



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 4 DHJETOR 2018**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 4. DECEMBRA 2018. GODINE**

**DHJETOR - DECEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Kërkesa e 40 deputetëve për seancë të jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave

Dnevni red

2. Zahtev 40 poslanika za vanrednu sadnicu za parlamentarnu raspravu u vezi sa neuspesima vladajuće koalicije koji su kulminirali zbog neliberalizacije viza

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Po fillojmë tani më në fund seancën e thirrur nga dy grupet parlamentare, që janë kryesisht deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje.

Pa humbur kohë dëshiroj që fjalën t'ia jap kryetarit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, zotit Hoti, që ta bëjë ekspozenë në emër të kërkuesit të seancës.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Nga një analizë e thjeshtë e qeverisjes njëvjeçare të koalicionit PAN mund të nxirret një manual se si të zhbëhet shteti brenda një viti.

Nuk ka si të kuptohet ndryshe veprimet e këtij koalicioni gjatë kësaj periudhe.

Shteti, rendi kushtetues dhe ligjet cenohen nëse kryeministri urdhëron ministrat të marrin vendime joligjore, siç është rasti me shkarkimin e Bordit të Agjencisë së Akreditimit, ose nëse Qeveria merr vendime jokushtetuese, siç është rasti ishte me pronat e AKP-së në komunat me shumicë serbe apo me rritjen e pagave për vete.

Paraja publike keqpërdoret nëse emërohen 80 zëvendësministra e plot koordinatorë nacionalë për të njëjtat detyra.

Mesazh i dëmshëm për shtetin dërgohet në Bruksel nëse 1/3 e ministrave kanë aktakuzë, pavarësisht parimit se ata janë të pafajshëm derisa nuk provohet nga gjykata.

Ekonomia e lirë e tregut cenohet nëse disa kompanive u falen 60 milionë euro taksa pa ligj, ndërkaq të tjerat i paguajnë taksat rregullisht.

Kushtetuta dhe parimi i ndarjes së pushteteve shkelen nëse Qeveria dhe kryeministri i marrin kompetencat Kuvendit, duke shkarkua borde të ndërmarrjeve publike, që janë në kompetencë të Kuvendit, siç ka ndodhur në disa raste.

Demokracia në vend cenohet nëse bashkëqeverisjet me krimin, siç është rasti i takimit të kryeministrit me personin e akuzuar në veri për krim e korrupsion.

Pavarësia e gjyqësorit shkelet nëse kryeministri urdhëron prokurorët se çka të bëjnë dhe nëse deputetët e Kuvendit i fyejnë prokurorët.

Parimi i trajtimit të barabartë të çdo qytetari nga ana e shtetit shkelet nëse komunat e udhëhequra nga partia e kryeministrit përfitojnë për kokë banori tri herë më shumë se komuna të tjera, siç u dëshmuua nga GAP në analizën e buxhetit për vitin 2019.

Një Qeveri që nuk respekton vendimet e autoriteteve të pavarura, siç është rasti me vendimin e Agjencisë Kundër Korrupsionit për konfliktin e interesit në rritjen e pagave për Kabinetin qeveritar, është një Qeveri që nuk ka si të respektohet nga qytetarët e vendit dhe nga partnerët ndërkombëtarë.

Nuk ka si të respektohet një qeveri nga të gjithë qytetarët e saj kur vetë i diskriminon ata.

Grantet për bujqësi që jepen nga Qeveri për bujqit në veri të vendit mbulojnë 90% të investimit, ndërsa për bujqit në pjesë të tjera të Kosovës të komuniteteve të tjera, vetëm 50%.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Unë e thashë në fillim se me këto dhe me plot veprime të tjera, këto vetëm mund t'i përmbledhim në një manual se si të zhbëhet shteti brenda një viti.

Sot nuk ka skepticizëm në shoqëri, sot ka pakënaqësi ekstreme. Vlerësimet tregojnë se Qeveria Mustafa, edhe kur ka qenë Qeveri në detyrë, ka pasur besueshmëri më të lartë se sa Qeveria Haradinaj që ka tash.

Raporti që është prezantuar në Parlamentin Evropian nga raportuesi për Kosovën thekson se ka elemente të kapjes së shtetit nga struktura qeverisëse.

Kulmi i këtyre dështimeve iu vu me dështimin për anëtarësim në Interpol dhe për liberalizimin e vizave.

Kryeministri, së bashku me partnerët e tij të koalicionit, të cilët dikur pengonin me dhunën e intriga përmbushjen e kriterëve për liberalizim të vizave, sot fajësojnë Bashkimin Evropian për këto dështime.

Këta persona dështimin e liberalizimit të vizave dhe anëtarësimin në Interpol po e plasojnë para qytetarëve si dështim të Evropës, në rastin e liberalizimit të vizave dhe të sigurisë globale, në rastin e Interpolit.

Ndërkaq vetë kanë dështuar totalisht në përmbushjen e Agjendës së Reformave Evropiane dhe zbatimit të MSA-së, pavarësisht se opozita jo që nuk ka hedhur gaz e ka përdorur dhunë, por i ka mbështetur të gjitha ligjet e reformës për integrim evropian pa asnjë kusht apo pengesë.

Këta zhgënjyen Brukselin dhe qytetarët tanë, ta kemi të qartë se fajin për mosliberalizim të vizave e ka ‘viti i mbrapshtë’ i kësaj qeverisje.

Arroganca e këtyre personave është e patolerueshme, po mundoheni që dështimet tuaja t’i mbulonit me një garë për patriotizëm. Kjo është arsyeja që Kosova po humb mbështetjen në botën demokratike. Tash ju kërkoni miq të tjerë në Lindje.

Po trumbetoni gjatë gjithë kohës të jeni për atë që Kosova të mos ndahet, ndërkaq të gjitha zhvillimet, jo vetëm në veri, po shkojnë në drejtim të këtij projekti të Serbisë.

Ushtria jonë po bëhet, deputetë të nderuar, pos tjerash edhe t’i mbrojtë kufijtë e Kosovës, po ju jeni bërë vetë rrezikuesit kryesorë të kufijve të Kosovës.

Nuk po na njohin shtetet e reja, ato që na kanë njohur, kanë filluar t’i tërheqin njohjet e tyre.

Në vend se t’i korrigjoni dështimet tuaja, ju po bëni plane për të korrigjuar kufijtë e Kosovës. Korrigjimin e kufijve nuk do të mund ta bëni.

E gjithë kjo situatë ka krijuar mungesë besimi te qytetarët. Kjo situatë nuk mund të vazhdojë më tutje.

Qytetarët e Kosovës kanë nevojë për normalitet dhe perspektivë të qartë, e jo tensione të përditshme që e kanë pamundësuar debatin substancial në shoqërinë e Kosovës për arsim e shëndetësi më të mirë, për shërbime publike më efikase, për punësim dhe për zhvillim ekonomik.

Ne presim që koalicioni i ‘punëve të mëdha’, PAN, të marrë përgjegjësinë për këto dështime dhe të hapë rrugë për formimin e institucioneve të reja.

Prandaj, të nderuar deputetë,

Në fund të këtij debati, ne i ftojme deputetët që të miratojmë së bashku një rezolutë që ka tri pika:

1. Që forcat politike parlamentare të ulen në tryezën e bisedimeve për të dakorduar agjendën për krijimin e institucioneve të reja përmes zgjedhjeve të lira dhe demokratike.
2. Pas këtij dakordimi, Qeveria e Kosovës të dorëhiqet dhe Kuvendi të shpërbëhet për t’i hapë rrugë formimit të institucioneve të reja.
3. Forcat politike të dakordohen që gjatë kësaj periudhe të mos dëmtohen proceset e rëndësishme nacionale, duke u siguruar që të adresohen çështjet më urgjente para se të shpërbëhet Kuvendit, para së gjithash, votimi i pakos së ligjeve për ushtrinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A doni të paraqiteni për të diskutuar, apo veç LDK-ja është paraqitur? Në rregull.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së nuk është paraqitur askush. Atëherë, Avdullahu është paraqitur në emër të propozuesit, tani në emër të LDK-së zoti Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar kryesues,
Kolegë deputetë,
Qeveria mungon,

Sot, në kushte dhe rrethana normale, me një qeveri kredibile, institucione të pavarura dhe të profesionalizuara do të duhej të kishim një seancë solemne për të dhënë mesazhe dhe inkurajim qytetarëve të Republikës së Kosovës se vendi ynë është afruar me botën perëndimore, janë shkurtuar hapat e anëtarësimit në BE, është siguruar lëvizja e lirë, por fatkeqësisht qytetarët e Republikës duhet të numërojnë dështimet, skandalet, dëmet dhe pasojat që kjo qeveri dhe këta krerë të institucioneve po ia bëjnë shtetit tonë dhe popullit të Kosovës.

Dje morëm përgjigje të prerë, shumë të shkurtër dhe pa asnjë mëdyshje se nuk ka lëvizje të lirë për qytetarët e Republikës së Kosovës. Sërish u përsërit refreni që disa nga ne e kemi theksuar gjatë gjithë kohës, që të mos jepni data të papërgjegjshme, duke menduar që po luani rolin e zëdhënësve të BE-së, por angazhohuni në mandatin kushtetues e ligjor që keni, përfundoni detyrat e paracaktuara, jo vetëm formalisht në letër, por duke krijuar pasqyrë adekuate të udhëheqjes, pa krim e korrupsion, pa klane dhe grupe, pa zhvatje të buxhetit e të asistencës ndërkombëtare, pa i sulmuar institucionet e sigurisë dhe të drejtësisë me ndërhyrje dhe ndikim. Por, ju edhe dje, sigurisht edhe sot, do të mundoheni që fajin dhe përgjegjësinë për dështime t'ia delegoni BE-së, sigurisht që edhe ajo i detyrohet një pjesë të fajit të saj, duke qenë bashkëpunëtore me njerëz, të cilët nuk njohin ligje dhe pavarësi kushtetuese, por krijojnë figura të bashkëpunimit dhe përkrahjes individuale, të cilët nuk janë asgjë më shumë se të kapur dhe të dorëzuar para të kaluarës së tyre, e cila bie ndesh me pastërtinë ligjore dhe pozicionin për të cilin përfaqësojnë.

Çdo veprim juaj në këtë vit si koalicion ka pasuar me pasoja, të cilat duken të pariparueshme. Në fillim të këtij viti presidenti i Komisionit Evropian, Junker, duke folur për të ardhmen e BE-së, theksoi: “Kosova ka një mundësi për progres të qëndrueshëm nëpërmjet implementimit të MSA-së”, por çka bëri qeveria pas shkurtit të këtij viti, jo vetëm që nuk u interesua për implementimin e saj, por ajo filloi edhe me vendime skandaloze:

- rritet pagat personale në mënyrë marramendëse,
- instaluar katër qeveri në një qeveri, ministra të cilët u raportojnë shefave partiakë, ndërrimet dhe vlerësimet për punën e tyre i bëjnë individët me porosi dhe kushtëzime,
- ngatërruar nivelet e qeverisë dhe administratës, duke shpikur pozita koordinatorësh nacionalë,

- banalizuat me emërimet e zëvendësministrave me individë klanesh, ku shumica e tyre e kanë punën e parë të tyre në institucione publike,
- devaluat skajshëm institucionin e qeverisë, shembull tipik ishte zënia në hajni e njërit nga zëvendësministrat, ky është tregues i qartë pse ata gjenden aty, si dhe çfarë shërbimesh bëjnë për shefat e tyre.

Nuk mund të marrësh liberalizim të vizave, e as të afrohesh me familjen evropiane duke përfshirë në vendimmarrje njerëz me aktakuza publike për krim të organizuar dhe korrupsion, shumica në nivel të ministrave. Si mund të ketë sundim të ligjit, ku partner në qeverisje konsiderohet edhe njëri nga të apostrofuariat si ‘kapo’ i bandave në pjesën e veriut të Kosovës, tani i kërkuar edhe nga drejtësia vendore për vrasje e shumë vepra të tjera kriminale? Këto janë vetëm disa nga elementet bazike që kanë krijuar mosbesim në Kosovën dhe të ardhmen e saj proeuropiane, të mos harrojmë edhe faktin e pamohueshëm të tezave të presidentit të vendit, i cili ka vënë në treg territorin e Kosovës, njëherësh duke zbehur subjektivitetin e brendshëm dhe duke sjellë defaktorizimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare, sigurisht duke qenë arkitekt i këtij koalicioni, i cili është i varur në tërësi në agjendën e tij personale.

Kolegë deputetë,

Sot kemi nevojë për unitet, duhet t’i thirrni mendjes dhe të mos mendoni vetëm për karrigen e pushtetit, të reflektoni duke thirrur në përgjegjësi dhe të kërkon dorëheqjen e kësaj qeverie, duke i mundësuar vendit kthimin e dinjitetit dhe rrugës demokratike të zhvillimit të saj.

Ju mund të provoni vazhdimin e kësaj që keni nisur, mund të shfrytëzoni këto procedura ligjore, të cilat pamundësojnë shkarkimin tuaj, por nuk mund ta ndalni zërin qytetar për kërkesën e tyre për një jetë më të mirë dhe me dinjitet në Republikën e Kosovës.

Andaj, hapni rrugë për zgjedhje të reja e demokratike. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Zemaj. Fjalën e ka zonja Blerta Deliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Si kryetare e Komisionit për Integritet, por edhe si deputete e këtij Parlamenti mund ta marr me mend ngutjen e thirrjes së kësaj seance të jashtëzakonshme për të adresuar shqetësimet lidhur me deklaratën e djeshme të Komisarit për Zgjerim, zotit Han, e cila ishte deklaratë dekurajuese për institucionet e Republikës së Kosovës dhe jo vetëm, ishte deklaratë dekurajuese dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Megjithatë, para kësaj deklaratë dua vetëm të kthej vëmendjen te një vizitë e fundit që e kemi pasur bashkë me dy shefat e grupeve parlamentare, me zotin Avdullah Hoti, të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe me zotin Glauk Konjufca, nga Lëvizja Vetëvendosje, në Bruksel, në një takim në Parlamentin Evropian, ku përfaqësues të Parlamentit, deputetë të Parlamentit Evropian i adresuan hapur shqetësimet në Parlamentin Evropian që Kosovës po i bëhet e padrejtë sa i përket moslejimit të qytetarëve që të lëvizin në zonën Shëngen.

Edhe në këtë takim të Parlamentit u tha qartë që procesi i filluar si proces teknik, tashmë po shndërrohet në diçka politik dhe këtë nuk po e themi ne si përfaqësues të zgjedhur të qytetarëve të Republikës së Kosovës, këtë e kanë thënë vetë zyrtarët e lartë të Bashkimit Evropian dhe, natyrisht që është njëri prej lajmeve më të këqija që i kemi marrë për këtë fundvit.

Të gjithë jemi të vëmendshëm që Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret sa i përket udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave. Kanë qenë gjithsej 95 kriteret, të cilat kanë prej kriterëve më të vështira që i kanë pasur shtetet, të cilat kanë kaluar nëpër të njëjtin proces.

Duke përfshirë këtu edhe dy kriteret të fundit që kanë qenë demarkimi i kufirit me Malin e Zi si dhe luftimi i krimit të organizuar rreth korrupsionit që ka qenë si kriter i mbetur, për të cilin institucionet kanë shënuar progres të vazhdueshëm.

Dhe konform punës që e kanë bërë institucionet e vendit, ne kemi pritur të marrim sinjale të qarta, meqë ka pasur një rekomandim pozitiv sa i përket procesit të liberalizimit të vizave dhe po ashtu ka pasur edhe një votë kualitative, një votim pro lëvizjes së lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kur jemi te kriteret e mbetura, të cilat ne i kemi përmbushur, unë dua të falënderoj këtu edhe Lidhjen Demokratike të Kosovës, e cila aso kohe ka dhënë një mbështetje të qartë për të përmbyllur procesin e demarkimit të Malit të Zi ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, si kriter i kërkuar nga Bashkimi Evropian dhe si kërkesë që na është parashtruar në mënyrë që qytetarët e vendit të lëvizin lirshëm.

Secila Qeveri, edhe kjo Qeveri, edhe Qeveria e Isa Mustafës, do të thotë e ka thënë atë që po e themi edhe ne vazhdimisht: që pritjet tona kanë qenë pritje realiste për të pasur diçka, jo si shpërblim, por për të pasur diçka si përmbushje të obligimeve që zyrtarët e Bashkimit Evropian i kanë dhënë raport me ecjen që ka bërë Kosova në këtë drejtim. Dhe, këtu jemi të gjithë të vëmendshëm që është bërë ecje e madhe.

Edhe në Bruksel na është thënë që Kosova i ka përmbushur 95 kriteret.

Dhe, sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, ne e kemi përmbyllur obligimin tonë si shtet.

Këtë nuk është mirë që sot opozita ta thotë në mënyrën si e tha sot parashtruesi i kërkesës, sepse ne obligimet tona si shtet sa i përket këtij procesi i kemi përmbyllur. Mendoj që është proces tejet i ndarë procesi i përafimit të Kosovës me Bashkimin Evropian, për të cilin ne do të vazhdojmë rrugëtimin tonë dhe do të vazhdojmë edhe reformat si institucione.

Në radhë të parë, për të forcuar vetë institucionet e Kosovës, për të forcuar shtetin e Kosovës, e pastaj edhe për të përafuar Kosovën në rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian.

Dhe unë e kuptoj plotësisht mllëfin e qytetarëve të vendit, e kuptoj dekurajimin që e kanë marrë dje nga një qëndrim i hapur i Komisarit Han qytetarët e këtij vendi, të cilët janë dekurajuar nga mesazhi që u tha hapur që Kosova nuk do të ketë liberalizim deri në vitin 2020, apo që të mos përmendet datë.

Ne kemi deklaruar vetëm atë që na është thënë vazhdimisht në takimet tona, ku kanë qenë bashkë edhe përfaqësues të pozitës, edhe përfaqësues të opozitës.

Sa i përket punës së Komisionit për Integritet, unë dua t'i falënderoj të gjithë kolegët e mi deputetë, pozitë e opozitë, për konstruktivitetin që e kanë treguar në agjendën tonë sa i përket këtij procesi, qoftë në vizitat tona jashtë vendit, qoftë në punën që është bërë brenda Komisionit për Integritet, ku ne kemi ftuar edhe përfaqësues të shteteve veç e veç për të marrë sinjale të qarta pse Kosova nuk po merr atë për të cilën ka punuar tash e sa vjet, do të thotë që nga vitin 2012, kur ne kemi marrë udhërrëfyesin për liberalizim të vizave.

Tash, natyrisht që është lajm i keq që ne nuk jemi përfshirë në agjendë të Këshillit, është njëri prej lajmeve më të këqija që Kosova nuk do të jetë pjesë e agjendës dhe presim që proceduralisht të përfshihemi dhe që të ketë një autorizim sa i përket fillimit të dialogut.

Institucionet e BE-së mendoj që duhet të trajtojnë në mënyrë të njëjtë të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor, e në këtë rast edhe Kosovën, e cila madje në ecjen e saj ka bërë hapa edhe më të vështirë për t'i realizuar se sa shtetet të cilat kanë kaluar nëpër të njëjtin proces.

Sot kemi pasur 22 anëtarë të Parlamentit Evropian që i kanë dërguar një letër të hapur presidentit të Këshillit Evropian dhe kryesuesit të përhershëm të Austrisë në Bashkimin Evropian, për të kërkuar largimin e regjimit të vizave për Kosovës, si një e drejtë që qytetarët e Republikës së Kosovës e kanë merituar tash e sa vjet, si një e drejtë dhe obligim, për të cilin kemi punuar gjithë bashkë pozitë dhe opozitë.

Në këtë letër, këta anëtarë deputetë të Parlamentit Evropian, kanë deklaruar se konsiderojnë jetike sigurimin e vizave për Kosovën, proces ky sipas të cilëve ka vonesa të panevojshme.

Këta deputetë edhe një herë sot i kanë bërë thirrje Këshillit që të përfshijnë në agjendë pajisjen me viza të qytetarëve të Kosovës apo dhënien e sinjalit të qartë për t'i larguar nga regjimi i vizave qytetarët e Republikës së Kosovës. Nuk e kemi thënë ne, e kanë thënë 22 anëtarë të Parlamentit Evropian dhe është thirrje e 22 zërave që përfaqësojnë shtetet e tyre në Parlamentin Evropian.

Prandaj, ne presim këtë fazë që të kemi diçka të pritshme, fundja, është në pyetje vetë kredibiliteti i Bashkimit Evropian si institucion që t'u dalë zot deklaratave, qëndrimeve, atyre që i ka thënë vazhdimisht, të gjithë zyrtarët e kanë thënë që ne i kemi përmbushur kushtet dhe s'po kërkojmë as më shumë as më pak se sa që të kemi diçka të pritshme lidhur me punën dhe angazhimin tonë si institucione që e kemi bërë në këtë drejtim.

Dhe, unë për këtë jam e bindur që liberalizimi i vizave do të ndikonte qartë në stabilitetin e vendit, duke e sjellë kështu edhe Kosovën më afër Bashkimit Evropian dhe duke përmirësuar çështjen e udhëtimit dhe të bërit biznes, e sidomos çështjen e udhëtimit, kur kemi parasysh ende pritje të gjata të qytetarëve të vendit nëpër ambasadat në Prishtinë dhe listat e gjata për t'u pajisur me vizë.

Dhe, në këtë fazë nuk mendoj që është kredibile për vetë një institucion të lartë, siç është Bashkimi Evropian, që Kosova të mbetet i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor që qytetarët e saj të mbesin edhe më tutje të izoluar.

Dhe, sa i përket këtij procesi, unë mund të them që nuk kemi asnjë informatë zyrtare pse mbledhja e Këshillit ende nuk është mbajtur, kemi vetëm informacione që ne nuk do të përfshihemi në Këshill, mirëpo nuk ka ende zyrtare asgjë sa i përket asaj që do të jetë edhe përfundimi.

Mund të them që kemi bërë bashkë një punë të jashtëzakonshme dhe që kemi punuar me vite pozitive dhe opozitive në këtë drejtim dhe unë gjithsesi pres që shpresa te ne të mos shuhet, fundja, ne do të vazhdojmë të kemi kërkesë të qartë që shtetet të cilat kanë hezitime, t'ua bëjmë të qartë qëndrimin tonë dhe progresin që e kanë bërë institucionet e Republikës së Kosovës.

Ka një numër të shteteve të cilat kanë hezitime që Kosova do të jetë vatër e migrimit, që qytetarët e vendit do të lëvizin në një pjesë të këtyre shteteve.

Kosova është njëri prej shteteve që ka bërë së fundi progres sa i përket listës së Eurostatit, ne nuk figurojmë në 30 vende, të cilat paraqesin rrezik serioz sa i përket migrimit ilegal. Këtë ua kemi bërë të qartë jo vetëm miqve të Parlamentit Evropian, por ua kemi bërë të qartë edhe atyre, të cilët kanë pasur dilemë dhe kanë pasur hamendje që nga Kosova do të ketë lëvizje të madhe të qytetarëve për në Bashkimin Evropian.

Unë po e ndërpres këtu diskutimin, besoj shumë që me të gjithë kolegët, pozitë dhe opozitë, do të kemi një diskutim konstruktiv dhe do t'i kontribuojmë kësaj situatë aspak të favorshme për qytetarët e Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Deliu! Fjalën e ka në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zoti Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Po më kujtohet si sot faqja e parë e një gazete shumë të njohur në Kosovë, gazetë ditore, më kujtohet si sot titulli i saj në faqe të parë, fotografinë e kryeministrit në atë kohë, Hashim Thaçi: "Hashim Thaçi: liberalizimi i vizave për Kosovën do të bëhet brenda vitit 2009". Në Koha ditore e keni, domethënë vitin 2009, titullin e madh, premtimin e kryeministrit të atëhershëm që liberalizimi i vizave për Kosovën do të vijë në vitin 2009.

Prej atëherë kur është bërë ky premtim i kryeministrit të atëhershëm, tri qeveri janë ndërruar në Kosovë, kjo është e treta tash, edhe Komisari Hahn na tha që nuk ka liberalizim të vizave për Kosovën para vitit 2020.

Tash merreni me mend, premtimi për liberalizim të vizave në Kosovë ka ndodhur tre vjet përpara se të na vijë edhe udhërrëfyesi për liberalizim të vizave. Udhërrëfyesi na pati ardhur në vitin 2012, po më kujtohet se kemi debatuar në këtë Kuvend kur ka ardhur udhërrëfyesi se cilat janë kriteret që duhet t'i plotësojë Kosova për të ndodhur liberalizimi i vizave.

A këtu politikanët e papërgjegjshëm të ne e kanë premtuar liberalizimin e vizave prej vitit 2009 për çdo vit, rregullisht, me të njëjtat fjalë, pa kurrfarë dallimi.

Kryeministri aktual që e kemi, në një farë mënyre, bashkë me Presidentin i bindën qytetarët e Kosovës që veç edhe një kusht ka mbetur dhe liberalizimi i vizave po bëhet shumë shpejt.

Se vetëm Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë demarkacionin, dhe liberalizimi i vizave vjen, e kam dëgjuar me veshët e mi kryeministrin aktual, brenda tre muajsh, premtimi publik i kryeministrit të Kosovës ka qenë: Qytetarë të Kosovës, do të keni liberalizim të vizave tre muaj pasi të marrim në këtë Kuvend vendimin për kalimin e demarkacionit me Malin e Zi.

Tash, demarkacioni me Malin e Zi u arrit vitin e kaluar, në vitin 2017. Komisari Han tha që nuk do të kemi deri në vitin 2020 liberalizim të vizave. Kjo tregon joseriozitetin e kësaj Qeverie edhe premtimet e këtyre politikanëve.

Edhe vetë Qeveria e kaluar kur është rrëzuar, koalicioni PAN e rrëzoi me arsytimin shumë të mirënjohur, e dini të gjithë, që këta nuk po dinë të marrin vendime për liberalizim të vizave, kështu që po i rrëzojmë se ne dimë qysh t'i marrim ato vendime të mëdha. Tash qytetarët kanë të drejtë të pyesin pse i keni mashtruar qytetarët? Pse nuk keni treguar drejt? Më në fund, në këtë vend duhet mësuar dhënien e përgjegjësisë politikanët, kanë poste publike, fjalën kur e thua, aq më tepër kjo, e cila aq shumë i mundon, qytetarët e Kosovës kanë shumë nevoja sa i përket lëvizjes, kur thua që vetëm demarkacioni duhet të kalojë dhe vijnë vizat, tash të gjithë ata politikanë duhet të dalin përpara qytetarëve të Kosovës e të tregojnë pse i kanë mashtruar.

Aq mizerie është ky pushtet, sa që zyrtarët e BE-së thonë: “Kosova i ka plotësuar kushtet, por edhe pse i keni plotësuar kushtet, nuk ua japim liberalizimin e vizave”. Porosi më të qartë unë nuk di qysh shkruhet. Kjo është si të të vizatohet me laps qysh ta ndërrosh qeverinë. Me këtë pushtet nuk ecet përpara, me shtetësi dhe territor kurrë nuk kemi qenë më të pasigurt, domethënë që prej përfundimit të luftës në vitin 1999. Po ashtu, marrëdhëniet tona me Bashkimin Evropian, me Gjermaninë, si dhe me shumë shtete mike të Kosovës, kurrë nuk kanë qenë në fazë më kritike. Jo me popullin e Kosovës, se këto shtete nuk kanë kurrë kundër popullit të Kosovës, se kur ka qenë puna e popullit, edhe NATO e bombardoi Serbinë. Mirëpo, marrëdhëniet e këtyre shteteve kanë problem me pushtetin në Kosovë, me ata që qeverisin, ata në këtë aspekt të demokracisë të mënyrës së qeverisjes së institucioneve, të luftës, të krimit të organizuar, të korrupsionit, unë mund të them që janë në nivel të mjerueshëm, fatkeqësisht.

Kosova vetëm sivjet ka pasur më shumë çnjohje se njohje të pavarësisë dhe çka ka kuptim njeriu të qëndrojë në pushtet me gjithë këto dështime. Në anën tjetër, unë nuk jam vetëm për t'i bërë kritika Qeverisë së Kosovës, do kritika i meriton natyrisht edhe Bashkimi Evropian. Nuk jam të gjitha kritikata t'ua drejtoj vetëm pushtetarëve dhe të thuhet se Bashkimi Evropian është krejt në rregull, se edhe atje është një paradoks, që s'po dinë si ta kuptojnë qytetarët.

Paradoksi është ky, sepse janë dy mundësi: ose Kosova i ka plotësuar kushtet, e kur thua i ke plotësuar kushtet, jepni vizat, ose Kosova nuk i ka plotësuar kushtet, por nëse nuk i ka plotësuar kushtet, tregoni, tregoni cilat kushte nuk i ka plotësuar. Ua lehtësoni jetën edhe qytetarëve të Kosovës, dinë qysh të votojnë më mirë, dhe ua lehtësoni argumentet opozitës. Ndoshta edhe pushtetit ia lehtësoni në mënyrën që të dinë ata cilat kritere janë të paplotësuara që t'i plotësojnë. Është paradoks me të vërtetë edhe prej anës së Komisionit Evropian të lëshojë një komunikatë, ku thotë: “Krejt është në rregull, Kosova i ka plotësuar kushtet, por nuk po ua japim liberalizimin e vizave”. Në të vërtetë, për ta zgjidhur këtë paradoks, unë mendoj që ajo pika e dytë, ku thuhet “Kosova i ka plotësuar kushtet në fushën e luftimit të krimit edhe të korrupsionit”, mendoj që atë BE-ja e ka shkruar sa për sy e faqe. Ne këtu po jetojmë në Kosovë, sa luftohet krimi e korrupsioni në Kosovë, sa ka korrupsion në Kosovë, i ndodh në pikë të ditës njeriut kryesor të institucionit më të rëndësishëm në Kosovë, i cili e bën prokurimin e parasë publike, i shkojnë njerëzit në pikë të ditës e ia kërkojnë tenderin për autostradën për Gjilan, kjo veç në Kosovë

ndodh dhe të mos procedohet, për shembull, lënda e tij në gjykatë. Në gjykatat e Kosovës prishen lëndët më serioze të korrupsionit, të profilit të politikanëve të lartë të Kosovës, këtë e dimë të gjithë.

BE-ja, sa për sy e faqe, shkon atje thotë që Kosova i ka plotësuar kushtet edhe sa i përket luftimit të kimit dhe të korrupsionit, është dashur të na tregojë drejt. Kur tregon drejt, është dashur të thonë sa ka korrupsion në Kosovë, edhe atëherë tani edhe opozita kishte kritikuar më drejt, edhe Qeverinë e kishim obliguar të punojë më shumë. Kështu me këto paradokse natyrisht që një pjesë të përgjegjësive e ka edhe mënyrën qysh po shprehet Komisioni Evropian. Tjetra, kam dëgjuar disa deklarata të zyrtarëve qeveritarë këto ditë, prej kur u bë e ditur që me gjasë nuk do të ketë liberalizim të vizave për Kosovën, zyrtarët tanë politikë, duke filluar prej ministres së Integritimit Evropian, i kam dëgjuar duke thënë kështu: “Çka na ka rrejtur Brukseli, iu kemi rrejtur ne juve”, demek s’kemi faj, qysh na kanë thënë ata, po ju themi ne juve. Ata na kanë thënë “miratojeni demarkacionin, gati i keni vizat”, ne ashtu kemi vepruar. Logjika e këtyre deklaratave është shumë shqetësuese për mendimin tim, kjo i bie që politikanin e Kosovës, zyrtarin publik, qeveritarin e Kosovës që e përfaqëson Republikën e Kosovës, është ministër, mund ta mashtrosh shumë lehtë dhe çka t’i thuash, ai beson, dhe mendon që kështu ik prej përgjegjësive të veta, as nuk ka përgjegjësi çka duhet të punojë, cilat detyra të shtëpisë duhet t’i kryejë, çka thonë atje në Bruksel, nënshkruaj diçka me Serbinë, shumë shpejt vijnë vizat, jepja 8 mijë e 200 hektarë Malit të Zi, automatikisht vijnë vizat, çfarë logjike është kjo? Çfarë justifikimi është një zyrtar i shtetit të dalë dhe të thotë: “Mua më kanë rrejt, unë ju rrejta juve”. Domethënë, kjo është me të vërtetë joserioze.

Edhe diçka, po thonë që ende nuk është definitive, mund të ketë liberalizim të vizave deri në fund të vitit. A dini çka është më e keqja, ne nuk jemi në rend të ditës, kjo është më e keqja. Kjo është simbolika e punës së kësaj qeverie në botë, rezultati është ky: të mos jesh as në rend të ditës, kjo është më së keqi.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Konjufca! Fjalën e ka zoti Dardan Sejdiu, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, diskutimi mbi çështjen e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës është diskutim, siç e përmendi edhe Glauku, tash e 10 vjet, është premtim elektoral tash e 10 vjet i të gjitha qeverive, pa përjashtim. Pra, pa asnjë përjashtim, secili në pushtet e ka premtuar liberalizimin e vizave, por sikurse që kanë qenë të pasinqertë secila qeveri deri tash, sa i përket temës së liberalizimit të vizave, po ashtu kanë qenë edhe elektoral, e qe besa kjo çështje po vazhdon të jetë elektorale edhe sot, e fatkeqësisht po përdoret duke mos e treguar, sipas meje, edhe faktin që jemi në një situatë jashtëzakonisht paradoksale.

Ky proces, sado që është teknik, pra është atje një ‘chek’ listë e kushteve që duhet plotësuar, apo së paku kështu thotë BE-ja, është gjithashtu edhe vendim politik. Gjithsesi nga qeveritë tona nuk kemi pritur ndonjë kredibilitet ose nuk presim ndonjë kredibilitet sa i përket kësaj teme, sepse tash e 10 vjet flasim, pa përjashtim, secila qeveri flet për këtë çështje. Por, ama nga BE-ja kemi pritur sado pak të jetë në përputhje me vlerat për të cilat, si të thuash, qëndrojnë, apo për vlerat, të cilat i përqafojnë, e ne mundohemi këtu, me anë të punës që e bëjmë në Kuvend, me ligje, me direktiva, e tjera, e tjera, të për afrohem. Pra, kritika ime për Qeverinë është e thjeshtë, është kritikë e njëjtë për secilën qeveri. Është përdorur një proces, është keqpërdorur një proces, është stërpërdorur një proces dhe në fund fare kemi mbet në të. Por, nga BE-ja e kam pritur një qasje pak më serioze. Nëse thuhet që kërkesat teknike janë përmbushur, atëherë liberalizimi, nëse ka qenë gjithherë argumenti që është proces teknik, e atëherë vendimi nëse nuk merret apo nuk vendoset çështja e liberalizimit të vizave në agjendën e Këshillit të ministrave, është kryekëput vendim politik. Dhe, këtë duhet shpjeguar qytetarëve të Republikës së Kosovës, duhet shpjeguar që ky vendim politik lidhet goxha shumë me proces elektoral fatkeqësisht në Shtetet e Bashkimit Evropian, dhe një prej punëve tona si deputet është të mundohemi sadopak të jemi korrektë me informacionin që e kemi.

Pra, në shtetet e Bashkimit Evropian ekziston një drojë që e djathta ekstreme po rritet, paramendojeni paradoksin. Duke iu nënshtuar rritjes së djathtës ekstreme, vlerat për të cilat avokojnë tash e 20 vjet për qytetarët e Republikës së Kosovës ndalen, preket pulla “pauzë” apo “stop”, derisa të kryhen zgjedhjet atje, në mënyrë që e djathta ekstreme atje të mos përfitojë mbi narrativen e migrimit, por për të treguar se sa e kotë është kjo narrativë, po e marr një shembull: Republika e Kosovës i ka 1.8 milion banorë sipas censusit të fundit, kryeqyteti i Francës, Parisi, i ka 2.5 milionë banorë. Pra, narrativi që po ushqehet duke mos lejuar lëvizjen e lirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës është inekzistente, thënë të drejtën, thjeshtë është pozicionim i gabuar. Dhe, mendoj që këtë secili prej nesh duhet të mundohet ta shpjegojë për aq kohë sa ka mbetur deri në mbledhjen e Këshillit të ministrave dhe të vendosjes së Kosovës në agjendën e Këshillit të Ministrave, në mënyrë që këtë të drejtë të lëvizjes së lirë ta gëzojmë secili prej nesh.

Në ndërkohë ekziston edhe një, të themi kështu, situatë e përçudnuar, shumica e shteteve të Ballkanit Perëndimor kanë të drejtën e lëvizje së lirë, një të drejtë fundamentale njerëzore që nga viti 2010 dhe përsëri këtu po e shpërfaq që nuk është gjithçka teknike, por është goxha politike si vendim. Sa u përket qeverive të Republikës së Kosovës, besoj një pjesë e kritikës u dha edhe nga iniciuesit, por unë po e përmend vetëm një. Keqpërdorimi i bashkësisë ndërkombëtare për shtyrje të agjendave të këqija për Republikën e Kosovës është gjithashtu një prej adutëve që këto qeveri e kanë përdorur tash e 18 vjet. Rasti i demarkacionit dhe shumë e shumë raste të tjera sa i përket procesit të dialogut, e shumë e shumë raste të tjera që na u kanë servuar këtu që janë në frymën e njëfarë agjende integruese në Bashkimin Evropian apo që duke vepruar në një formë apo tjetër, sjellin deri te liberalizimi i vizave. Pra, kritika për qeveritë tona prej vitit 2010 e deri më tash nuk është risi, dhe nuk presim ndonjë kredibilitet nga këto qeveri, asnjëra këto 18 vjet. Por, besoj që

duhet të presim një lloj kredibiliteti nga ato shumë shtete që kanë shpenzuar qindra miliona euro për të pasur institucione të tyre në Kosovë, këtu po përmend, për shembull, EULEX-in. Paratë e taksapaguesve të qytetarëve të Bashkimit Evropian janë shpenzuar me të madhe, në mënyrë që të ketë një mision, i cili e skanon, e mirëmban dhe e ndërton sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Misioni i EULEX-it ka qenë mentorimi, monitorimi dhe këshillimi i qeverive të Republikës së Kosovës, e në disa raste të kenë edhe fuqi të kufizuara ekzekutive, që të gjithë e dimë që ka pasur fuqi ekzekutive në sistem të drejtësisë. Pra, është pak hipokrite të thuash nuk keni pasur sukses në sundim të rendit dhe ligjit, e në anën tjetër, të jesh pjesë integrale e tij, me paratë e taksapaguesve. Pra, mendoj që kritika për qeverinë jo veçse që qëndron, por është e njëjta tash e 18 vjet, por gjithsesi duhet të shpërfaqim edhe atë, e cila për mua është gjithashtu tepër me rëndësi, është kredibiliteti i institucioneve të Bashkimit Evropian karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës. Po dua të flas edhe për këtë farë trininë e shenjtë, pra këtë treshen e famshme, për të cilën tash e 18 vjet ne flasim: për një ekonomi të tregut, për lirinë, për konceptin e lirisë në një botëkuptim liberal, e që ka të bëjë me lirinë e lëvizjes së mallrave, së kapitalit, së njerëzve, në këtë rast kur flasim për lirinë e lëvizjes së njerëzve nuk flasim veç për turizëm, flasim edhe për lirinë e lëvizjes së fuqisë punëtore. Dhe, asnjëra prej këtyre nuk është temë, e cila është trajtuar sa i përket Republikës së Kosovës.

Sot mallrat e Republikës së Kosovës kanë barriera të ndryshme tarifore e jotarifore. Qytetarët e Republikës së Kosovës nuk mund të lëvizin as për turizëm, e lëre më si fuqi punëtore në Bashkimin Evropian. Ndërsa, kapitalin tonë, institucionet tona, paratë e kursimeve tona nacionale qëndrojnë në institucionet financiare të Bashkimit Evropian. Pra, kritika duhet të jetë në dy drejtime: edhe karshi mospunës së qeverive e premtimeve boshe tash 18 vjet, keqpërdorimit të liberalizimit të vizave për përfitime momentale, elektorale, politike, por në të njëjtën kohë, besoj që duhet edhe një herë të shpërfaqim që asnjë prej vlerave për të cilat flasim çdo ditë si komunitet, i cili pretendon të jetë pjesë e Bashkimit Evropian, nuk po na lejohen t'i gëzojmë. Dhe në fund fare po e them që liberalizimi i vizave është një temë, e cila është shndërruar në politike sot për shkak të situatës komplet problematike elektorale në Bashkimin Evropian. Edhe një herë po e potencoj, e djathta ekstreme atje është problem, me të cilin në vend se të trajtojmë me një fuqi progresive e hapje për të gjithë popujt e Evropës, po e bëjmë saktësisht të kundërtën, po e ushqejmë idenë që ekziston një problem imigracionit prej vendeve si Kosova, që përfaqësojnë as 70% në terma të popullatës sa një kryeqytet, si Parisi.

Përfundimisht, asnjë qeveri deri tash nuk ka qenë as korrekte dhe as e drejtë sa i përket trajtimit të temës së liberalizimit dhe kjo është një kritikë, e cila vlen edhe për këtë qeveri, bile edhe më shumë. Meqë është pretenduar që me votim të demarkacionit, ndodh liberalizimi, ja që nuk ndodhi dhe po besoj që, po shihet që nuk do të ndodhë. Liberalizimi është lëvizja e lirë e qytetarëve...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka në emër të AAK-së, zoti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo seancë se sa është serioze, u pa nga seanca paraprake, e cila nuk u mbajt, sepse erdhi me nënshkrime të manipuluar dhe po ashtu, sa është serioze tregon me vetë faktin e leximit të rezolutës, në të cilën theksohet se kërkojnë zgjedhje. Domethënë, është një seancë paraelektorale që e do një pjesë e opozitës, e që normalisht e ka të drejtën gjithmonë të kërkojë zgjedhje, por duhet t'i përmbahet më shumë temës për të cilën e ka thirrur seancën.

Duke e parë edhe interesimin për temën, normalisht ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës iu kemi përgjigjur kësaj seance dhe konsideruar edhe në të kaluarën kur është thënë se do të bëhet liberalizimi i vizave, nëse mund t'ju shihet për të madhe përfaqësuesve politikë e institucionalë gjatë të gjitha periudhave kur kanë udhëhequr edhe ata që e kanë thirrur këtë seancë, që kanë premtuar liberalizim të vizave pa e pasur në dorë mandatin për ta bërë liberalizimin, sepse liberalizimin e vizave normalisht si proces e bën Bashkimi Evropian. Dhe, çka është më interesantja, Bashkimi Evropian, përmes Komisarit Han në Prishtinë dje deklaroi se Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret, 95 kriteret, domethënë ka kryer punën e vet dhe nuk e tha ndryshe, por e tha që në Bashkimin Evropian ekzistojnë procedura, të cilat duhet të vazhdojnë në mënyrë që të bëhet liberalizimi i vizave. Kemi dëgjuar edhe deklaratat të përfaqësuesve të Bashkimit Evropian që kanë qenë shumë më të ashpra se sa këto që opozita po i bën ndaj institucioneve të vendit, e që janë përmendur edhe se procesi po politizohet, është thënë publikisht nga ana e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian dhe po ashtu është thënë se Kosova po kthehet në një aparteid, nuk e di shprehje më të rëndë të ketë përmendur dikush se sa këtë nga përfaqësues të Bashkimit Evropian.

Po ashtu, edhe kërkesa e tanishme e 22 deputetëve të Parlamentit Evropian që t'i hiqen Kosovës këto pengesa që i janë vënë e të bëhet liberalizimi i vizave edhe të dalin qytetarët e Kosovës që sot janë të izoluar kudo nëpër botë, si të gjitha vendet e tjera, ndërsa këtu shpikin edhe elemente, të cilat as nuk janë përmendur në fjalën e Komisarit Han, se gjoja për shkak të krimit të organizuar, korrupsionit, se Qeveria s'po bëka, lërini këto, nëse doni të interpretoni deklaratat e përfaqësuesve të Bashkimit Evropian, merrni autentike, ashtu si thonë ata, por jo si dëshironi ju t'i transmetoni. Njëkohësisht, mund të them se tani duhet të kemi kujdes të mos japim data, kur e dimë që nuk është në dorën tonë ta bëjmë, topi është në Këshillin e Evropës, duhet të bëhen angazhime të mjaftueshme e të domosdoshme të institucioneve të vendit që të ndikojnë sa më shumë në liberalizimin e vizave si proces për një çështje krejtësisht e të drejtës njerëzore, humane që të gjitha vendet tjera e gëzojnë. Dhe, në fund e kisha lutur edhe opozitën, sepse kemi pasur raste kur publikisht para 28 përfaqësuesve të vendeve të Bashkimit Evropian janë folur

fjalë të rënda për institucionet e vendit, edhe ato që s'janë merituar të thuhën dhe normalisht që edhe të tjerët i marrin për konsideratë ato, por të tregojnë realisht se kjo Kosovë nuk meriton të jetë e izoluar, qytetarët e këtij vendi nuk meritojnë një trajtim të tillë në Evropën e civilizuar, por përkundrazi, të thërrasin arsyen dhe ndërgjegjen edhe deputetët, në mënyrë që t'u drejtohen përfaqësuesve të ndryshëm që mund t'i takojnë në takime të veçanta që të kërkojnë që kjo e drejtë elementare t'i takojë popullit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sherifi, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sikur sot të ishte thirrur seancë parlamentare për të diskutuar pse vizat nuk u liberalizuan në vitin 2017, do ta kisha kuptuar kërkesën e kolegëve nga Lidhja Demokratike e Kosovës për këtë debat, edhe të gjitha akuzat, fajësimet që do t'i drejtoheshin së paku pjesës së tashme të Qeverisë që ka të bëjë me AAK-në e Nismën, të cilët ishin dikur në opozitë, do ta kisha kuptuar se do të kishit thënë nuk po na leni të kalojmë demarkacionin, prandaj s'po na i liberalizojnë vizat, këtë do ta kisha kuptuar.

Sepse, është e vërtetë që kemi qenë në pozicione kundër ratifikimit atë kohë. Mirëpo, sot kjo seancë është thirrur pse ka gjasë që fare të mos liberalizohen sivjet dhe, siç tha zoti Han, as në mot, këtë nuk e kuptoj, se të njëjtën kohë Komisari Han tha që janë plotësuar kushtet për liberalizimin e vizave.

Pra, nëse para dy vjetësh thoshin nuk janë plotësuar, para një e viti e gjysmë dy, demarkacioni është kusht, nuk janë plotësuar, pa u plotësuar kushti i demarkacionit nuk ka liberalizim, këtu do ta kishim kuptuar pozicionin e LDK-së. Në anën tjetër, do ta kisha kuptuar akuzën e bashkëftuesve të kësaj seance se dhatë territor dhe megjithatë vizat s'u bënë, ama ju ftesën e keni bërë bashkë me këta që dhanë territor për këtë seancë. D.m.th. gati se të gjithë fajtorë për që jemi në këtë seancë në të, nëse hyjmë në këtë logjikën se vetëm ne qenkemi fajtorë pse nuk janë liberalizuar vizat. Unë do t'i referohem pak fjalës së zotit Dardan Sejdiu. Të gjithëve, ama bash të gjithëve një nga një që kemi pasur takime me të huaj, me deputetë të huaj, me qeveritarë të huaj, na është thënë: po ju e meritoni liberalizimin e vizave, i keni plotësuar të gjitha kushtet, mirëpo na kuptoni që jeni vonuar me çështjen e demarkacionit dhe tash i kemi zgjedhjet e brendshme. Sikur ta kishit përfunduar më herët demarkacionin, vizat do të ishin liberalizuar 2018-tën dhe ne nuk do ta kishim pasur shqetësim çështjen e zgjedhjeve. Pra, kush ju ka ndalur ju ta kaloni, 88 vota i keni pasur. Për juve më me rëndësi ka qenë pushteti ta mbani me PDK-në sesa liberalizimi i vizave. Pse?

Tash po hyjmë pak te përmbajtja e kërkesës. Ta bëjmë pak më interesant, pak më të gjallë debatin. Po ndalemi te arsytimi i kërkesës. Pas dështimeve thotë të njëpasnjëshme të koalicionit qeverisës të cilat kulmuan me mosliberalizimin e vizave, pra kanë kulmuar, Kryeministri i Republikës së Kosovës bashkë me partnerët e tij të koalicionit po e fajësojnë Bashkimin Evropian për këto dështime. Ndalemi pak te kjo, a po e fajësojmë ne a e fajësoi zoti Hahn? A tha zoti Hahn që problemi është te na tash, topi është te ne, nuk është më te ju. Pra, jo që ne koalicioni qeverisës po bën përpjekje ta hedhë fajin te Bashkimi Evropian, por ata vetë po thonë: Hej, ne i kemi fajet, ne e kemi përgjegjësinë, por është çështje procedurash. Bile, bile siç tha zoti Hahn, kjo çështja e procedurave na qenka standarde se edhe Ukrainës kështu i paska ndodhur, kështu e tha. Pra ju jeni në afate për të cilat parashihen në kuadër të BE-së. Nuk është, konstatimi im është paragrafi i parë i pasaktë. Jo ne, ata po thonë që ne i kemi fajet.

Shkojmë te paragrafi i dytë. Dështimi për liberalizimin e vizave dhe anëtarësimin në Interpol po e kamuflojnë dhe po e plasojnë në opinion si dështim të Evropës. Në rastin e liberalizimit të vizave dhe të sigurisë globale në rastin e Interpolit. Po, a ka faj Serbia këtu? Se këtu po shihet te Interpoli veç Kosova i paska fajet. Serbia, hiç fa. Krejt po e thonë amerikanët, SHBA-të, ambasadorët, diplomatët krejt, juve, edhe neve na kanë thënë po është e vërtetë që lobi serbo-rus ka qenë më i fortë dhe na ka mundur, në rastin e Interpolit. Krejt po e thonë. Pra nuk po e themi ne, po e thonë ata dhe prandaj Kosova e shfrytëzoi të drejtën të vetëmbrojtjes duke aplikuar masën ndaj Serbisë, po më sulmon, po më vret, po më bllokun, të sulmoj përmes vetëmbrojtjes, të bllokoj. Pra ti po më bllokun atje ku mundesh, unë po të bllokoj atje ku mundem. Veç po them sa të pasakta janë arsyetimet për ftesën e kësaj seance.

Te i treti. Në anën tjetër, Qeveria aktuale ka dështuar totalisht në përmbushjen e agjendës së reformave evropiane. Bashkimi Evropian i thotë i keni plotësuar. Në emër të BE-së, zyrtarët e BE-së po thonë i keni plotësuar. Këta dalin tash në emër të BE-së thonë s'i keni plotësuar. Tash a bën ta dimë kush është i autorizuar, nuk e kam fjalën për deputetët e paautorizuar, nënshkrimet e paautorizuara, e kam fjalën kush është i autorizuar të flasë në emër të kujt? Në emër të deputetëve, secili grup parlamentar, në emër të BE-së, besoj që BE-ja është e autorizuar. E ata 22 deputetë sot që besoj shumë do të rritet numri i atyre që janë duke mbledhur nënshkrime për të kërkuar me çdo kusht futjen në rend dite të kësaj çështjeje, po thonë i ka plotësuar Kosova kushtet për liberalizim dhe nuk mundesh në temën e liberalizimit të vizave ta fusësh ti krejt agjendën evropiane. S'i keni plotësuar agjendën evropiane, era 1, era 2, ku ta di unë. Nuk mundesh ti sot, thirrë një seancë tjetër, për sa janë plotësuar kushtet apo sa është plotësuar rrugëtimi ynë drejt Bashkimit Evropian, ejani flasim, edhe i numërojmë pastaj edhe aktorët edhe fajtorët për këtë nivel që është mosplotësimi i kushteve.

Shkojmë te paragrafi i katërt. E gjithë kjo situatë ka krijuar mungesë të besimit të qytetarëve te institucionet e vendit dhe ka lëkundur besimin e partnerëve tanë ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës. E po tash kjo është relative. Ai qytetari që voton LDK-në, thotë s'jeni në rrugë të Zotit,

d.m.th. në rrugë të LDK-së. Ky i VV-së thotë ashtu, po këta të tjerët nuk po thonë veç ashtu, krejt s'po thonë ashtu. Edhe sondazhet po thonë aty diku 20-20, krejt të 20-ta, dikush shtatë, dikush tetë, dikush dhjetë. E për t'u matur, e nderuar kolege, Kushtetuta i rregullon afatet e matjeve. Nuk shkon ajo sa herë të humbësh, hajde të matim edhe një herë. E humba këtë lojë të shahut, po hajde po e nisim edhe një tjetër. Duhet të presësh, ka kohë. D.m.th. janë afatet aty. A mocionin qite! Zoti Konjufca mocionin qite, veç bëji 61 vota njëherë. Afatet kushtetuese janë katër vjet, a rrugët kushtetuese, mos i ngatërro rrugët kushtetuese me afatet kushtetuese. Mocioni është rrugë kushtetuese, kur të mundeni ta rrëzoni, hiç mos u ndalni.

Edhe për fund, bëni mirë që seriozisht tash kthehemi pak, se po keni qejf ta shndërroni në humor, por kjo nuk është humor, nuk është për hajgare. Tani mirë që së paku qytetarëve t'ju tregohet e vërteta dhe e vërteta sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave është se të gjithë njëzëri po e thonë Kosova i ka plotësuar kushtet për liberalizim të vizave. Unë nuk mundem as me këto, as askush nuk mundet t'ua zgjidh problemin e të majtës dhe të djathtës në Evropë apo frika e arsyeshme, e paarsyeshme e tyre.

Dhe, për fund, është pak paradoks dy parti, tri parti të djathta, 70 për qind, 80 për qind e Parlamentit e djathtë, Evropa krejt e djathtë, mos të mund t'i bindni sivëllezërit e juaj të na i liberalizoni vizat. Është pak paradoksale edhe kjo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Naser Rugova.

NASER RUGOVA: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të vendit,

Nuk kisha dashur që sot të flisja në këtë seancë dhe në rrethana të tjera do të doja që kjo seancë të mos thirrej fare për arsyen që është thirrur dhe do të doja që partneriteti i Republikës së Kosovës me Brukselin të ishte në relacione të një shteti të pavarur dhe sovran me mekanizmat e BE-së që është edhe synim, edhe objektiv i qytetarëve të Republikës. Por fatkeqësisht është një realitet tjetër. Kolegët e caktuar këtu po trumbetojnë që opozita i është gëzuar lajmit mbase më të keq në këto vitet e fundit që Kosova nuk është as në rend dite sa i takon çështjes së liberalizimit të vizave. Asnjë qytetar i Kosovës, asnjë subjekt politik, asnjë njeri i zgjedhur nuk do të donte që udhëheqësve të shtetit tonë, të shtetit tim, një nga përfaqësuesit e lartë të BE-së t'ju thoshte troç që lëre që nuk do të ketë këtë vit liberalizim të vizave dhe as që jemi në rend të ditës, po nuk do të ketë as vitin e ardhshëm, madje-madje e përmendi edhe vitin 2020. Sigurisht se deklaratat dhe vlerësimet e mekanizmave të caktuar të Bashkimit Evropian se kriteret janë plotësuar, në aspekte të caktuara kanë ekzaltuar pushtetarët, qeverinë aktuale dhe deklaronin me llogari të huaja se këtë vit qytetarët e Kosovës do të udhëtojnë pa viza. Kanë deklaruar madje që për 90 ditë do t'i liberalizojnë vizat. Por doli diçka tjetër dhe në politikë mbase nuk ka moral, po nuk paska moral, por ka politika të moralshme. Premtimet publike, fjalët publike, jo elektorale dhe paraelektorale,

por thënë nga burrshtetasit, nga krerët institucionalë, thjesht a kanë përgjegjësi këta njerëz. Në këtë kuptim, 22 europarlamentarët duhet t'iu bashkëngjitemi edhe ne, duhet ta dërgojmë një letër si Kuvend, Parlamentit Evropian dhe mekanizmave të tjerë relevantë për një padrejtësi të madhe, shkelje e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të lëvizjes së lirë, që Bashkimi Evropian po i bën të vetmit shtet në kontinentin e vjetër. Atëherë, cilat janë politikat e BE-së për integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe cila është tani qasja e BE-së ndaj Kosovës? Prandaj, ky është një mesazh për popullin e Kosovës, është një mesazh për klasën politike në Kosovës dhe është mesazhi më i mirë për këto institucione të Kosovës, se këta 15 muajt e fundit plot gojën e kanë pasur me premtime, me data.

Në fakt, zyrtarë të lartë të Bashkimit Evropian na e kanë tërhequr vërejtjen mos caktoni data, mos u lidhni për limite kohore, sepse mund të zhgënjeheni dhe kjo ndodhi. Por mesazhi frikësohem që është pak më i thellë dhe më substancial. Mesazhi i Bashkimit Evropian për qytetarët e Kosovës dhe për klasën politike është që jeni të obliguar të ndryshoni dhe të bëni reforma. Aq më shumë që jeni kaq të ngurtë dhe hezitoni t'i bëni ndryshimet e nevojshme do t'ju lëmë të izoluar. Dhe qytetari i Kosovës nuk ka faj. Qytetari i Kosovës nuk e meriton të ndëshkohet, qytetari i Kosovës nuk meriton të jetë i vetmi qytetar i këtyre shteteve të Bashkimit Evropian sepse tekefundit kontinenti i vjetër vetëm një shteti dhe vetëm qytetarëve të një shteti, qytetarëve të Republikës së Kosovës ua ka mohuar të drejtën e lëvizjes. Prandaj, është pak të kërkohet falje publik për ato deklarata të pamatura të tre krerëve institucionalë të vendit dhe është vërtet koha për durim, për urti, për koka të ftohta, për një analizë dhe një autokritikë të komplet institucioneve të shtetit.

Nuk dua të adresoj faje në emra të përveçëm, sepse ka ardhur momenti edhe politik, edhe kohor, edhe historik të bëhet kthesa e madhe, t'i dërgohet mesazh edhe Brukselit, që ato 100 e sa shtete që e kanë njohur Kosovën, përjashto pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian, duhet vërtet Kosovën ta trajtojnë si shtet të pavarur, si shtet sovran, si qytetar të një shteti dhe si shtetas të një shteti që është pjesë e kontinentit të vjetër.

Prandaj gjëja më e mirë është që kthesën e madhe ta bëjë legjitimiteti elektoral dhe qytetar. Këto institucione të japin dorëheqje, të krijohen ambiente normale elektorale politike, me konsensus të shkojmë tutje, ta caktojmë datën e zgjedhjeve dhe ta bëjmë kthesën e nevojshme sepse mjaft kemi humbur kohë. Me këtë logjikë qeverisëse, m këtë logjikë politike të këtyre partnerëve të koalicionit, frikësohem se Evropa do të na ndëshkojë dhe do të na mbajë të izoluar edhe për një kohë të gjatë. Prandaj është momenti më se i nevojshëm që spektri politik kosovar të ulet, të ndërmarrrë hapat e nevojshëm që të dalim nga këto barriera të padrejta që i bëhen Kosovës dhe qytetarit të saj dhe të ecim tutje, thjesht ta zhblllokojmë me alternativa politike dhe elektorale vendin nga kjo krahurë që e ka kapluar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Mexhide Mjaku e ka fjalën.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Lajmi për shtyrjen e liberalizimit të vizave nga diplomati Hahn ishte tronditës dhe tejet shokues për Republikën e Kosovës dhe për qytetarët e saj, të cilët akoma të izoluar Evropën e përjetojnë vetëm në imagjinatën e tyre. Duke bërë një krahasim të rrugëve të shteteve të tjera që e fituan liberalizimin e vizave dhe Republikën e Kosovës, ne e shohim se Evropa ka përdorur standarde të shumëfishta dhe fatkeqësisht në dëm të Kosovës. Neve zyrtarisht na është thënë se ju duhet t'i plotësoni 95 kriteret për përmbushjen e rekomandimeve, kriteret të cilat numerikisht janë më shumë se çdo shtet tjetër që i ka përmbushur. Kriterin e fundit të cilin zyrtarët më të lartë evropianë na obliguan ta përmbushim ishte ai i demarkimit të kufirit me Malin e Zi, të cilën institucionet tona e përfunduan me mund shumë të madh. Ishin po ata diplomatë evropianë, respektivisht Komisioni vlerësues i tyre, i cili erdhi në Republikën e Kosovës, i verifikoi nga afër të gjitha kriteret e përmbushura dhe u kthye në Bruksel me raport të qartë dhe u deklarua publikisht se Republika e Kosovës i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara nga BE-ja.

Ne kemi pritur krejtësisht një lajm tjetër për liberalizimin e vizave, e në asnjë mënyrë shtyrjen në pafundësi të këtij procesi. Evropa që për parim ka jodiskriminimin e popujve, fatkeqësisht me dy këmbë e ka shkelur këtë parim dhe kjo nuk ka sesi të shihet apo të rrëfehët ndryshe pos diskriminim. Diskriminimi ndaj një populli që me shekuj ka bërë luftë mbijetese dhe favorizim të atyre të cilët Ballkanit i shkaktuan vuajtje, tragjedi e mbi 350 mijë viktima në Kroaci, Bosnjë e Kosovë. Pse Republika e Kosovës dhe qytetarët e saj duhet t'i mbajnë mbi supet e veta problemet dhe paqartësitë në vendimmarrjen e vendeve të BE-së?

A duhet që BE-ja të tërë mllëfin e zgjerimeve dhe dhënies pa kriter të liberalizimit të vizave për shtetet me mbi 20 milionë banorë, sis është Rumania dhe të tjera, ta përdorë si frenim, sanksion apo korrigjim të gabimeve në një popull me 1 milion e 800 mijë banorë? Kjo më së paku është parimore, e drejtë dhe i shkon frymës së BE-së. Pse ne shqiptarët shihemi me aq sy kritik nga shtetet e BE-së? Ne si shqiptarë jemi kontribuues më të mëdhenj të zgjidhjes së problemeve kyçe të BE-së në dy shtete, të Malit të Zi dhe të Maqedonisë. Nën një, a nuk jemi ne shqiptarët të cilët u mobilizuar tërësisht në Mal të Zi, u detyruam tërë diasporën tonë për të ardhur në Mal të Zi dhe për të kontribuar me votën tonë në votimin e referendumi të pavarësisë, për pavarësinë e Malit të Zi, i cili referendum falë votave të shqiptarëve kaloi, duke iu bërë mur politikave pansllave të depërtimit në Adriatik. Në anën tjetër të medaljes, të kundër-referendumi ishin shteti serb, i cili me tërë qenien e vetë e luftoi suksesin e këtij referendumi, duke i siguruar pozicion Ruisë për dominim në Ballkan. BE-ja këtë ia shpërbleu me vendim për liberalizim të vizave. Nën dy, a nuk jemi ne shqiptarët në Maqedoni, me votën e të cilëve kaloi referendumi për ndryshimin kushtetues në Maqedoni? Hapjen e rrugës për ndryshimin e emrit të Maqedonisë dhe futjen e këtij shteti në NATO, e kjo nënkupton ndërprerjen e hijes së ndikimit të politikave ruse në Ballkan.

Evropa ndaj shqiptarëve është treguar mosmirënjohëse duke përsëritur historinë mosmirënjohëse, njëjtë sikurse edhe për kontributin që dha Gjergj Kastrioti-Skënderbeu në shpëtimin e krishterimit evropian nga invazioni i Perandorisë Otomane para 600 vjetësh. Ne si deputet normal shprehim shqetësimin tonë dhe zhgënjimin e madh të qytetarëve tanë që përkundër deklaramit publik të BE-së dhe raportueses Tanja Fajon për plotësimin e kriterëve për liberalizimin e vizave, ju me kryeneçësi na dënuat, na latë të izoluar. Ne si vend i vogël nuk mund të ndikojmë në fuqizimin e unitetit dhe vendimmarrjes brenda për brenda BE-së, sepse nuk jemi pjesë e saj. Por, ne kemi hapur dyert dhe zemrën dhe kemi pranuar diplomatë nga të gjitha vendet e BE-së dhe madje edhe nga ato pesë vende të BE-së të cilat nuk e kanë njohur Kosovën. Problemet brenda për brenda jush që dita-ditës po shpërthejnë si dalja e Britanisë nga BE-ja, problemet monetare me Greqinë, me Spanjën, me Italinë, nuk duhet ta nxisin egon për ndëshkim ndaj popullit tonë, ndaj popullit shqiptar.

Ndoshta për të pasur konsideratën e vendeve të BE-së, ne është dashur ta përdorim politikën sikurse Serbia, ndoshta këtu kemi gabuar, por ne kemi edhe një gabim dhe ky gabim është thellë në qenien tonë, gabim të cilin po e shpërfaqim shumë nga partitë politike dhe deputetët vetëm për të marrë poenë politike brenda e jo për të qenë të bashkuar kundër një diskriminimi që po i bëhet popullit tonë nga jashtë. Ne patëm konfirmimin zyrtar për plotësimin e kriterëve, pse ne duhet të gjejmë fajin te ne? Ne i kemi plotësuar kushtet. Kjo është e papranueshme prej të gjitha partive dhe deputetëve të cilët fajin për mosliberalizim të vizave tentojnë ta gjejnë brenda nesh. Andaj ju apeloj që mos ta kërkojnë fajësinë te institucionet tona, por fajësia është gjetiu te vendet e BE-së dhe politika diskriminuese që ata i bëjnë ndaj nesh. Uroj që vendet e BE-së më në fund do të zbresin në standardet e tyre të proklamuar dhe shqiptarët t'i shohin me të njëjtit sy siç i shohin edhe popujt e tjerë. Ne jemi gjeografikisht Evropë, gjenetikisht Evropë, dhe kulturallisht Evropë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zonja Mjaku! Fjalën e ka zonja Fatmire Kollçaku.

FATMIRE KOLLÇAKU: Faleminderit!

Fillimisht është shumë për keqardhje që duke shikuar kështu përpara nuk po e shoh asnjë anëtar të kabinetit qeveritar. Fillimisht zonja ministre, zonja Dhurata sonte do të duhej të ishte këtu me ne, meqenëse në shumë takime kur e kemi ftuar më herët, kur ne si opozitë ishim shumë kritikë, ajo ishte aq shumë optimiste, saqë ishte dashur të ishte sonte këtu dhe së paku të na sqarojë atë çfarë tha Komisionari Hahn. Ndoshta ajo ende dikush ndonjë optimist siç jemi disa këtu optimistë ashtu të papërmirësueshëm, ndoshta edhe mund të shpresojë që do të ndodhë ndonjë çudi apo mrekulli që si dhuratë e Babadimrit të na sjellë dikush liberalizimin me rastin e festave të fundvitit, por çdo njeri që ka së paku logjikën kështu mendoj siç duhet, e di që tashmë edhe viti 2020 do të jetë kështu shumë optimistik, bazuar në të gjitha rrethanat, edhe të gjithë atë çfarë do të pritet të ndodhë në Parlamentin Evropian, zgjedhjet, pastaj kush do të vjen aty, cilat rryma

dhe fare a do të jetë interesante çështja e liberalizimit të vizave sa i përket Republikës së Kosovës.

Do të thotë ajo çfarë u tha dje kur u përmend viti 2020, megjithatë u tha mos u kapni shumë për data, që do të thotë që edhe ajo datë nuk do të jetë fare e sigurt. Kujt a ka sot dikush, a do të jap dikush përgjegjësi, a ndihet dikush fajtor në këtë vend dhe thjesht kush ishin ata që jepnin data? A mund të thotë dikush sonte këtu që qoftë edhe një zyrtar evropian ka përmendur ndonjëherë datën e liberalizimit të vizave për ne? Jo. Besoj që asnjë nuk mund ta konfirmoj qoftë edhe një zyrtar i cili ka përmendur një datë për liberalizimin. Deri dje kur për herë të parë u përmend viti 2020. Ndërsa çfarë ka ndodhur me zyrtarët këtu, që tërë vitin kanë trumbetuar që fundi i vitit do të jetë kur qytetarët do të kenë mundësi të lëvizjes së lirë? Të mos themi që dhjetë vjet më herët ka filluar kjo temë, nga të njëjtit njerëz. Do të thotë këtu u tha që vitin 2008 kanë filluar të flasin për liberalizim të vizave dhe tashmë jemi një dekadë më vonë dhe jemi ku jemi. Do të thotë, mungesa e Kabinetit qeveritar këtu e tregon joseriozitetin e skajshëm karshi një teme aq të rëndësishme për qytetarët e Republikës së Kosovës, mirëpo për dallim për një nga deputetët tjerë kur thotë se qytetarët nuk janë fajtorë... Po, po! Edhe qytetarët janë fajtorë. Se qytetarët me votën e tyre vendosin se kush do t'i udhëheqë. Dhe pjesa e qytetarëve që i kanë votuar këta njerëz që sot nuk dalin këtu dhe nuk vijnë të japin përgjegjësi, janë po ashtu fajtorë.

Është e pasinqertë të thuhet se qytetarët e meritojnë lëvizjen e lirë, qytetarët janë të pafajshëm, sepse të gjithë ata që e kanë dhënë votën për këta pushtetar duhet të ndihen bashkëfajtor.

Praktika e mosdhënies së përgjegjesisë po vazhdon, por një gjë është e qartë, dështimi i plotë në politikën e jashtme është i bashkëngjitur me dështimin e plotë në planin e brendshëm. Ju e dini që sot i kemi tre zyrtarë më të lartë shtetëror të cilët veprojnë me agjenda komplet të ndara.

Njëri e ndje njëren agjende, tjetri shkon me aventurë personale dhe lobon për tjetër gjë, ndërsa kryeparlamentari fut në agjendë atë që e sheh të arsyeshme dhe është shumë vështirë për opozitën që një çështje ta fut në rend të ditës dhe kryesisht në orët e vona, kur thënë të drejtën edhe përqendrimi edhe interesimi i qytetarëve nganjëherë bie dhe është qëllimi që asnjë çështje të mos shtyhet deri në fund. Asnjë çështje të mos votohet. Të shtyhen seancat e radhës dhe nuk e kemi më asnjë agjendë të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ne si deputetë më nuk e dimë se a dihet dita kur mbahen seancat apo thjeshtë këto ad hoc seanca janë bërë një praktikë e orëve të vonë, ku nuk ka vendimmarrje.

Po thuhet se janë përmbush kriteret. Dhe a dini se çfarë është kjo? Si të themi ne se operacioni ishte i suksesshëm, por pacienti vdiq. Dhe ne tash s'po merremi që ai vdiq, po ne po themi se operacioni ka qenë i suksesshëm.

Do të thotë ne nuk po shikojmë ku jemi ne keq që nuk po ndodh. Ne jemi në fazën kur 27 vende të cilat tani duhet të vendosin, po hezitojnë. Dhe pse po hezitojnë? Pse aleatët e deridjeshëm, pse ata që deri dje ishin shumë më miqësorë karshi neve, tash po ndërrojnë qëndrim? Po si mos të ndërrojnë qëndrim kur, mos harroni se ka raporte që publikohen po ka edhe raporte joformale, sepse në këtu bashkëjetojmë me shumë zyrtarë të vendeve të ndryshme, dhe ata raportojnë në vendet e tyre për krimin dhe korrupsionin institucional për ndarjen e haraçit. Raportojnë për ministrat me aktakuza të cilët kurrë nuk kanë dhënë përgjegjësi. Raportojnë për dënimet që parashkruhen për zyrtarët.

Dy-tri vite ikë prej vendit dhe atij i parashkruhet dënimi dhe ai kthehet këtu pa asnjë faj. Do të thotë askush më nuk merret me të. Ndahen mes subjekteve politike postet më të larta nëpër borde. Na sugjerohet që të mos zgjidhet ai njeri se ka aktakuza, është i dënuar, shkon e vendos në borde, udhëheqës të bordeve. Njerëz total të paaftë i vendos në pozicione më të larta. Asnjë përvojë pune nuk e ka, shkon bëhet...

Thjesht, zyrtarëve më të lartë shtetërorë nëse u shikohet CV-ja, ke çfarë sheh. Dhe thjesht, po ju them që ne si Komision për Integritet Evropian, fillimisht po ju them që fare nuk kemi qenë të përfshirë në lobim sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave. Do të thotë të anashkaluar plotësisht.

Mirëpo, edhe ne ato takime të pakta që kemi realizuar me diplomatë të vendeve të huaja, tua them drejtën si të themi sot ka qenë ministria në takim dhe na ka thënë plotësisht diçka tjetër, dhe të nesërmen vjen ambasadori i shteteve më vendimmarrëse, po mendoj shteteve mike që i kemi këtu në Evropë, dhe na e përplasë në fytyrë realitetin. Dhe nuk na kanë thënë që i keni përmbush. Nuk na kanë thënë i përmbush kriteret, sepse kriteri kryesor nuk është i përmbush, përkundrazi gjatë këtij veti është shënuar regres në përmbushjen e kriterit kryesor që është lufta kundër krimit të organizuar institucional, lufta kundër korrupsionit.

Provat për këtë po i japin çdo ditë. Bile nëse e them të drejtën edhe nuk po brengosen që ta fshehin shumë këtë. Vetëm pak nëse hulumtoni lirisht mund të hasni, aferat korruptive janë sekrete publike.

Prandaj, ne duhet tash ta kuptojmë, edhe qytetarët, ta kuptojmë që ëndrrat që të iket nga ky vend, duhet t'i lëmë dhe duhet t'i kthehemi asaj sesi ne t'i kryejmë detyrat pa u marrë me data. Problemi është këtu në vend.

Unë po e them, ne të gjithë e dimë që dalja nga kjo situatë janë zgjedhjet. Nuk po dua që sonte të flas më shumë për zgjedhjet, mirëpo po dua të them që kjo klasë aktuale, këta pushtetarë më nuk janë kredibil. Pikërisht, sikur të kishin pak fytyrë, sonte do të uleshin këtu përballë nesh, do të dilnin në foltore për të na u kundërpërgjigjur neve me argumente, nëse kanë. Dhe të dalin para

qytetarëve dhe të thonë se cila është arsyeja që shtetet që deri dje kanë folur shumë më pozitivisht, sot po hezitojnë.

Nëse e them të drejtën, për shembull, ligjet që ne i kemi miratuar si kriter për agjendën evropiane dhe çështjen e liberalizimit, duke e parë që nuk do të zbatohen se me kalimin e kohës do të shtohet kriter, zbatoheni ligjin. Kriter ka qenë që të miratohet ligji, dhe nesër do të jetë kriter që të zbatohet ligji.

Andaj, do duhej që të vijnë këtu dhe të deklarojnë se pse ndodhi kjo që premtimet nuk i kanë mbajtur. Dhe, zonjës Dhurata po i them që ma ka obligim të ma qerasë një kafe, sepse publikisht më ka ftuar që unë ta qeras, sepse ka deklaruar që në fund do të ndodhë liberalizimi, prandaj po më dhimbset që do të shpenzohet 1 euro, por po e ftoj publikisht që të ma qerasë një kafe, se nuk po gëzohem as unë që nuk po ndodh liberalizimi.

Edhe mua më vjen keq si të gjithë qytetarëve, por megjithatë unë jam shumë më komode se nuk e kam votuar këtë Kabinet qeveritar, këtë Qeveri dhe këta pushtetarë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Topalli. Atëherë, fjalën e ka zoti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesues!

Ne patëm sot dy seanca të jashtëzakonshme. Ende nuk e kemi të qartë se çfarë është bërë me seancën e parë të jashtëzakonshme. Prita nga kryesuesi që së paku me ndihmën e stafit të vet ta kuptoj se çfarë është bërë me atë seancë? Çka është bërë me ato nënshkrime të falsifikuara? A ka vend për vepër penale?

Ngase nëse nuk japim ndonjë përgjigje, mund të shtyhen vizat edhe për 2022-tën, problem e kemi. Pra, nuk e di edhe qytetarët, po edhe ne kemi nevojë që të kemi sqarime se çka është bërë me nënshkrimet e falsifikuara.

Kur subjekte politike nënshkruajnë në formën e falsifikuar ose prezantojnë nënshkrime të falsifikuara për të thirru seancë të jashtëzakonshme, atëherë dihet se diçka po ju ngutet shumë.

Pikëpyetja po ju ngutet që ta prishin çështjen e dialogut. Ne patëm një rezolutë për dialogun. A ka të bëjë me çështjen e ushtrisë, unë nuk e di saktë, por kjo nguti është e çuditshme.

Kurse sa i përket liberalizimit të vizave, unë vërtetë nuk e njoh Ukrainën ose di shumë pak edhe për Gjeorgjinë, edhe për disa vende të tjera që e kanë fituar liberalizimin e vizave, po di diçka për Bullgarinë. Edhe ajo ka fituar liberalizimin e vizave. Paska hyrë edhe në BE.

Di diçka për Rumaninë, së paku prej historisë. Edhe në kohë e sotme dimë çdonjëri diçka për Rumaninë. Edhe Rumania ka fituar liberalizimin e vizave. Ka hyrë edhe në BE.

Të gjithë dimë mjaft shumë për Serbinë. Kur Serbia me kryeministër, Koshtunicë e Vuçiq, e çka janë këta Daçiqa e Milosheviqa e çka janë edhe fitojnë liberalizimin e vizave.

Kur një Maqedoni me një qeverisje të Gruevskit fiton liberalizim të vizave. Po edhe Shqipëria fiton liberalizim të vizave para neve, ne duhet ta pyesim se çka nuk është në rregull. Ose ta pyesim edhe BE-në nëse janë në rregull ose jo.

Unë po mendoj që është një formë e shantazhit. Personalisht po mendoj që ka të bëjë edhe procesin e dialogut. Duhet ta sqarojmë këtë çështje, sepse nuk ka kuptim të pritët.

Dikush i përmendi kryeministrat. Unë mund të them se edhe kryeministrin që e ka pasur LDK, zotëri Isa Mustafa ka qenë shumë më i mirë se kryeministrat dhe qeveritë e këtyre vendeve. Edhe kur kryeministër ka qenë Hashim Thaçi, ishte shumë më i mirë se qeverisja e këtyre vendeve. Pra, këtu s'ka të bëjë me qeverisjen, po ka të bëjë me shantazhin që ka të bëjë me dialogun.

E përmendi dikush demarkacionin. Edhe unë po e pranoj që ka qenë një formë e shantazhit. Tash kemi një shantazh tjetër, që ne duhet të përgatitemi së bashku sesi ta përballojmë, ka të bëjë me dialogun. Ose ka të bëjë me qytetërimin tonë. Kulturën tonë, traditën tonë, të kaluarën tonë.

Duhet të ulemi edhe të bisedojmë BE-në ndryshe. Sepse, të vijë dikush dhe të thotë që ju i keni plotësuar kushtet, të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave edhe të thuhet; nuk ua japim liberalizimin e vizave, atëherë duhet të ndryshojë komplet qasja në raport me BE-në. Jo të prishen raportet me BE-në, po duhet t'i shqyrtojmë dhe ta kuptojmë qartë se çka po dëshiron. Të dilet para popullit dhe të thuhet; po e dëshiron këtë, këtë, këtë. Dhe jo vetëm për liberalizimin po edhe elementeve të tjera që kanë të bëjnë me anëtarësimin në agjendat ndërkombëtare.

Kam të bëjë edhe me diçka tjetër. Më habiti zoti Hoti. Zoti Hoti e bëri një hyrje shumë interesante që u pa që nuk është çështja e liberalizimit të vizave se edhe qytetarët e dinë, edhe mirë e dinë, që ju personalisht jeni fajtor për çështjen e msoliberalizimit të vizave. Së paku në kohën tënde, sa ke qenë në pushtet, nuk i ke plotësuar kushtet dhe së paku kjo ka qenë e evidente.

Po, ka të bëjë me buxhetin. Thatë që kjo Qeveri ka investuar 30% në komunat e Aleancës, s'e di zoti Hoti a di që Aleanca nuk i ka më dy komuna po i ka tetë komuna. Nuk e di a di që investimet kapitale, vetëm 1/3 janë buxhete të reja, 2/3 fillojnë 2017 dhe 2018. Pra, buxhete të reja në buxhetin e vitit 2019, investime kapitale kemi vetëm 1/3. Normalisht që ju e dini, por këtu e dimë që je demagog së paku në këtë kuptim, në hyrjen që e bërë mos na shit demagogji.

Pra, ju e dini shumë mirë që vetëm 1/3 janë investime të reja për vitin 2019, pra investime kapitale, ndërkaq thoni se 33% e buxhetit për investime kapitale shkojnë për komunat e Aleancës. Nuk është fajtor Suhareka që më nuk është LDK. Nuk është fajtor as Rahoveci që tash është AAK. Ato buxhete janë përcaktuar në vitet 2017, 2018, 2019.

Nuk është fajtor as Ardian Gjini që ka fituar në Gjakovë. Jo, në zgjedhje mos fillo, ti kur të na thërrasësh neve për çështjen e liberalizimit të vizave, atëherë flisni për liberalizimin e vizave. Merre përgjegjësinë edhe për vete edhe për kohën tënde. Në vend se të qani dhe thoni se pse nuk e kemi bërë në vitin 2010, tani më thua pse nuk e kemi bërë në 2018 për 1 vit.

Së paku ne arritëm diçka që të thuhet se, ju u i plotësuar kushtet. Tash ne duhet ta shohim me BE-në se çka duhet të bëjmë ne që ta marrim këtë liberalizim vizash. Ngase kushtet i paskemi plotësuar.

Jo, unë e thashë që Isa Mustafa është më i mirë se Daçiqi këtë e pranova, sidomos në këtë aspekt është më i mirë, sepse qeverisja ka qenë më e mirë në kohën e Isa Mustafës sesa Daçiqit edhe Koshtunicës normalisht, por edhe të Gruevskit normalisht. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti ka replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

E para, për nënshkrimet për seancë. Në seancën e orës së kërkuar, në orën 16:00 janë dorëzuar 42 nënshkrime me një gabim teknik që ka ndodhur, duke iu bashkuar listës së nënshkrimeve edhe dy deputetë të nënshkruar shumë më herët. Është sqaruar me ata dy deputetë. Kanë dorëzuar shkresë zyrtare ata dy deputetë, dhe kemi dorëzuar shkresë zyrtare edhe ne në Kryesi, por Kryesia nuk deshë që ta procedojë. Ne dorëzuam edhe njëherë nënshkrimet e të gjithë deputetëve tjerë, pra 40 nënshkrime të depozituara.

Tash, unë prita nga zoti Kuçi që ta mbajë fjalën. I ka shtirë fjalët fort për çështje të liberalizimit të vizave. Pavarësisht se çka ndodhë, unë pres që ai ta mbajë fjalën.

Mos të harrojmë, kjo çështje do ishte kryer dhe do të ishte harruar para tri vitesh sikur partia e zotit Kuçi të sillej siç po sillet opozita e sotme, pa gaz dhe pa dhunë. Atëherë koalicioni kishte 87 vota, por 77 kanë qenë që e kanë votuar që do ta kishin votuar demarkacionin. Nuk kemi llogaritur, siç nuk keni llogaritur as ju në votat serbe. Pra, asnjëherë nuk ka mundur që të kalojë demarkacioni pa mbështetjen edhe të opozitës së atëhershme.

Dhe e fundit, tek buxheti. Unë në fjalën time e thashë, bazuar në analizat e institut GAP, komunat e AAK-së për kokë banori marrin buxhet i cili është i planifikuar për vitin 2019, trefish më shumë sesa komunat që udhëhiqen nga LDK ose nga partitë tjera. Kjo është e vërteta.

Të enjten do ta kemi buxhetin, kemi mundësi që të shkojmë në detaje. Unë e lus zotin Kuçi që të përmbahet nga fjalori fyes që e përdori. Unë asnjëherë nuk e fyej askënd dhe unë kërkoj që secili ta respektojë mendimin ndryshe. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë, zoti Kuçi!

BLERIM KUÇI: Faleminderit!

Unë thashë që këto seanca disi po më ngjajnë që duan ta prishin atë koordinim që ka të bëjë me çështjen e dialogut edhe të ushtrisë. Intenca e këtyre seancave në këtë formë, po më duket kështu dhe bindja ime është kështu.

Kur të votohet ligji për ushtri, bisedojmë edhe për dorëheqjen time edhe tënden. Mirëpo, me genë ministër i Financave edhe të thuash diçka të pavërtetë, aq të pavërtetë nuk ka kuptim.

Ju shumë mirë e dini që 1/3 e investimeve kapitale janë investime të reja për vitin 2019. Shumë mirë e dini që 3/4 e tyre kanë filluar në vitin 2017. Edhe kur e di që e dini këtë, për këtë arsye unë i përpjeka që të tregoj.

Është një thënie e cila thotë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Unë nuk dua të flas për konstatimet e mbledhjes së Kryesisë, sepse ato u bënë publike, por ajo që unë e konsideroj të mirë është që përfundimisht merr fund formulari me nënshkrime blanco që u jepen kryetarëve të grupeve parlamentare.

Secili deputet duhet të nënshkruaj për vete.

Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesues!

Unë kam filluar çdo ditë e më shumë të bisedoj edhe me njerëz, po edhe të besoj vet në atë përrallën magjike të presidentit Thaçi, për ridizajnimin e kufijve.

Pse e them këtë? Kurrë në jetë nuk kisha besuar ndonjëherë që Lëvizja Vetëvendosje bëhet bashkë me LDK-në. Për arsyes se vazhdimisht edhe me shumë të drejtë sipas konceptit të cilin ata e kanë, edhe sipas modelit të Vetëvendosjes, Malit të Zi u janë dhënë 8200 hektarë, edhe këtu është bërë një tradhti kombëtare.

Ti mund të bisedosh me një mashtrues, mund të bisedosh me një gënjeshtar, mund të bisedosh me një hajdut, por asnjëherë nuk mund të bisedosh dhe të bashkëveprosh në asnjë rrethanë historike dhe politike me ata të cilët e kanë shkëlur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe e kanë tradhtuar vendin. I kanë dhënë 8 200 hektarë Malit të Zi. Kjo është shokante, kjo është amorale, e para.

E dyta, sikur ne si deputetë të Parlamentit të Kosovës ta kishim treguar 10% e dashurisë ndaj Kushtetutës së vendit tonë. Dashurisë ndaj respektit, tolerancës dhe atyre gjërave që na bashkojnë në politikën e jashtme, aq sa tregon dashuri, e shikoja sot me shumë respekt qenin e Xhorxh Bushit, ne do ishim në një situatë krejt tjetër.

Sot kemi ardhur në një situatë kur vërtetë as nuk po e dimë në Parlament se pse kemi ardhur në këtë seancë të jashtëzakonshme, dhe edhe pozita edhe kolegët e mi, Ahmet Isufi për shembull nga AAK-ja, nuk pati kurajën që të flas me emër e mbiemër se kush çka ka thënë në Bruksel para njerëzve të Brukselit për mosliberalizimin e vizave.

Kryetari i Parlamentit na foli këtu me rrotulla e nuk tha që falsifikimi i nënshkrimeve është vepër penale, dhe si mundet dikush të dalë dhe t'i thotë qytetarit të Kosovës që ne e kemi thirrur një seancë të jashtëzakonshme për një shqetësim të jashtëzakonshëm për izolimin që padrejtësisht po na e bën Brukseli me nënshkrime false.

Të paktën dy deputetë e kanë thënë publikisht; Ilir Deda dhe Mimoza Kusari, që na janë falsifikuar nënshkrimet, na janë keqpërdorur nënshkrimet. Kjo ishte e para.

E dyta, nuk mund të bëhet kurrë bashkë Lindja me Perëndimin. Dielli lind dhe perëndon në një pjesë krejt tjetër të kontinentit. Unë nuk besoj kurrë, kurrë, kurrë që prapë se prapë Lëvizja Vetëvendosje mund të koordinohet me Lidhjen Demokratike të Kosovës, për arsye se Lidhja Demokratike e Kosovës e ka 100% këtë debat vetëm që t'i hedh hi elektoratit.

Ndërsa, Lëvizja Vetëvendosje e ka ndjekur këtë kauzë, vazhdimisht e ka ndjekur dhe ka qëndruar. E vetmja gjë që mua më shokon dhe më befason është afrimi i tyre. Ndërsa, kauzën për mendimin tim gjithmonë, e kanë të drejtë.

Nuk ka veprim të dëmshëm për liberalizimin e vizave të cilin nuk e ka bërë Lidhja Demokratike e Kosovës bashkërisht me Partinë Demokratike të Kosovës dhe bashkërisht edhe me opozitën edhe me AAK-në që në atë kohë kanë qenë kundër detyrave të cilat i ka dhënë Brukseli për Qeverinë e atëhershme të Kosovës.

Prandaj, mbi bazën e kësaj, ne të gjithë që jemi sot në Parlament e kemi shumë të vështirë që ta flasim të vërtetën se cilët janë faktorët që kanë ndikuar për mosliberalizimin e vizave.

Unë personalisht, aq sa e njoh politikën evropiane dhe aq sa kam pasur takime me burokratët e Brukselit, është vetëm një e vërtetë shumë tragjike; Brukseli e ka dënuar popullin e Kosovës vetëm për shkak të përkatësisë fetare. Ky është faktori numër një. Këtë ua kam thanë ambasadorëve, edhe ambasadorit gjerman edhe ambasadores holandeze, Blerta ka qenë aty. Burokratët evropian të cilët nuk guxojnë kurrë, kurrë në takime, deri t'i pinë diku 6 ose 7 gota raki, të thonë që i urrejnë vendet të cilat kanë përkatësi myslimane. Dënimin Kosovës dhe Shqipërisë po ua bëjnë vetëm këtë. Kjo është e para.

E dyta, dënim numër 2 është se ne i kemi plotësuar vërtetë kriteret, 95 kritere që na i ka kërkuar Bashkimi Evropian, po ata nuk janë budallenj, e tha një deputet këtu, nuk janë budallenj, e dinë edhe ata jetojnë këtu, që problemi i korrupsionit dhe krimit të organizuar në Kosovë është njëri ndër problemet më shqetësuese.

Por, Qeveria e Kosovës, Qeveria aktuale që është në krye me kryeministrin Haradinaj, të paktën i ka plotësuar këto kritere. I ka plotësuar këto detyra të cilat kanë qenë të përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Kur po them te korrupsioni, e kam fjalën pikërisht për Parlamentin. Ndër institucionet shumë të korruptuara e mos të them më i kuptuari në Kosovë, është Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Unë habitem sesi disa herë e kam përmendur dhe keni heshtur ju kolegë deputetë, çështjen e makinave. Po e përmend kontratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ka marrë 10 makina me qira, Pezho 508, ku këto 10 makina u kushtojnë qytetarëve të Kosovës 6 mijë euro në muaj, 60 mijë euro në vit, ndërsa kontrata e cila është bërë, u kushton taksapaguesve të Republikës së Kosovës 330 mijë euro për 66 muaj.

Më tregoni ju, me 330 mijë euro sa makina do t'i kishte blerë Parlamenti i Kosovës dhe të ishin pronë e Parlamentit të Kosovës, më tregoni ju sa çerdhe të fëmijëve në Republikën e Kosovës i kishim ndërtuar me 330 mijë euro. Sa, rrafsh dhjetë. Dhjetë çerdhe nga 30 mijë euro, po edhe gjysmë çerdhe të bëhej, kurrfarë nevojë nuk keni pasur të merrni makina me qira, hiç, kurrfarë. Gjysmë çerdhe e kisha bërë e vetura nuk kisha marrë, po hipni kalit e mos i zbritni hiç, veç vazhdoni ju, nuk është kurrfarë problemi. Po unë jam duke folur për qytetarët e Kosovës që të dinë se çfarë deputetësh jemi. Krejt partitë politike, duke përfshirë Partinë Socialdemokrate atje që Vetëvendosja nuk ua ka dhënë paratë, krejt e keni buxhetin, duke përfshirë edhe partinë time, e ne kemi mundur të blejmë veturën me paratë tona, nuk kemi pasur ne nevojë të marrim kurrfarë parash prej taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

Në fund mendoj që edhe njëri prej faktorëve që e kanë hequr liberalizimin e vizave nga rendi i ditës kanë qenë përrallat të cilat erdhi në Pejë edhe na i tregoi Edi Rama. Erdhi aty, veç që s'e mori ai tupanin dhe defin me hallën Fazë dhe të dalë atje e të thotë ne jemi për këtë, ne jemi për

këtë, edhe aq shumë u frikësua Brukseli prej këtyre llafeve tona, sa që menjëherë e hoqën prej rendit të ditës çështjen e liberalizimit të vizave.

Edhe Hanin aq shumë e kemi bërë nervoz e aq shumë e kemi frikësuar, sa që me byrek me djathë e me gjizë u kthye në Bruksel.

Lëne, se ne ta kërcënojmë Brukselin jemi sikur ta kërcënojë miza elefantin. Hajde të merremi me detyrat tona të shtëpisë, të bëhemi bashkë pozitë dhe opozitë, ta ndërtojmë një platformë dhe të shkojmë në Bruksel bashkërisht. E kam thënë në këtë foltore dhe prapë po e them, për mua do të ishte nder të udhëheqë dialogun në Bruksel qoftë Lëvizja Vetëvendosje, qoftë Partia Socialdemokrate, qoftë Lidhja Demokratike e Kosovës, çfarëdo partie vetëm për hir të interesit të përbashkët të shkojmë në Bruksel bashkërisht. Kaq kryesues, faleminderit që nuk ma ndale fjalën sot.

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk e ofendove askënd. Zoti Hoti, e ka fjalën për replikë.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kemi gati 30 vjet në përpjekje tona për shtet të Kosovës, ka 10 vjet shtet të pavarur, asnjëherë në këtë Kuvend ose në politikën kosovare nuk e ka akuzuar askush Evropën që po e diskriminon Kosovën, nuk po e përkrah mbi baza të religjionit.

LDK-ja është anëtare e partive popullore evropiane, unë e kam emrin Avdullah, Ismeti, Luta, Armendi e të tjerë, çdo tre muaj jemi në takime të EPP-së, ku janë prej kancelares Merkel e deri te parti në të gjitha vendet e BE-së dhe kurrë, asnjëherë askush nuk e ka ngritur një çështje që ka mundur të kuptohet që po diskriminohen qytetarët e Kosovës në baza të religjionit.

Unë dëshiroj që të mos dëgjoj akuza të tilla më në Kuvendin e Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Kundër-replikë ka zoti Zeka.

MILAIM ZEKA: Unë, zoti kryesues, për fatin e keq prej viti 1982, 19 shkurt 1982, kam jetuar në Evropë dhe unë jam shumë i sigurt dhe i qartë se çfarë flas. Ekziston një racizëm i çmendur në Bashkimin Evropian kundër myslimanizmit dhe kundër vendeve myslimane, dhe përkundër asaj që ne duhet ta ndërtojmë shtetin tonë, unë prapë po e them që njëra prej arsyeve për mosliberalizimin e vizave dhe izolimin e Shqipërisë është pikërisht feja myslimane. Po unë nuk i frikohem se ti e ke emrin Avdullah, edhe unë e kam Milaim, babagjyshi im ka qenë hoxhë, unë tash s'mund të bëhem dy herë katolik, një herë kam qenë, prej katoliku jam bërë mysliman dhe mysliman jam.

KRYESUESI: Zoti Konjufca e ka fjalën, replikë.

GLAUK KONJUFCA: Unë mendoj që ne nuk kemi edhe liberalizim të vizave, ndër të tjera edhe për një arsye, për shkak që njerëzit që falsifikojnë viza në Kosovë, jo vetëm që shëtisin të lirë prej drejtësisë, po bile edhe bëhen edhe deputet në Kuvend të Republikës së Kosovës, kjo e dëmton pa masë liberalizimin e vizave. Ashtu qysh e ka dëmtuar edhe vjedhja për pasaportat, 5.3 milionë euro korrupsioni.

Të gjitha këto, edhe deputetët që falsifikojnë viza, ata i lexojnë, i këqyrin dhe kjo është e patolerueshme për Bashkimin Evropian.

Unë e kuptoj krejt çka foli deputeti paraparak, për arsye se ky tash aq është në zor prej drejtësisë sa që të shpëtojë mendon që kjo zgjidhet duke ua bërë qefin atyre prokurorëve të Presidentit e duke e sharë opozitën. Mendon që kështu mund të shpëtojë prej drejtësisë. Ama krimet e tij janë të mëdha dhe evidente, nuk do të mund t'i zgjidhë më as me korrupsion, as nëse e korrupton ndonjë gjyqtar apo ndonjë prokuror, do të përfundojnë shumë keq.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani fjalën e ka zonja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është interesant se si po fillojnë bisedimet e kolegëve deputetë, si po fillojnë fjalimet e kolegëve deputetë të koalicionit qeverisës.

Asnjëri prej tyre nuk po e fillon fjalimin duke treguar se kanë dhënë premtime që nëse nuk liberalizohen vizat do të japin dorëheqje apo të nisen nga premtimi kryesor i kryeministrit që në shtatorin e vitit të kaluar kur mori pushtetin tha se brenda tre muajsh do të liberalizohen vizat.

Në fakt, jeni specializuar shumë për propagandë dhe kjo po ju 'dhez' shumë.

Sot na keni akuzuar për falsifikimet e nënshkrimeve, gjë që nuk është e vërtetë. Dy deputetë të Alternativës kanë qenë pjesë e Grupit Parlamentar të LDK-së, jo LDK-ja, po të gjitha grupet parlamentare në këtë Kuvend punojnë me listat e nënshkrimeve, sepse shpesh deputetët janë larg dhe nuk mund të thirren për çështje urgjente për të dhënë nënshkrimet.

Nënshkrimet ne i kishim në listë, nuk kanë qenë falsifikim, ka qenë gabim teknik pse i kemi përfshirë derisa ata nuk janë në grup.

Nëse sot Kryesia ka vendosur që të mos punojmë me lista të tilla, atëherë shumë mirë.

Po një thirrje para se të filloj fjalimin dua t'ia bëj zonjës Kusari dhe deputetit Deda, se ata tek ne i kanë nënshkrimet e depozituara edhe për mocionin për rrëzimin e Qeverisë. I ftoj të deklarohen publikisht nëse ata qëndrojnë ende prapa këtyre nënshkrimeve dhe të mos na shkaktojnë përçarje të tilla dhe skandale në media të panevojshme.

U tha sot se kjo seancë dhe mënyra qysh u fillua, mund ta shtyjë liberalizimin deri në vitin 2020, Hani e tha dje. Domethënë, kur ishte në Kosovë që liberalizimi edhe mund të shtyhet deri në vitin 2020, e arsyeja nuk janë seancat e thirrura nga ana e opozitës, arsyet janë vendimet e Qeverisë ku çdo i dyti vendim mund të kualifikohet si vendim korruptim, sepse implikon vendime korruptive.

Shtimi i numrit të ministrive për pazare politike, 80 zëvendësministra, rritja e numrit të këshilltarëve, emërimi i koordinatorëve nacionalë, falja e 50 e sa milionëve borxhe ambalazhuesve të ujit vetëm se iu ka tekur kryeministrit, ndërimi i kalkulimit të akcizës ose heqja komplet e akcizës për pronarin e Fabrikës së Duhanit, i cili është këshilltar i kryeministrit të Kosovës, të gjitha këto implikojnë korrupsion në vete.

Korrupsion ka pothuajse çdo ditë, ju e keni parë, janë mbi 50 vendime të Qeverisë nga më skandalozet, ku ndahen para qoftë për t'i çua veteranët në deti ose në banja pas 20 vjetëve, qoftë u ndahen para familjeve të të akuzuarve për terrorizëm në rastin Kumanova dhe plot çka tjetër, çka nuk ka, ndahen taksat e shtetit për kësi lloj qëllimesh.

A e dini se sa është numri i veturave që Qeveria e Republikës së Kosovës i ka marrë me qira? Është një numër që e tejkalon 10 herë numrin e veturave që e ka marrë Kuvendi me qira dhe dikush duhet të flasë për këto.

A e dini se sa borde, sa kompani publike janë zaptuar, a e dini se qysh ka ndërhyrë nga dita e parë kjo qeveri në punën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe atë jo vetëm me shkarkimin e kryeshefit dhe më pas me shkarkimin e Bordit, por ka ndërhyrë drejtpërdrejt në një institucion të pavarur në punën e tyre, duke marrë me vendime arbitrare tokën e ndërmarrjeve shoqërore dhe duke ua dhënë komunave të Mitrovicës veriore në menaxhim. Domethënë këto janë vendime korruptive dhe sot, po kjo Qeveri është e cila po na lë pa viza dhe pajtohem plotësisht me kolegët që thanë se bashkësia evropiane me të vërtetë nuk ishte e sigurtë kur tha që kushtet i keni plotësuar, por nuk do t'ua japim vizat dhe kush deshë ta kuptojë e kuptoi që me këtë Qeveri në pushtet nuk ka viza.

Por, ne si qytetarë kemi nevojë për më shumë qartësi, qytetarët e Republikës së Kosovës donë të dinë se ku është faji dhe kjo pritet në ditët në vijim, sepse në takime individuale me përfaqësues të lartë të BE-së në Kosovë ata janë tmerruar nga krimi dhe korrupsioni në Kosovë.

Edhe dështimi në Interpol ishte grabitja e gylenistëve në mes të ditës, e cila mori nam në mediat botërore dhe sot e kësaj dite Komisioni Hetimor Parlamentar i Kuvendit mundohet të zbulojë ku është përgjegjësia.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme u shkarkuan tre ministra, krejt këto për pazare politike, krejt këto kanë implikime korrupsioni.

Dhe, pikërisht për vendime të tilla dhe veprime të tilla ne sot jemi pa viza, sepse qytetarëve të Republikës së Kosovës u ka humbur shpresa dhe BE-ja e di se sikur ta bëjë liberalizimin njerëzit ndoshta do të zbrazin Kosovën dhe do të ikin për të gjetur shpresë diku tjetër dhe kjo është rezultat i këtyre.

Në vitin 2015-2017 e dinë të gjithë që i vetmi kriter ka qenë demarkacioni dhe sikur të votohej atëherë, ne do i kishim qytetarët që tashmë dy vjet do të udhëtonin të lirë nëpër Evropë.

Po në fakt edhe unë dua t'i them disa fjalë edhe për BE-në.

Shpesh kam përshtypjen që personalitete të institucioneve tona, të cilët shkojnë të llobojnë për liberalizimin e vizave janë të shantazhuar dhe dosjet gjithmonë i kanë nën tavolinë.

Unë dua t'i them BE-së se nuk ka deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe nuk ka ministër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili nuk ka vizë Schengen jo vetëm për veten, po edhe për gjithë familjen. Po dënohen vetëm qytetarët e këtij vendi.

Edhe unë po dua t'i them BE-së se në vitet e '70-ta babi im i ndjerë, ndjesë pastë, e ka marrë trenin në Pejë dhe ka mbërritur me tren në Minhen ku ka punuar dhe ka vepruar.

Sot, në vitin 2018, nipat edhe mbesat e tij Evropën e shohin vetëm nga interneti, dhe sot jo vetëm për ta, po për shumë qytetarë të Republikës së Kosovës Evropa është 'mollë e ndaluar', duke qenë 'mollë e ndaluar' është bërë shumë atraktive.

Sot qytetarët e Republikës së Kosovës të zonave urbane dhe rurale, duke qenë nën presionin e varfërisë po shesin gjithçka, po shesin tokën, bagëtinë, po lënë vendet e punës dhe po blejnë rrugë ilegale deri në 3 000 euro për një person për të shkuar në Evropë.

Këta njerëz sapo shkojnë atje, rrinë dy javë e shohin se atje nuk mund të fillohet një jetë e re me kërkesë për azil ekonomik. Mirëpo, ku të kthehen, ata janë barrë edhe për vendin ku kanë shkuar, po janë shumë barrë edhe për vendin që do t'i kthejë e nuk ka ku t'i kthejë.

Sikur të kishte liberalizim, këta qytetarë të gjithë do e blinin nga një biletë 50 euro të autobusit dhe do të shkonin fillimisht të vizitonin Austrinë, Francën, Gjermaninë, Suedinë dhe cilindo vend tjetër. Dhe, pas dy jave këta kishin vërejtur që atje nuk mund të fillojnë jetë të re duke u thirrur në varfëri dhe duke kërkuar azil ekonomik, do t'i blinin biletat për t'u kthye në Kosovë dhe kështu nuk do të kishim asnjë problem.

Mirëpo, ne në Evropë do të kërkonim shërim, do të kërkonim edukim, do të kërkonim partneritet dhe do të bënim kryqëzim të kulturave.

Andaj, unë mendoj që është e turpshme që sa vjet në emër të politikës së korruptuar të Kosovës po dënohen qytetarët e Kosovës, të cilët nuk e kanë asnjë faj, sepse BE-ja duke mos qenë e sinqertë dhe duke mos treguar se kush e ka fajin, në fakt nuk po ua bënë të qartë atyre se kë ta votojnë në zgjedhjet e ardhshme.

E për shkak të korrupsionit këta njerëz të korruptuar nesër me dhjetëra e qindra miliona do t'i fusin në proceset zgjedhore dhe kështu korrupsioni asnjëherë nuk do të mund të luftohet në Kosovë. E kemi për obligim të gjithë që t'ua hapim sytë qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Bajrami. Fjalën e ka zonja Xhevahire Izmaçu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, për ju kolegë të nderuar,

Përshëndetje për qytetarët, të cilët e përcjellin këtë seancë,

Fjalimi im që është i shkruar në notes nuk do të fillojë me këtë, mirëpo me gjithë respektin që e kam për kolegen time Hykmeten, e shpreh keqardhjen që e devijoi me kriteret pak për liberalizim të vizave, sepse kurrësi nuk hyn vajtja në banjë ose në deti e veteranëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare me një penalizim të liberalizimit të vizave.

Po pajtohem plotësisht edhe nuk më ka kurajuar fakti që kjo Qeveri i ka afërsisht 100 zëvendësministra, as nuk më ka pëlqyer vendimi për rritje të pagave, por vendimi për t'i dërguar në banjë edhe në deti veteranët e vërtetë, ka qenë vendimi ndër më të mirët që i ka bërë kjo Qeveri.

Të nderuar qytetarë,

Bashkë me ju, edhe unë si deputete shpreh zhgënjimin tim të thellë me rastin e mosfutjes në agjendë për liberalizim të vizave të shtetit tonë.

Meqenëse kjo seancë është ftuar me kërkesën e LDK-së, po e theksoj, po e lexoj kërkesën.

Kërkesa e mbi 40 deputetëve për mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për debat parlamentar lidhur me dështimet e koalicionit qeverisës, të cilat kulmuan me mosliberalizim të vizave.

Të nderuar kolegë deputetë të LDK-së,

Po jua rikujtoj se 95 kritere të cilat kanë qenë të përcaktuara për këtë proces, vetëm dy kritere janë që janë realizuar në këtë mandat qeverisës, pra është demarkacioni, për të cilën shkua në zgjedhje dhe e prishëm Qeverinë, ky demarkacion për të cilin nuk pati unitet brenda grupit dhe nuk u arrit, edhe krimi i organizuar dhe rastet e shënjestruara të korrupsionit dhe krimet të organizuar, për të cilat BE-ja dhe të gjitha institucionet ndërkombëtare deklaruan se janë realizuar. Pra, sikur ju, po aq edhe ne, edhe unë, nuk e dimë ende shkakun e vërtetë për çka ne nuk jemi në agjendë dhe sigurisht që edhe ne e presim këtë arsye.

Më së lehti është ne t'i kundërvihemi njëri-tjetrit, më së lehti është që opozita të përdorë këtu emocione zhgënjime e të harrojë që edhe vetë ka qenë pjesë e çdo procesi, së paku kolegët e mi të nderuar të LDK-së.

Pra, kemi qenë bashkë, keni qenë pjesë e të gjitha vizitave evropiane, pa e lëshuar asnjë rast, bile në këtë rast dua ta përmend deputetin që është zëvendëskryetar i Komisionit për Integritet Evropian, zoti Zemaj, i cili është ndër deputetët i cili ka shpenzuar më së shumti mjete financiare nga Kuvendi për vizita. Unë e di që në këto vizita ka bërë edhe punë shumë të mira, bashkë me kryetaren e komisionit, e cila ishte shumë reale në fjalën e vet.

Mirëpo, në fjalimin e Armendit nuk e dëgjova asnjë keqardhje, sepse nëse ka për keqardhje vend dhe për kërkim falje, i dashur të ishte pjesë e fjalimit, sepse unë si deputete kam pasur veç dy vizita gjatë krejt vitit me financim të Kuvendit. Ndërsa ju zoti Zemaj, keni pasur me dhjetëra dhe nëse është bërë një punë e mirë, ose është bërë një punë e keqe, atëherë jeni përgjegjës edhe ju.

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe ju nga Vetëvendosja, që keni qenë pjesë edhe nuk e keni anashkaluar asnjë vizitë, çka keni kontribuar në këto vizita? Çka keni diskutuar? A mos keni qenë edhe ju pjesë e atyre frymëzimeve të paqarta ndaj këtyre shteteve se Kosova në momentin kur do të fitojë liberalizimin do të zbrazet dhe kjo ka qenë një ndër shqetësimet e vendeve, të cilat kanë refuzuar të jenë pjesë e vendimmarrjes dhe vendet të cilat na kanë njohur si shtet.

Tani kisha dashur ta mbyll debatin me kolegë, unë e di që do të ketë reagime, por më shumë kam ardhur në seancë që të kem një fjalë timen drejtuar kryesisht përfaqësuesve të institucioneve ndërkombëtare, Bashkimit Evropian, ambasadorëve, të cilët në momentet kur ne po bënim diskutime dhe votime shumë të rënda, aspak popullore, na kanë ndjekur korridoreve për të na dhënë kurajën që të votojmë, nuk jam pishman që kam votuar për ato procese, sepse kanë qenë

në dobi të vendit tim. Mirëpo, pse tani heshtin, domethënë pse së paku nuk e shprehin një keqardhje për këtë zhgënjim popullor, sepse ky dënim nuk na drejtohet neve, nuk na drejtohet neve si deputet se 90% prej neve kanë viza, edhe familjarët tanë, po ky dënim u jepet qytetarëve pa të drejtë, keqardhja më e madhe shkon për studentë, të rinj, sportistë, artistë, pleq, të cilët presin me orë e javë për një vizë dhe shumë mirë e dinë, së paku ambasadorët që janë në vendin tonë, e dinë shumë mirë që kosovarët nuk e kanë atë kulturë as atë dëshirë të shkojnë e të jetojnë, sepse kanë dalë nga dhuna dhe nga pamundësia ekonomike i kanë lëshuar vatrat e tyre, pra nuk do të dalin, mirëpo duan të jenë të barabartë.

Po ashtu, të nderuar kolegë deputetë,

Ne e dimë shumë mirë se te çështja e përmbushjes së kriterëve qëndrojmë jashtëzakonisht mirë edhe në raport me shtetet të cilat ka vite që kanë liberalizimin, sepse nuk janë as afër me ne, me të gjitha kriteret, me të gjitha kushtet, standardet. Pra, ne po presim sikur ju po ashtu një përgjigje për çka ne nuk jemi në agjendë dhe nuk dua të besoj atë që e tha kolegu im, zoti Zeka, se mund të jetë një prej atyre arsye, mirëpo nëse ne heshtim dhe nuk kemi përgjigje, sigurisht që do të mendojmë për hipoteza të ndryshme.

Po besoj shumë që nuk jemi në atë pozicionin që kolegët e mi opozitarë janë të lumtur që ka ndodhur kjo, thirrmi te fjala popullore: “Për inati të resë, më vdektë djali”. Mirëpo, të shfrytëzojmë këtë seancë sa nuk është vonë dhe të gjithë ju të bëheni bashkë, t’i ftonin krerët e partive tuaja politike që të jenë bashkë në proceset e ardhshme, sepse përndryshe në këtë mes nuk do të fitojë askush, por zhgënjimin e thellë të qytetarëve do ta bartim edhe në procese të tjera. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Zemaj ka kërkuar replikë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Shumë faleminderit nga deputetja në fjalë, sepse më dha rastin dhe mundësinë ndoshta me ato propagandat, qoftë të disa mediave, të cilat fatkeqësisht bien pre e sulme individuale, duke mos pasqyruar realitetin dhe punën individuale të çdo deputeti.

Është e vërtetë se më duhet të marr pjesë në udhëtime, të cilat janë jashtë vendit si pjesë e Komisionit për Integritet Evropian, duke marrë për bazë që agjenda shtetërore në subjektin tim politik mbizotëron mbi agjendat politike dhe partiake.

Komisioni për Integritet Evropian është pjesëmarrës dhe anëtar në konferencat e parlamenteve evropiane, siç janë dy organizatat KOSAK dhe KOSAD dhe pjesa tjetër ndër lidhet me të qenit tim si anëtar i Komisionit për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, ku përfaqësoj opozitën, ku katër takime janë të obligueshme, dy mbahen në Kosovë dhe dy në Strasburg të Francës. Kjo është pjesa e agjendës dhe punës.

Ndërsa për fjalimet e mia, diskutime dhe kontributin mendoj që kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian dhe kolegët e këtij komisioni e pasqyrojnë në punën tonë e përditshme.

Kjo është puna dhe unë e bëj me nder dhe me përkushtim shumë të madh, nuk e bëj për arsye personale as individuale, sepse jam në mandatin e katërt deputet, tri mandatet paraprake, 10 vjet kam qenë anëtar i Komisionit për Legjislacion dhe udhëtimet dhe vizitat kanë qenë shumë të kufizuara, pa interes personal. Ndërsa udhëtimet e deputetes, ato dy udhëtimet janë trajnime, domethënë janë vizita koti, për dallim prej vizitave dhe pjesëmarrjes aktive permanente dhe e cila është e domosdoshme për integrimin e Republikës së Kosovës dhe bashkëpunimit ndërparlamentar apo diplomacisë parlamentare që e bën Komisioni për Integritet Evropian.

KRYESUESI: Faleminderit! Glauk, e kërrove edhe ti fjalën? A ta ka përmendur emrin? Dy minuta replikë.

GLAUK KONJUFCA: Ne jemi bërë pjesë e vizitave, të cilat Kuvendi i Kosovës i ka bërë për liberalizimin e vizave, sepse e kemi konsideruar që është interes nacional dhe kur është puna e interesit nacional, ne nuk grindemi, po kontribuojmë që qëllimet të realizohen.

Qysh e tha edhe kryetarja e Komisionit për Integritet Evropian, sa herë kemi shkuar jashtë, jemi munduar të argumentojmë që qytetarët e Kosovës e meritojnë liberalizimin e vizave që kjo ndoshta është edhe një e drejtë njerëzore përtej disa kriterëve që mund të vendosen, është e drejtë elementare njerëzore të qarkullosh i lirë, mirëpo ky koncepti mua po më bën përshtypje që mund të prishësh diçka apo të rregullosh shumë përmes këtyre vizitave dhe a mos kemi prishur rastësisht diçka ne si opozitë gjatë këtyre vizitave? Kjo është e paqëndrueshme dhe joserioze të mendohet kështu, për arsye se këtu nuk çon peshë as, le të themi, dukja, as mirësjellja kështu artificiale dhe sipërfaqësore, as shminkimi, qe besa, këtu krejt çështja reduktohet dhe esenca është te qeverisja e vendit. Qeverisja e vendit është esenciale në liberalizimin e vizave. Pra, çfarë pushteti ke, sa demokratik është ai pushtet, sa i respekton të drejtat e njeriut dhe pastaj kriteret teknike, siç janë siguria e dokumenteve, siguria e kufijve, kredibiliteti i dokumenteve. Unë mendoj që Kosova ka çaluar me të vërtetë shumë, plus ky kriteri tjetër që ka qenë i korrupsionit dhe luftimit të krimit të organizuar, kjo tipike ka lidhje me qeverisjen, fare nuk ka të bëjë me opozitën.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Izmaqu, ju lutem!

XHEVAHIRE IZMAKU: Në këtë rast, direkt me ty e kam tash, Glauk, sepse po mendoj që nuk është etike kategorizimi i elementeve estetike, mirëpo pikërisht këtë nuk desha, sepse ruaj respekt ndoshta jo aq për ty, sa për babin tënd, pikërisht është emri yt që diskutohet që ju në forume ndërkombëtare keni qenë ai që keni shprehur hezitimin se në rastin kur Kosova do të fitojë liberalizimin, Kosova do të zbrazet. Pra, a jeni ju ai deputet? Dhe, tani nëse jeni duhet të

jeni i sinqertë, pra mos u mundoni të devijoni debatin dhe diskutimin tim në çështje, të cilat s'kanë lidhje me kategori estetike edhe morale. A jeni ju ai deputet?

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Albin Kurti!

ALBIN KURTI: Deputetë të Kuvendit,
Qytetarë të Republikës,

Arsyeja kryesore pse nuk ka liberalizim të vizave është dështimi total në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit të lartë. “Freedom House” na ka cilësuar si vend gjysmautoritar, regjim hibrid dhe pjesërisht i lirë. Kur cilësohesh ‘pjesërisht i lirë’, kjo do të thotë se ke legjitimitet për të kërkuar azil politik, rrjedhimisht qytetari i Republikës sonë më të mëdha i ka gjasat ta fitojë azilin politik, meqenëse jemi ‘pjesërisht të lirë’, se sa heqjen e vizave në shtetin tonë të pavarur për të shkuar në Bashkim Evropian. Në anën tjetër, KDI-ja dhe “Transparency International Kosova” e kanë përdorur togfjalëshin “state capture”, “kapje e shtetit”, situata thonë nuk është vetëm korrupsion, sepse është kapje e shtetit. Kjo do të thotë se në Kosovë nuk do të mund të flitet për krim të organizuar, sepse krimi është i institucionalizuar. Krimi i organizuar megjithatë ndodh jashtë strukturave shtetërore, ndërkaq në shtetin e kapur nuk ka më as krim të organizuar, as korrupsion, sepse ka krim të institucionalizuar, këtë praktikisht e thonë “Transparency International Kosova” dhe KDI-ja.

Qëndrimi i zyrës së Bashkimit Evropian më 30 tetor ishte ky: Zyra e BE-së nënvizon nevojën për intensifikimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, po e citoj: “Para se të merret vendimi përfundimtar është e rëndësishme që autoritetet e Kosovës të vazhdojnë me shpejtësi të plotë punën e tyre të vazhdueshme për përcjelljen e rasteve që kanë të bëjnë me luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përparimi i përgjithshëm në fushën e sundimit të ligjit do t'i kontribuojë përmirësimit të prospektit për një vendim përfundimtar pozitiv lidhur me liberalizimin e vizave”. Pra, nuk kërkojnë vetëm përmbushje të kriterëve, por edhe “përparim të përgjithshëm”, e ne e kemi imazhin përtokë, imazhi i Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian kurrë nuk ka qenë më i keq sesa sot që nga mbarimi i luftës sonë çlirimtare. Më tutje, qëndrimi i drejtoreshës për Evropën Kontinentale në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Francës ishte që ‘duhet punë e madhe për të përmirësuar sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit’. Pra, kohët e fundit nuk janë përqendruar vetëm te përmbushja teknike e kriterëve të shumta, por te përshtypja e përgjithshme, te lufta e përgjithshme kundër korrupsionit, përkatësisht tek imazhi i Kosovës, e unë besoj që kjo nuk është kuptuar qysh duhet.

Ne i kishim njëmend 95 kritere për liberalizimin e vizave, më shumë se kushdo tjetër. Pra, Bashkimi Evropian e ka shtuar numrin e kriterëve për neve, unë besoj, duke e ditur sa e rëndë dhe e keqe është gjendja në Kosovë. Për shembull, Bashkimit Evropian nuk i ka shkuar mendja që ta vërë kriter se kryeministri nuk bën ta kërcënojë prokurorin, nuk i ka shkuar në mendje, ose nuk i ka shkuar në mendje që të thotë se shtetasit e huaj nuk bën të deportohen tinëz, pa ligj dhe

kundër Kushtetutës, nuk i ka shkuar në mendje. Pra, ky është problemi i Bashkimit Evropian, nuk i ka shkuar në mendje që t'i shkruajë edhe këto kritere. Ata kanë vënë shumë kritere, tepër shumë kritere, sepse janë munduar ta shterin me imagjinatën e tyre paparashikueshmërinë e mbrapshtë në shtetin e kapur të Kosovës. Pra, me imagjinatën e tyre ata janë munduar ta shterin paparashikueshmërinë e keqe, të mbrapshtë, në shtetin e kapur të Kosovës, por nuk ia kanë dalë, ata kanë dështuar në imagjinatën e tyre se çfarë kriteresh krejt duhet vënë në mënyrë që ne të kualifikohemi. Prandaj, janë 95 kritere, sepse vetëm kanë venë njëren pas tjetrës në një situatë ku shteti është i kapur dhe nuk kanë arritur që ta shterin paparashikueshmërinë e mbrapshtë tonën. Prandaj, kemi shumë kritere, sepse nuk jemi trajtuar asnjëherë normalisht as për së afërmi dhe doli që imagjinata e tyre ishte e kufizuar.

Liberalizimi i vizave nuk ka qenë dhe nuk është prioritet i qytetarëve të Kosovës për vetveten e tyre, por është prioritet i Qeverisë së Kosovës për qytetarët e Kosovës. Nëse i shihni matjet e opinionit publik, gati 20 vjet pas çlirimit, e më shumë se 10 vjet pas pavarësisë, asnjëherë në top 3 prioritetet si brenga, si shqetësime, të qytetarëve të Republikës nuk është liberalizimi i vizave; janë punësimi dhe luftimi i korrupsionit, është arsimi, është shëndetësia, nuk është liberalizimi i vizave. Liberalizimi është prioriteti i qeverisë për qytetarët, jo i qytetarit për vetveten. Edhe kur qeveria me mediat e veta e shkaktonte përshtypjen se liberalizimi është prioritet, kjo më shumë flet për qeverinë sesa për qytetarët. Tregon se kjo qeveri është dorëzuar për shtetndërtimin demokratik, për zhvillimin ekonomik, për mbrojtjen sociale dhe e dorëzuar, si e tillë, ofron rrejtshëm bileta dalëse nga kriza që e ka shkaktuar, me ç' rast, njëkohësisht, vetë zhvlerësohet si qeveri. Sepse, një qeveri, e cila vendos si prioritet ta nxjerrë qytetarin jashtë vendit ku qeveris, atëherë ajo veç zhvlerësohet si e tillë.

Pushteti, që në Kosovë më shumë është regjim sesa qeveri, e ka krijuar përshtypjen se as populli, porsiq qeveria, nuk e do Kosovën: duan vetëm të dalin prej këtu, të ikin prej vendit. Qeveria po e vjedh vendin, rrjedhimisht nuk e do vendin, por as populli nuk e do, edhe ai po do të ikë nga vendi, por nuk është e vërtetë! Nëse i pyetni qytetarët e vendit tonë: a e zgjedhin një vend pune në Kosovë apo në Gjermani? Në Kosovë e zgjedhin, por po shkojnë në Gjermani, ndoshta edhe pa vend pune, sepse këtu nuk ka shanse për vend pune. Përveç papunësisë enorme, ajo është edhe shumë afatgjatë. Shumica dërmuese e të papunëve e kanë papunësinë afatgjatë. Pra, qytetarët e duan vendin, qeveria është munduar ta krijojë përshtypjen e rrejshme se qytetarët, porsiq qeveria, nuk e duan vendin, por duan të ikin prej vendit: këta duan të ikin, këta po e vjedhin, njësoj jemi, "harni për thes", siç thotë populli ynë. Por, nuk është e vërtetë! Për dallim nga Qeveria, qytetarët e duan vendin tonë.

Padrejtësia e Bashkimit Evropian ndaj Kosovës as nuk nis, as nuk është thelbësore mosliberalizimi i vizave, janë dy të tjera: e para, për bindjen time, është përkëdhelja e vazhdueshme e Serbisë, privilegji i saj dhe e dyta, është EULEX-i me fuqi ekzekutive. Por, që të dyja këto janë miratuar në këtë Kuvend, i cili është shtypur nga qeveria servile. Qeveria servile

dhe Kuvendi i shtypur e kanë krijuar këtë situatë. Ne, për dallim nga kapësit e shtetit, gjithmonë e kemi kundërshtuar EULEX-in dhe kemi afirmuar Bashkimin Evropian, ndërkohë që kapësit e shtetit e kundërshtojnë Bashkimin Evropian, mirëpo e kanë mirëpritur gabimisht, padrejtësisht, dëmshëm, EULEX-in.

Krejt në fund, ne po e kërkojmë dorëheqjen e qeverisë, e cila tashmë është tërhequr. Këtu janë 22 ulëse, nuk është asnjë ministër. I kemi 5 zëvendëskryeministra, kryeministrin edhe 23 ministra që bëjnë gjithsej 29. Prej 29 qeveritarëve, asnjëri prej tyre nuk ndodhet në këtë seancë. Pra, ne kemi një qeveri që tashmë është tërhequr. Ne po e kërkojmë dorëheqjen e një qeverie të tërhequr, sepse qeveria nuk është këtu. Dhe, shtrohet pyetja: kjo qeveri, e cila e ka bojkotuar Kuvendin, sepse kështu lufton opozitën, çka do të thotë për neve ta kërkojmë dorëheqjen e të tërhequrit? Do të thotë të kërkojmë tërheqjen edhe të dorës, sepse kjo Qeveri është tërhequr, nuk i ka investuar për vendin tonë as zemrën, as trurin, as shpirtin, as trupin, por vetëm dorën. Dhe, një qeveri e tërhequr, përveçse për dorën e saj mbi buxhet e mbi pasuritë e Kosovës, do të duhej ta tërhiqte edhe dorën, në këtë kuptim kur kërkojmë dorëheqjen e qeverisë së tërhequr, i bie le ta tërheqin edhe dorën, përveçse janë tërhequr shpirtërisht, e fizikisht prej qeverisjes me vendin tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kurti! Fjalën e ka Gani Dreshaj, nuk është këtu, sipas radhës fjalën e ka Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Për të mos folur shumë për seancat e jashtëzakonshme që janë bërë rutinë në Kuvendin e zakonshëm të Republikës së Kosovës, në këtë seancën e dytë ose tentim seance për t'u mbajtur i kemi në listë 21 nënshkrime nga Vetëvendosja dhe 19 nga LDK-ja, të kundërtën, gjithsej 19-21, por megjithatë, edhe pse në listë e kemi një kolege timen, Saranda Bogujevci, e që personalisht e di arsyen pse nuk është në Kosovë, çka kam shumë respekt të madh, por megjithatë është në Londër, që i bie që janë 39, pa e ditur në kohën kur janë deponuar këto nënshkrime Liburni a ishte këtu, apo jo, se erdhën më vonë, që i bie 38.

Megjithatë, seancë e jashtëzakonshme me 38 nënshkrime që nënkryetari i Kuvendit tha nuk do të ndodhë më, për t'ju treguar që jo të gjitha subjektet politike bëjnë politikë siç u konvenon, kurrë për tri mandate rresht Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, sa unë jam deputete, nuk ka ndodhur të deponojë nënshkrime blanko. Shumë herë ka ardhur edhe në fshat ku unë jetoj, ma ka marrë nënshkrimin në atë kohë kur ishim bashkë edhe me Vetëvendosjen. Pra, jo me të gjithë ndodh kështu, por dikujt i pëlqen edhe kur flet për korrupsion, edhe pse nganjëherë unë e quaj bash korrupsion bre është, edhe të hollat që Vetëvendosja dhe LDK-ja nuk ua japin deputetëve, të cilët i deponojnë, 12 deputetë të PSD-së andej, e 4 tjerë që i kanë pasur në listë janë të holla për deputetin që i marrin grupet parlamentare, po çka është kjo? Korrupsion, pse s'ua jepni të hollat? Pikërisht, të gjithë, krejt, ama të gjithë. Pse more s'jua jepni të hollat? 12 deputetëve ua keni

ndalur të hollat, ju tjerët 4 a 5, pse s'jua jepni e të bëheni burra të mirë, burra e gra, më falni. Domethënë, aty po ju pëlqen, çka është kjo? Pse more s'po thoni parime kemi? Jo, i keni, s'ka parime, materialisht s'ka parime. Megjithatë, një pyetje për Vetëvendosjen, nuk e di Glauk a ishte këtu në fjalën e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së, a je pajtuar komplet me këtë tekst, apo jo? Sepse, nuk e di, megjithatë unë pashë diskutimet brenda grupit që krejt të kundërtën e asaj që e thatë ju e thanë kolegët tuaj. Por, megjithatë veç kisha dashur juve personalisht t'jua bëj një pyetje: në tekstin që e ka lexuar shefi thotë: “pas dështimeve”, ndër të tjera po dal te një fjali që thotë, “të cilët dikur pengonim me dhunë e me intriga përmbushjen e kriterëve për liberalizim”. A jeni pajtuar ju Vetëvendosja me këtë? Veç kisha dashur ta di.

Pra, kjo është për Vetëvendosjen. Tutje, shkojmë për shefin e Grupit të LDK-së në manualin, të cilin ai do ta shkruajë që e sugjeroj ta shkruajë një manual për ish- Qeverinë Mustafa ose Qeverinë e fjetur Mustafa, unë vetëm disa nga deklaratat e ish-kryeministrit Mustafa i kam këtu, do t'i lexoj disa, për të mos ju lodhur shumë, që do t'ia jap material shefit, se i nevojiten. Megjithatë, sot do të duhej që seanca, po, të diskutojë për mosliberalizimin e vizave, po, plotësisht e drejtë, por të ketë edhe një reagim, siç e pati edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, që propozimi ishte nga kolegja ime nga LDK-ja, Lirije Kajtazi, që e përkrahëm të gjithë njëzëri. Reagim që u është bërë e padrejtë qytetarëve të Republikës së Kosovës me mosliberalizim të vizave, përderisa janë të rrethuar nga të gjitha shtetet e tjera që kanë liberalizim vizash.

Nuk po flas fare për vendimet dhe ligjet, të cilat janë mbi 120 që i kanë ardhur në Kuvend, përkundër Qeverisë së fjetur Mustafa, që kanë ardhur nga Qeveria Haradinaj, nuk po flas për vendime, të cilat për herë të parë i kanë fuqizuar komunat, domethënë në Kosovë, të gjitha komunat, pra që u janë dhënë mundësi si asnjëherë më parë. Nuk po flas për punë të buxhetit, sepse do ta shohim më vonë me shifra, sepse 1/3 e komunave udhëhiqet nga Aleanca, për ata që nuk e dinë, dhe një që është marrë në tavolinë. Nuk po flas për kurrgjë më shumë, vetëm se për marrëveshje, siç tha shefi i LDK-së, marrëveshjet ndërkombëtare po vijmë e po i votojmë. Pse more marrëveshjet ndërkombëtare, në fund të fundit, po ligjet për kënd bëhen? A janë ligjet për qytetarët e Republikës së Kosovës? Domethënë, ne po duam BE-në ose miqtë tanë ndërkombëtarë më shumë se vetveten. Ligjet nuk bëhen për subjekte politike, i nderuar shef, por ligjet bëhen për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Nuk po flas për shumë vendime, të cilat janë publike të Qeverisë Haradinaj, shqetësuese për mua ishte edhe një reagim i koleges time, prapë ish-ministres që tha se Qeveria i ka çuar veteranët e invalidët e luftës. Po, bre, edhe Qeveria Mustafa i ka çuar dhe plotësisht kanë pasur të drejtë. Për mua është shqetësuese numri i njerëzve të luftës që kanë varë veten apo sot nuk janë me neve pikërisht për shkak të shumë plagëve që i kanë, e nuk mund t'i shërojnë, për mua kjo është shqetësuese, se s'kemi mundur kurrë t'u ndihmojmë. Ju e thatë, e nderuar, shumë keq.

Pra, po i kthehem materialit që duhet t'ia jap shefit më vonë, gjithë këtë material e kam kurrgjë pa argumente, po flas në kohën kur, më 12 nëntor 2016, ish- kryeministri Mustafa thotë

“liberalizimi i vizave për Kosovën, në duart tona”. Domethënë, kjo është në fund, vetëm më dëgjoni pak me kujdes, kryeministri Isa Mustafa ka thënë se mesazhet e Brukselit janë të qarta se liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës është në duart tona, mesazhet e BE-së janë të qarta tashmë në dorën tonë që t’i hapim udhë liberalizimit të vizave dhe të vazhdojmë më tutje në integrimin e plotë në BE, i cili është vullnet dhe aspiratë e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Më tutje, në postimin e tij në rrjetin social, sepse zakonisht në Facebook kanë shkruar, ka shkruar se takimi i djeshëm me Komisararin e Bashkimit Evropian, Johannes Han, që ishte po i njëjti, i njëjti, nuk ishte tjetër ai i njëjti që ka qenë atëherë një ditë më parë është i rëndësishëm për rrugën integruese të BE-së.

Tutje, ngadalë-ngadalë, Isa Mustafa: “Liberalizimi i vizave, vitin e ardhshëm”, po flasim për datën 24 nëntor 2015, ora 11:33. Kryeministri Isa Mustafa në një konferencë për media ka thënë se liberalizimi i vizave do të ndodhë në vitin 2016, më tutje Mustafa ka thënë se në fund të vitit ose në fillim të muajit janar, e ke domethënë, tutje, Isa Mustafa, liberalizimin e vizave në 2015. Këto janë data të ish-kryeministrit zyrtarisht. “Unë jam”, thotë, po e citoj: “Unë jam shumë i bindur se vitin e ardhshëm”, pra po flasim për 2015-ën, “vitin e ardhshëm ne do ta kryejmë këtë punë, do të bëj përpjekjet maksimale që në pjesën e parë të vitit të ardhshëm të punojmë me ngulm që t’i bindim dhe që të kemi mirëkuptimin e vendeve të BE-së që këtë proces ta përmbyllim”, thotë ish-kryeministri Mustafa.

Tutje, krejt këto për shefin janë, Isa Mustafa e quan të pakuptimtë kushtin e BE-së për liberalizimin e vizave. Më tutje, thotë shumë për atë ka shkuar qysh ka shkuar, Kosova ka nevojë të jetë në tregun e BE-së dhe, sipas Mustafës, këtë e mundëson MSA-ja, që Qeveria Haradinaj i ka plotësuar kriteret, të nderuar. Thoni që i ka plotësuar kriteret, se tha po i njëjti Han që ishte më herët, e tha: “Janë plotësuar kriteret”. Tutje, ngadalë-ngadalë, se keni material, ka ende, po unë diçka kam marrë, krejt këto janë pikërisht materiale, shihni, të gjitha këto për manualin e shefit të LDK-së, të cilin e sugjeroj që në fillim dhe tani i them LDK-së që Qeveria nëse ju pengon që po bëhet ushtria e Republikës së Kosovës, thoni, nëse po ju pengon taksa prej 100% që po përqafohet nga të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës anembanë, thonë, nëse po ju pengon që Qeveria Haradinaj për herë të parë, përkundër Qeverisë Mustafa që kishte kërkesë të vazhdueshme, qoftë nga Avokati i Popullit, që pagoi nga taksat e buxhetit të Kosovës rrymën në veri, Qeveria Haradinaj nuk po e bën, domethënë a po ju pengon kjo? Edhe sa argumente të tjera duhen t’ju thuhet që Qeveria Haradinaj është qeveri e vendimeve, është qeveri...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë zoti Konjufca dhe zoti Hoti. Zoti Konjufca e keni fjalën!

GLAUK KONJUFCA: Meqë e ngriti çështjen drejtpërdrejt sa i përket gazit lotsjellës, atëherë me siguri që duhet t’i përgjigjemi Teutës. Krejt ato që i kemi bërë për ta kundërshtuar krijimin e

Zajednicës në Kosovë, edhe demarkacioni, 8 mijë e 200 hektarë, asnjë gram pendesë, as turp nuk kam për asnjë veprim që e kemi bërë edhe unë edhe kolegët e mi brenda Kuvendit të Republikës së Kosovës për ta ndalur Zajednicën. Shumë mirë që këto veprime kanë ndikuar që Zajednica të ndalet. D.m.th. Teuta po troket në derën e hapur. Prej kësaj nuk kam asnjë fije turpi. Ama të kisha qenë deputet, i cili dal e kundërshtoj demarkacionin me gaz lotsjellës, shëtis poshtë e përpjetë Kosovës duke ua marrë votat qytetarëve për ta ndalur demarkacionin, në fund vij në pushtet, edhe e votoj pikërisht atë demarkacion të Murat Mehës, të cilin e quaj tradhti kombëtare, e për besë prej kësaj do të më kishte ardhur turp shumë. Prej kësaj kisha vdekur prej turpit. Shyqyr që nuk më ka ndodhur, por për dikë nuk është gajle.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Teuta Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: Pyetje për Glauk Konjufcën dhe njëherësh shefin e Vetëvendosjes: A po pajtoheni pra që ka pasur dhunë dhe intriga në atë kohë Glauk, një. E dyta, kemi votuar diçka që janë dy marrëveshje, plus raporti i Shpëtim Bulliqit, nëse juve nuk ju pëlqen, janë me qindra faqe dhe është një marrëveshje e dy presidentëve që nëse brenda afatit që shkruan aty nëse s'gaboju dy vjet, nuk kthehem atje, atëherë flasim. A ka pasur dhunë dhe intriga, apo i keni mbyllur sytë? Përgjigju në këtë pyetje të lutem, sepse nuk u përgjigje, por prapë intrigove ashtu siç edhe zakonisht bën.

KRYESUESI: E ke radhën, tani kur ta jap radhën të flasësh, ti diskuto, i ke dhjetë minuta. Zoti Hoti e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Pyetja ime për kolegën deputete është çka ka ndodhur ndërkohë që ajo e ka ndërruar qëndrimin dhe e ka votuar demarkacionin se unë kam qenë atje i ulur në ulëse bashkë me ish-kryeministrin dhe me plot kolegë ku jam qorrur prej saj dhe prej kolegëve të saj. Pra, unë e pyes çka ka ndërruar, si është bindur ajo që ta votojë demarkacionin, të mos thirret në Ligjin për ratifikimin e kësaj marrëveshje, sepse ato raporte që po i përmend janë totalisht pa vlerë, janë vetëm për informim të deputetëve, kështu jemi dakorduar, kështu i kemi votuar ato. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

TEUTA HAXHIU: D.m.th. nëse shefi i LDK-së është mashtruar, kjo për mua është shqetësuese, shef. Nëse ti je mashtruar, sepse the ashtu jemi marrë vesh, nëse ka qenë mashtrim, ti e ke përgjegjësinë. Ne u besojmë shefave. Kemi votuar dy dokumente shtesë, të cilat janë faktike. Dy nënshkrime që e kemi detyruar Presidentin aktual që ju e keni bërë President, Hashim Thaçin e kemi detyruar të bëjë nënshkrim mbi firmën e vet që e ka pranuar se është bërë gabim dhe e kemi një raport të ish-kolegut tuaj që e përjashtuat, ngase e ka përgatitur një material. Nëse nuk e keni lexuar, ju sugjeroj ta lexoni mirë. Pra, janë dy dokumente shtesë, nëse jeni mashtrues thojeni

“jam mashtruar”, dhe mos tento të na mashtrosh neve. Materialin mos të harroj të ta jap për manual.

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Haxhi Avdyli.

HAXHI AVDYLI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Është për keqardhje që sot Kosova mbetet oaza e fundit e izolimit, getoja e fundit e Evropës. Pritshmëritë e kosovarëve për liberalizimin e vizave ishin të mëdha. Kjo edhe për shkak të politikanëve kosovarë të papërgjegjshëm si Hashim Thaçit e të tjerët, të cilët që nga viti 2010 e këndeje kanë propaganduar e premtuar rrejshëm pa u skuqur fare se do të hiqeshin vizat që nga viti 2010 e tutje, herë pas tetë muajsh, e herë pas 18 muajsh. Është e padrejtë edhe nga Evropa që sot kosovarët nuk e kanë liberalizimin e vizave, por ne nuk mund të bëjmë gjykim për politikën evropiane, ne duhet të mendojmë dhe t'i bëjmë autokritikë politikës kosovare nëse i ka bërë detyrat sa duhet, apo mund të thuhet që sa ka punuar kundër partneritetit me BE-në, me politikën e saj të mbrapshta. Për një vit të qeverisjes së Ramush Haradinajt jemi dhjetë vjet më larg nga integrimi evropian. Edhe një vit tjetër i kësaj agonie të kësaj qeverie na largon edhe me dekada të tjera nga integrimet evropiane.

Prandaj, çdo ditë me këtë Qeveri, jo që s'do të kemi liberalizim, por s'do të kemi asnjë rrugë të hapur për integrim, do të kemi izolim, do të kemi papunësi, do të vazhdohet zhvatja e pasurisë dhe Buxhetit të Kosovës nga një klan i njerëzve dhe grupit të lidhur me politikën dhe duke shkaktuar edhe humbje të mëtutjeshme të shpresës dhe për këtë edhe ikje masive të rinjve nëpër rrugë ilegale.

U tha këtu se ky proces nga ai teknik u shndërrua në proces politik. Kjo flet se BE-ja s'është e kënaqur me këtë pushtet dhe qeverisjen e saj dhe liberalizimi s'ka për të ndodhur derisa ta kemi një qeveri dhe politikanë të dështuar në udhëheqje të saj. Si duket ai lobim i pakët që kanë bërë, apo thënë ndryshe shëtitjet nëpër Vjenë e Bruksel, duke filluar nga kryeparlamentari e të tjerë dhe shumë qeveritarëve të tjerë, ka bërë më shumë kundërefekt, duke e rritur skepticizmin e evropianëve për kosovarët dhe liberalizimin e vizave për ta. Sepse, kjo më shumë ka shkaktuar çudi e habi sesi një popull si ai i yni që sot ka dhënë emra të mëdhenj për artin, muzikën e sportin, të votojë këta njerëz kaq të padijshëm dhe kaq të korrumpuar, që më shumë dhe më shpesh po ia çajnë hallin Serbisë dhe po brengosen për problemet e tyre dhe po brengosen sesi t'ia rritin territorin e Serbisë sesa ta ruajnë territorin e shtetit të tyre.

Prandaj, për fund, unë nuk dua ta gjykoj Bashkimin Evropian, por e kam vetëm një lutje, liberalizoni vizat për qytetarët e mirë të Kosovës e ndalojuani hyrjen të gjithë atyre politikanëve, të cilët më shumë po e udhëheqin Kosovën drejt Lindjes dhe humnerës sesa drejt zhvillimit dhe Perëndimit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sherifi. Në rregull! Kur e kërkove fjalën? Për replikë, a çka? Jo, e ke kryer diskutimin. Prit kur të vijë radha.

Zenun Pajaziti e ka fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti kryesues!

E di që është..., ju lus për qetësi nëse ka mundësi, ose e lëmë... nëse jeni të lodhur e përfundojmë, mund ndoshta edhe të vazhdoj, por unë mendoj që e metë e këtij debati është jo pse është thirrur, jo pse është thirrur prej një grupi deputetësh të cilësdo parti, ose me ndonjë nënshkrim të diskutueshëm. Për mendimin tim, e meta e këtij debati është që nuk jemi në temë dhe fajtor për këtë janë më së shumti ata që po mungojnë.

Sot është mëkat që dikush nga Qeveria nuk është këtu për t'iu falënderuar qindra e mijëra njerëzve shërbyes civilë, njerëz që kanë kontribuar për të pasur pas gati shtatë vjetësh prej se është marrë udhërrëfyesi një përfundim pozitiv për përmbushjen e kriterëve për liberalizimin e vizave. Është dashur sot të ketë njerëz që janë të kyçur në këtë proces, edhe ta shpjegojnë procesin. Sot më shumë se kurrë ka qenë mirë ta japim një mesazh të përbashkët, pozitiv e opozitë, dhe të dalim me një rezolutë krejt ndryshe nga kjo që është servuar sot nga opozita.

Mendoj që sot, edhe këto ditë që opozita dhe të gjithë ata që nuk janë të kënaqur me qeverisjen në këtë vend kanë mundësi në temat në vijim, në tema jashtëzakonisht serioze të kenë debat dhe të kenë qëndrime për proceset e ardhshme. Por, liberalizimi i vizave është një diçka që do të duhej sot të na bashkonte të gjithëve në raport me BE-në, ta nxjerrim një mesazh nga një vendim, ose një proces që po përfundon padrejtësisht, ose nuk po përfundon në kohën e duhur, jo për fajin e kosovarëve, jo për fajin e institucioneve dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Unë nuk po them se sot duhet ta shfajësojmë Qeverinë e të flasim për gazin lotsjellës dhe anasjelltas, por sot duhet të tregojmë që Kosova e ka përmbyllur një kapitull që për dallim prej pjesës tjetër të procesit të integritit në BE, që është më shumë politik, ka qenë një proces politik, teknik, dhe herë pas here Komisioni Evropian ka nxjerrë kriterë që nuk ka qenë një praktikë me vendet e tjera, ka nxjerrë kriterë politike me të cilat janë ballafaquar qytetarët e Kosovës dhe institucionet e Kosovës që kanë pasur për detyrë t'i zbatojnë.

Sot ne vetëm lodhemi duke e fajësuar njëri-tjetrin nëse nuk e bëjmë gjënë e duhur për kohën që na ka mbetur. Unë nuk dua t'i humb shpresat që institucionet e Kosovës, komuniteti i politikanëve, i partive politike në Kosovë, ta adresojë njëzëri një qëndrim të qytetarëve të Kosovës të cilët e duan këtë proces dhe të cilët e kanë shprehur nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, edhe në këtë Parlament, pozitiv e opozitë që t'u hapen rrugët për të lëvizur lirshëm në BE. Mendoj që sot, pavarësisht këtij teksti, të nderuar kolegë deputetë të opozitës, edhe njëherë po them proceset që janë në këto ditë në vazhdim, që lidhen me fatin e këtij vendi, janë të tilla që mund të na duhet të bëjmë debat dhe të nxjerrim qëndrime të tjera, po pikërisht çështja e

liberalizimit të vizave nuk është një moment që ta sjellim në këtë situatë, ose këto qëndrime politike që kanë të bëjnë edhe me zgjedhjet, edhe me proceset e tjera.

Unë edhe njëherë po them nuk është se nuk ka lëshime, ka pasur shumë, por entuziazmi i kosovarëve për vizat ka qenë më i madhi sesa në të gjitha vendet e rajonit. Pesë vjet para se ta marrim udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave, institucionet e Kosovës e kanë nxjerrë një udhërrëfyes të njëanshëm, edhe kjo falë ekspertëve, gjeneratës së re, njerëzve që kanë pasur vullnet me vite të punojnë, edhe të tregojnë që duhet të hapet rruga drejt BE-së. Unë pres, meqenëse sot edhe nuk ka mjaftueshëm deputetë, që shefat e grupeve, përfaqësuesit e partive politike të ulen, ta nxjerrin një rezolutë të përbashkët dhe ta drejtojmë atje ku duhet, një rezolutë, e cila ndoshta do ta bënte edhe një detyrë të mirë në raport me ata që duhet të marrin vendim sa më shpejt për heqjen e vizave për kosovarët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Sami Kurteshi.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege dhe kolegë deputetë,

Unë po citoj, mosratifikimi i marrëveshjes për demarkacionin me Malin e Zi nuk ka asnjë pasojë të vetme për Kosovën. Kjo është marrëveshje për humbjen e territorit dhe jo për liberalizim të vizave. Lidhja me liberalizimin e vizave është e shpifur, është gënjeshtër, krim ligjor e politik i pushtetmbajtësve dhe i disa mediave të tyre të kriminalizuara. Lidhja e demarkacionit me liberalizimin është krimi më i madh që bëhet kundër qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ky është një citat i nxjerrë nga transkripti i Kuvendit me rastin e diskutimit në lidhje me demarkacionin me Malin e Zi në mars të këtij viti.

Po të kishim luftuar ne kundër liberalizimit, ashtu siç kanë luftuar për faljen e tokave të Malit të Zi dhe Maqedonisë, sot me siguri do ta kishim një lajm tjetër nga Bashkimi Evropian për liberalizimin. Këtu ata pikërisht e kanë parë, përveç tjerash, se sa seriozë jemi në lidhje me territorin tonë. Kjo së paku ka ngjarë, dhe e kanë parë edhe te vendet e tjera, madje edhe në fqinjësinë tonë më të afërt, me Malin e Zi dhe me Kroacinë. Ata nuk kanë bërë demarkimin, edhe i kanë lutur të hyjnë në Bashkimin Evropian. Po them, i kanë lutur.

Këtu po dëgjoj po thonë i kemi përmbushur 95 kritere të caktuara për liberalizim. Kjo ndoshta edhe është e vërtetë nuk e di, por kriterin 96 nuk po e përmend askush, e ky është largimi i pushtetarëve të korruptuar, edhe i pushteteve të korruptuara dhe të kriminalizuara. E këtë ne nuk e kemi plotësuar. E ky është kriteri kryesor. Kaq e thjeshtë është kjo punë. Nuk ka liberalizim me heshtjen e vrasjes së Astrit Deharit dhe dëshmitarit kryesor në burg, që kurrë nuk janë sqaruar. Me vrasjen brenda ndërtesës së AKI-së, me rrahjen e investitorëve të huaj nga vëllai i Presidentit, me kërcënimin e prokurorit nga Kryeministri dhe të tjerët, gjetjen e armëve dhe të drogës në veturën e djalit të shefit të AKI-së dhe suspendimi i policit që e ka bërë atë publike.

Me depërtimin e shtetasve turq nga Kosova pa asnjë procedurë gjyqësore, me ministra dhe zëvendësministra me akuza e me marrje të mitës. Me vjedhjen e pazbuluar kurrë të Dhomës së Dëshmime në polici. Nuk ka liberalizim. Ata këto i shohin. Bile, ata i kanë zbuluar, jo ne. E ne veç i kemi qarë pastaj.

T'i kthehemi tani temës për liberalizim. Kush e trumbeton liberalizimin e vizave më së shumti dhe kush e ka trumbetuar? Në Kosovë i kemi dy shtresa shoqërore që e bëjnë këtë punë. Në njërin anë që e shohin liberalizimin e vizave si turizëm, si skijim, si makijazh, si shopping, si shpëlarje parash. Këta janë ata që e kanë gojën plot liberalizim të vizave dhe janë shtresa që është e lidhur me pushtetin dhe është e vendosur mbi popullin. Janë ata që edhe Gjykatën Speciale, bisedimet me Serbinë, humbjen e territorit, duke u falur tokë Malit të Zi dhe Maqedonisë, i lidhin me liberalizimin. Dhe, në anën tjetër, janë ata që liberalizimin e kërkojnë si shans jete për punë, për shkollim, për shërim, por që nuk kanë zë, e nuk janë publikë dhe shtypen e manipulohen nga këta të parët. Dallimi ndërmjet këtyre dy palëve është se të parët ua kanë shkatërruar jetën dhe ardhmërinë këtyre të dytëve. E kanë varfëruar ekonominë duke e vjedhur dhe duke u shkatërruar gjithçka çka kanë, ua kanë vjedhur vendet e punës, për klane e për familjarë, me korrupsion e krim të organizuar, tani e 19 vjet. E kanë sëmurë shëndetësinë deri në vdekje, duke e korrupuar dhe duke e vjedhur. E kanë bërë injorant arsimin, duke e shndërruar në biznese fitimprurëse. E kanë shkatërruar sistemin e drejtësisë, “duke e shkelur ligjin dhe duke e forcuar Maliqin”, duke e bërë jo vetëm sistemin të paligjshëm, por edhe duke i humbur edhe shoqërisë besimin në shtetin dhe në njeriun.

Të parët janë publikisht ekzistentë. Ata e kanë fuqinë, janë të fuqishëm, janë ata që i shohin përditë në media, i dëgjojmë për çdo ditë, sepse me ndihmën e pushtetit, të cilën ata e mbajnë në dorë, edhe e ushqejnë duke u mbajtur e ushqyer njëkohësisht nga pushtetet e ndryshme, zhdukin publikun, duke mos e nxjerrë në ekran të televizionit. Vetëm ata janë gjallë, vetëm ata janë që ekzistojnë, sepse ata e kanë pushtuar sferën publike. Populli i thjeshtë nuk është në televizion, nuk ekziston, prandaj nuk e dimë mendimin e tij. Në këto televizion defilajnë ata që kanë pushtet, që kanë fuqi, që i kanë marrë paratë, që e keqpërdorin paratë e popullit, e ju e dini shumë mirë cili është dallimi ndërmjet mediave publike dhe këto i kanë në dorë, dhe mediave private të pushtetit.

Mediat publike paguhen nga paraja publike, kurse mediat private paguhen me paratë e publikut, edhe kur ato janë të vjedhura e kriminale. Të tjera para nuk kanë asnjëra palë, e as tjetra. Mediat publike mbahen me paratë publike, domethënë me ato para që shteti ua merr qytetarëve, me rrymë e me taksa, e duke ua vjedhur në forma të ndryshme. Me krim të organizuar institucional, me korrupsion, qoftë me rrymë, e qoftë me gjithçka tjetër, e këto i sheh edhe Bashkimi Evropian.

Pra, këta janë ata që bërtasin e këlthasin tërë kohën liberalizim, janë ata që kanë mundësi të flasin publikisht, e këta janë ata që e kanë pushtuar jetën publike nëpërmjet mediave e nëpërmjet

pushtetit. Janë të paktë, por e manipulojnë krejt publikun, sepse i kanë mediat në dorë. E ata që nuk flasin janë të shumtë, është populli. Sepse ata nuk kanë qasje në hapësirën publike. Këta kanë nevojë reale e jetike për liberalizimin e vizave, sepse këtu ua kanë shkatërruar jetën, prandaj nuk u ka mbetur vend e vrap për të ikur. Edhe kjo është e vërtetë. Këta sigurisht nuk kanë për të shkuar as në skijim, as në makijazh, as të shpëllajnë para, as në hotele të shtrenjta dhe askund tjetër, por kërkojnë një perspektivë me një vend pune, ose shkollim diku që këtu ua kanë mohuar këto pushtete.

Prandaj, këta duan veç të ikin sikurse në vitin 2014 e 2015, sikur në kohën e Milosheviqit, edhe sikur në kohën e Titos, e dimë, prandaj e kemi këtë numër të madh të mërgimtarëve.

Klithja e asaj kohe për liberalizimin, kur është bërë demarkimi, ishte dhe mbetet karrem i helmatisur i pushteteve për mbulimin e mjerimit politik, ekonomik, shëndetësor, gjyqësor, sjellë në shkallën e shtetshkatërimit. Ky karrem që është i helmatisur, megjithëse i degraduar deri në absurditet, do të futet në përdorim përsëri, edhe në të ardhmen. Këtë nuk kanë për ta lëshuar prej dorës, sepse i vetmi karrem u ka mbetur. Ka mbetur edhe marrëveshja fantome, d.m.th. ligjërishit e obligueshme ndërkombëtare, që askush nuk di çka do të thotë, e Presidentit të vendit, e cila nuk dihet as çfarë përmbajtje ka dhe as në çfarë forme do të shpërfaqet, që me siguri, e për këtë jemi të sigurt, do ta cenoj edhe integritetin territorial, edhe sovranitetin e Republikës së Kosovës.

Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës duhet të jenë të përgatitur se karremi i liberalizimit që u është mbajtur para hundëve tani e dhjetë vjet do të aktivizohet sërish kur duhet copëtuar territorin, kur duhet zhbërë sovranitetin edhe ashtu të sakatosur të Republikës së Kosovës.

Këto gënjeshttra nuk duhet gëlltitur, të dashur qytetarë. Këta pushtetarë duhet të tërhiqen, të lëshojnë rrugë për legjitimitet të ri dhe për zgjedhje të reja. Kjo është porosia, liberalizimi është rrena që ka për t'u ofruar përsëri para se të harrohet kjo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi, pasi të dhanë leje edhe kolegët e tu, se të drejtë s'ke. Kur flet në emër të Komisionit, s'ke të drejtë të flasësh si deputet.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë mendoj që ka gjëra të cilat unë apo është kryetari i grupit, kur del të flasë aty nuk mund t'i thotë, për shkak se përfaqëson subjektin.

KRYESUESI: Jo, jo!

BILALL SHERIFI: Prandaj, të flasësh në emër të grupit dhe në emër tënd personal janë dy gjëra të ndryshme. Sidoqoftë, po filloj dhe shpresoj së paku do të përpiqem që të jem më i shkurtër, t'i them vetëm disa gjëra që nuk arrita t'i them si deputet. Nuk thuhet kot që qafës së shtrirë më së

miri i rri shpata, po si duket tash ka filluar të ju pengojë fakti që nuk po rri kjo qafë shtrirë, ka filluar pak ta çojë kryet. Nuk po do të rrijë krejt shtrirë, që t'i rrijë shpata më së miri. Edhe ajo çka dëgjova deri tash nga shumë kolegë është se kanë filluar të lexojnë mendime dhe deri dje interpretonim atë që thoshin përfaqësuesit zyrtarë të BE-së. Çka thoshin ata? Ata thoshin që nuk janë plotësuar kriteret për liberalizim të vizave. Njëri nga ta i famshmi, demarkacioni. Dhe, kur ata që paguhen nga Bashkimi Evropian për të folur në emër të Bashkimit Evropian, vijnë këtu, edhe thonë që janë plotësuar kushtet nga Kosova, dalin kolegët deputetë këtu thonë që jo nuk është e vërtetë ajo që po thotë BE-ja. Po pse? Sepse ata nuk po e thonë të vërtetën. Merre me mend tash, merre me mend! Edhe kur ata thonë që Kosova i ka plotësuar kushtet, këtu ka kolegë që thonë: jo, ata nuk po e thonë të vërtetën, sepse kjo nuk është e vërtetë. Epo, kjo është qafë e shtrirë. Ky është mentaliteti i qafës së shtrirë.

Jo, Kosova, sa i përket liberalizimit të vizave, i ka plotësuar kushtet. Shumica e atyre gjërave, argumenteve, pikëpamjeve, këndvështrimeve të cilat u thanë, i ndaj edhe unë me to, por ato nuk kanë të bëjnë me liberalizim të vizave, kanë të bëjnë me procesin e integritimeve. Dakord jemi. Shumë gjëra ka për t'u bërë. Ka gjëra që janë bërë dhe ka shumë për t'u bërë. Ka gjëra që janë bërë mirë, ka gjëra që nuk janë bërë mirë, por ato s'kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave. Këtu kemi të bëjmë me një temë të veçantë specifike, për të cilën e keni ftuar debatin.

Pse dështoi afati i këtij viti për liberalizim të vizave? A janë fajtores institucionet e Kosovës, apo nuk janë? A është fajtores Kosova, apo nuk është? Dhe, të gjithë ju e dini që nuk është faji dhe përgjegjësia e Kosovës për këtë çështje. Sepse, çfarëdo që është kërkuar, madje është kërkuar shumë më shumë nga Kosova dhe janë plotësuar shumë më shumë, por vendimi është politik.

Pse është vendimi politik? Sepse na është thënë, u është thënë edhe juve të cilët sot po thoni nuk është ashtu, se zgjedhjet që do të mbahen vitin e ardhshëm në BE i kanë fajet. Dhe, për të mos i dhënë terren të djathtës ekstreme të tipit të AFD-së në Gjermani e të tipit Le Penit apo bijës së Le Penit në Francë, nuk mund ta fusim në rend dite. Këtu është problemi.

Ngase edhe ata mirë e dinë që rreth 200-300 mijë njerëz të cilët potencialisht do të mund të udhëtonin për vendet e Bashkimit Evropian në një treg hapësirë prej 500 milionë banorëve, nuk e përkeqësojnë gjendjen e migrimit në hapësirën në të cilën janë 2 milionë sirianë e 1 milion irakian apo afganistanas. Pra, nuk është problemi as i migrimit, as i mosplotësimit të kushteve, por lufta ndërmjet partive politike të cilat natyrisht siç e bëjmë ne këtu, siç e bëjnë në vendet e rajonit, e bëjnë edhe ata. Ngase edhe ata janë si ne, në kuptimin e kërkimit të mundësive për të fituar sa më shumë vota në zgjedhje.

I kanë zgjedhjet për Parlamentin Evropian, dhe duan që të mos e kenë një telashe më shumë në përballjen me zgjedhësit e tyre, një. Dhe, e dyta, kemi të bëjmë me çështjen e Rumanisë. Ju e dini që gjashtë muajt e ardhshëm Rumania do ta udhëheqë Bashkimin Evropian. Është

udhëheqëse e radhës. Duke e pasur parasysh këtë, sigurisht që do të jetë vështirë në gjashtë muajt e ardhshëm.

Mendoj që këtë debat duhet ta shfrytëzojmë që në mënyrë unike, ashtu siç e thotë miku i Kosovës për të cilin, sidomos LDK-ja ka fjalë shumë të mëdha, në postimin e vet që e paska bërë në Twitter zoti Engel, lexojeni, thotë: Mosliberalizimi është tradhti e premtimeve të BE-së. Nuk po e them unë, po e thotë njëri nga miqtë më të mëdhenj të Republikës së Kosovës.

I zhgënjyer nga komisionari i BE-së Johannes Hahn, i cili tha se liberalizimi i vizave për Kosovën do të shtyhet përsëri. Kosova ka bërë çdo gjë që është kërkuar nga BE-ja. Refuzimi i liberalizimit të vizave është tradhti e premtimeve që ka bërë BE-ja, ka thënë Eliot Engel.

Ne nuk duhet që asgjë më shumë që së paku për këtë çështje të bëjmë, pos t'i bashkëngjitemi konstatimit të zotit Engel. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Gani Dreshaj e ka fjalën.

GANI DRESHAJ: E kam humbur rendin, por së pari do të ishte mirë që të shikojmë ne se a kemi faj në Parlament dhe të shohim se çfarë kemi bërë ne parlamentarët nga mëngjesi.

Mua po më vjen marre që do të më shohë djali im, kam ardhur nga Hamburgu. E kam humbur ditën, edhe punën. E nëse ka dikush faj që s'i kemi marrë vizat, i kemi ne në Parlament të gjithë së bashku.

Sikur një deputet i Brukselit, i Bashkimit Evropian sot ta shihte këtë cirkus që është duke u bërë këtu, ku ne flasim për gjëra që kanë ndodhur para 300 vjetëve para e prapa, nuk shtyhet bjeshka me gjoks. Nuk mund ta kushtëzojmë ne Bashkimin Evropian, e as me kisha as me xhamia nuk na e kanë inatin fare, por ne është mirë që t'i kryejmë punët tona si parlamentarë.

Ndoshta më pak faj Qeverisa sesa ne vetë. Sa kemi lobuar ne si deputetë të Parlamentit, si parti opozitare, si Qeveri? Është e lehtë që t'i lihet faji dikujt tjetër, ngase faji është jetim.

Të përpiqemi dhe të shikojmë se çfarë mund të bëjmë nesër. Çfarë mund të bëjmë pasnesër. Si t'u jepet e drejta qytetarëve tanë që të lëvizin lirshëm. Të mos shtyhem ndërmjet vete, të përlahemi ditën dhe natën në mënyrë që t'i fitojmë zgjedhjet e ardhshme, sepse nuk na ka faj Bashkimi Evropian.

Po ju them të drejtën se edhe unë sikur të isha deputet i Bashkimit Evropian dhe sikur ta shihja vetëm seancën e sotme, as unë nuk do të votoja për.

Ata janë njerëz me integritet. Edhe zoti Hahn e ka thënë në kontekst të nervozizmit që i kemi rritur taksat, por nuk është përmbysur bota, sepse as ai nuk është zoti i Bashkimit Evropian. Nuk mendoj se do të vonohen edhe dy vjet vizat, por krejt varet nga deputetët. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Rekaliu.

FIDAN REKALIU: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarët e Kosovës, të rinj e studentë, ndërmarrës, sportistë e artistë, dje e morën një lajm të keq. Liria e lëvizjes s'është afër që të ndodhë.

Nuk ka sesi të lexohet ndryshe kjo ngjarje përveçse fatkeqësisht duhet ta konstatojmë se jemi në pikën kur partnerët tanë ndërkombëtarë që, në periudha kyçe na janë gjendur pranë, e kanë humbur besimin në atë se çfarë është duke performuar Kosova me sjelljen politike dhe qeverisës, qoftë në planin e brendshëm apo të jashtëm.

Ne jemi të bindur se vendimmarrësit në Bruksel po japin mesazhe refuzuese ndaj udhëheqjes politike institucionale të Kosovës. Kjo është çfarë po ndodh sot, por dje nuk ishte kështu.

Të gjithë janë dëshmitarë se në vitin 2016 vendet mike të Kosovës në Bashkimin Evropian s'kishin asnjë dilemë për vizat, por e prisnin kriterin e fundit demarkacionin e kufirit me Malin e Zi, kriter të cilin e sabotua, e penguan haptazi e fshehurazi ata që sot me udhëheqjen e tyre të mbrapshtë e kanë nxjerrë shtetin e Kosovës jashtë binarëve kushtetues e institucional.

Atëbotë, në Perëndim kishte besim në Kosovën për shkak se qeverisej në frymën e Kushtetutës dhe të shtetit të së drejtës. Qeverisej nga Lidhja Demokratike e Kosovës, e cila në çdo rast si në pushtet si në opozitë, për demarkacionin, ushtrinë apo pakon e reformave për Bashkimin Evropian kishte qëndrim konstant në të mirë të shtetit dhe të qytetarëve të vet.

Lidhja Demokratike e Kosovës për çdo ditë e ofronte Kosovën me standardet e një shteti të modelit perëndimor. Është e qartë e do të jetë edhe më e prekshme në të ardhme se qoftë vizat, zhvillimi dhe integrimi, rendi dhe ligji në Kosovë mund të ndodhin vetëm me Lidhjen Demokratike të Kosovës.

Kjo do të ndodhë shpejt. Kosova, sidomos të rinjtë e saj do të reagojnë dhe do të vendosin ta dërgojnë në histori mentalitetin që e kthen shtetin në servis të grupeve të interesit, qoftë politike, ekonomike apo të fushave të tjera.

Me këtë Qeveri, mos zot më keq, problem të ecën përpara ky vend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, që edhe në këto orë të vona sot po na përcillni, Jo për të bërë një zgjidhje për ju, por për të paraqitur dhe parashtruar apetitet politike tona dhe të parashtruesve të kësaj kërkesë për debat parlamentar.

Apetitet as nuk janë për interesin e qytetarëve, as për liberalizim apo brengosje për mosliberalizim të vizave, sepse e shikova këtë listë të nënshkruesve të kësaj seance të jashtëzakonshme, edhe mund të konstatoj bazuar në atë që njihemi, që 80% e këtyre që kanë parashtruar këtë kërkesë i kanë nga dy ose tri pasaporta dhe lëvizin lirshëm pa asnjë problem.

As që e kanë hallin në këto orë të vona të natës që qytetarët e Kosovës nuk mund të lëvizin lirshëm. Po ta kishin këtë hall që qytetarët e Kosovës të lëviznin lirshëm, sigurisht që kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare të drejtuara me kohë për institucionet e Republikës së Kosovës, në veçanti për Kuvendin, do të adresoheshin dhe do të zgjidheshin me kohë.

Ne nuk mund të sillemi në atë formë duke menduar se e gjithë bota e ka orientimin rreth nesh, se ne jemi epiqendra e zhvillimeve në Evropë dhe në botë.

Proceset kalojnë, sepse ne vonohemi. Edhe sot në këtë debat po debatojmë për atë që ne jemi vonuar në të kaluarën. Edhe rrethanat politike në Evropë, u tha edhe nga parafolësit, sot janë determinuese për përcaktimin apo për vendimin për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Por, këto rrethana politike tre vjet më parë ishin në favorin e Republikës së Kosovës, dhe ne nuk i shfrytëzuam. Ata që sot këtu e kanë nënshkruar këtë kërkesë, janë po të njëjtin që e bllokuan Kosovën para tre vjetësh, 100% ose 50%.

Po, po, se edhe këtu ka parashtrues të kërkesës që ishte kundër demarkacionit më herët. Nëse për asgjë tjetër, Qeveria e Republikës së Kosovës me Ramush Haradinajn, ajo që duhet vlerësuar është për kapërcimin nga njëri pozicion në pozicionin tjetër, sepse ishte kundër demarkacionit dhe e kaloi demarkacionin. Po përse e kaloi? E kaloi për lëvizjen e lirë për interesin e qytetarëve.

Edhe disa nga deputetët e Lidhjes Demokratike që nuk e dëgjuan Isa Mustafën e dëgjuan Ramush Haradinajn që ta votojnë demarkacionin. Është më se e vërtetë. Por, që kjo na mundësoi që ta plotësojmë kriterin për liberalizimin e vizave. Dhe sot, ky debat po bëhet për konsum të brendshëm politik, ose për ta bindur dikë që të shkohet në zgjedhje.

Deklarimet e zyrtarëve të Bashkimit Evropian janë të qarta, Kosova i ka plotësuar të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave.

Qeveria e Republikës së Kosovës, kjo dhe qeveria paraprake i kanë meritat e tyre në këtë rrugëtim. Sepse, jemi mësuar që meritat t'ia japim vetëm dikujt dhe të tjerëve jo. Është punuar edhe në qeverinë e kaluar dhe është punuar edhe në këtë Qeveri që të plotësohen të gjitha kriteret.

Nëse një subjekt politik ka qenë konsistent në qëndrimet e tij, në deklarime dhe veprime, është Partia Demokratike e Kosovës me agjendën e saj evropiane. Asnjëherë në asnjë moment, Partia Demokratike nuk ka pasur dilema se cilën rrugë duhet ndjekur dhe me cilët aleatë duhet të bashkëpunojë në rrugën evropiane. Kjo është më se e qartë dhe këtë duhet t'ua themi të gjithëve, sepse në këto orë të vona qytetarët e Republikës së Kosovës nuk kanë pse e mbajnë televizionin ndezur që të na dëgjojnë neve sa i përket një kriteri që ne e kemi plotësuar.

Do të ishte mirë, se di nëse e dinë të gjithë qytetarët formën sesi është parashtruar kjo kërkesë për debat dhe që kjo kërkesë për debat nuk ka asnjë konkluzion, dhe nuk pritet që pas këtij debati ne të votojmë diçka ose të miratojmë diçka në interesin e qytetarëve. Pse? Sepse, pas kësaj, ne nuk kemi çka të votojmë. Ne i kemi plotësuar kriteret, problemi është te Bashkimi Evropian. Te vendimi të cilin Bashkimi Evropian duhet ta marrë për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Çka mund të bëjmë ne sot? Ne nuk mund të rrimë dhe të vajtojmë, se pse ata nuk e mbajtën fjalën. Popullit thotë, atë që e kam dëgjuar nga gjyshi im që; nuk është marre të të mashtrojë dikush, marre është të jesh mashtrues. Dhe, ne nuk jemi mashtruesit. Dhe, ne i kemi plotësuar kriteret tona.

Është dikush këtu që mburret se është mashtrues, sepse i ka mashtruar mbi dy-tri subjekte. Ka lëvizur nga njëri në tjetrin subjekt, mashtroje këtë, dil andej, dhe ajo që tani diskutoi ishte e njëjta. Po, po ka mashtrues plot këtu që kanë lëvizur nëpër parti politike.

Në demokraci ekziston kjo, por ne duhet t'u japim qytetarëve tanë në veçanti, sepse edhe parashtruesi i kërkesës, edhe nënshkruesi, zoti Zemaj, i kësaj kërkesë për debat të jashtëzakonshëm në orët e vona të natës, pak para orës 24:00, dhe... Po, ju e dini pse s'është mbajtur në orën 16:00, se e ke bërë shprehi që të ndërhysh, po të them kështu; mos falsifiko dhe je në rregull!

Mos falsifiko se mund të pësojë Avdullahu pastaj, sepse ishte edhe në media që Avdullahu mund të shkojë në burg për falsifikim. Mos e godit shefin. Por, po ju them një gjë. Çka duhet të bëjmë sot? Cili është mesazhi kur dihet se Qeveria i ka plotësuar kërkesat? Cili është mesazhi që ne duhet ta përçojmë?

Sot në botën perëndimore në shtete e Evropës ekzistojnë dhe jetojnë qytetarë me të drejtë vote, që janë shqiptarë. Nëse partitë politike në Evropë e kanë hallin e zgjedhjeve të tyre brendshme, atëherë ne mund t'i orientojmë qytetarët tanë në Evropë që votën e tyre ta orientojnë për partitë politike të cilat e mbështetin liberalizim dhe të drejtën elementare qytetare të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Këtë duhet t'ia sugjerojmë çdo qytetari dhe këtu Ministria e Diasporës duhet të punojë më shumë që ta kemi një qytetari më proaktive shqiptare në Evropë dhe që të jenë, jo vetëm vëzhgues të proceseve, sepse nuk kishte nevojë që të thirreshin protesta në Prishtinë kundër Hahn, por protestat duhet të jenë në Bruksel, për shkak se vendimmarrja është atje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Albulena Haxhiu. Atëherë po ia jap fjalën Rasim Selmanajt, pastaj flet Albulena. A dëshiron ta zëvendësojë dikush nga ju? Nëse dëshironi ju, e keni ju radhën. Zoti Arbër, a po? Arbër Rexhaj, regjia!

ARBËR REXHAJ: Faleminderit!

Këtu pati deklarime të deputetëve të cilët ndanin faje me përqindje, diku 100 e diku 50%, dhe Vetëvendosjes ia faturuan fajin e bllokimit të liberalizimit të vizave me përqindje për 100%, sepse atëbotë i pati ndalur demarkacionin dhe Zajednicën dhe në fakt kur sot nuk po liberalizohen vizat, duhet të shtrohet pyetja themelore; Pra, ku janë ata 8 200 hektarë tokë që iu falën Mali të Zi?

Dhe, nëse iu janë falur pra “Cërna Gores”, ku mbeti çështja e liberalizimit të vizave dhe ne si deputetë, si përfaqësues, por edhe qytetarët duhet ta kërkojmë rikthimin e atyre tokave, sepse fundi i fundit ato e kanë cenuar territorin e Republikës së Kosovës. Prandaj, ky faji i bllokimit 100% nuk është i Vetëvendosjes, por është kryekëput i Partisë Demokratike të Kosovës, sepse është e keqja më e madhe e vetë Republikës së Kosovës. E tash po kaloj te fjala ime:

Të nderuar qytetarë,

Kjo Qeveri e dobët e Republikës së Kosovës të një viti të dështuar plotësisht në aspektin e politikave të jashtme ndërkombëtare e ka dobësuar ndjeshëm përforcimin e sovranitetit të saj ndërkombëtar, duke dështuar për anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, si: UNESCO, tri herë në Interpol, tashmë epilogu thotë që po dështojmë edhe në liberalizim të vizave.

Kjo Qeveri e ka futur Kosovën në geto të Evropës. Tërheqja tashmë e dhjetë njohjeve tregon theqafjen se ku po e dërgon Republikën e Kosovës kjo Qeveri me Ramush Haradinajn dhe me një president, i cili po e rrezikon sovranitetin dhe territorin e vendit.

Në një vend ku sundon krimi e korrupsioni, kapja e institucioneve të drejtësisë dhe në veçanti vrasja e aktivistëve politik nëpër burgje, dhe edhe po qe se i fal tokë Malit të Zi për hir të

demarkacionit të kufirit, sërisht nuk mund të kesh liberalizim të vizave dhe për këtë sigurisht që neve na vjen keq.

Dje, komisionari evropian për politika të fqinjësisë dhe negociata të zgjerimit, zoti Hahn tha se viti 2020 është datë realiste për liberalizim.

Kjo është përgjigjja për Qeverinë e Kosovës, e cila festoi me dhjetëra herë, dhe bartësit e institucioneve talleshin me qytetarët e Republikës së Kosovës, një herë duke pretenduar se falja e 8 200 hektarëve tokë do të sillte liberalizim dhe fundin e bllokimit të vendit tonë në raport me Evropën.

Kryeministri së bashku me të tjerët e dha këtë tokë, ndërsa tani ai parimisht edhe duhet të japë dorëheqje.

Ju kujtohet sesi kryeministri Haradinaj disa herë ka premtuar se me t'u bërë kryeministër, e edhe kur u bë kryeministër thoshte se do të ketë liberalizim të vizave brenda tre muajve. Tash, ky kryeministër nuk e sheh fajin që u nda këtu me përqindje të Qeveria e tij, por mundohet ta gjejë jashtë, ndërsa bartës të institucioneve të tjera e gjejnë fajin edhe deri te Serbia.

Evropa nuk mund t'ia hapë kufijtë Kosovës, sepse për t'ia hapur duhet luftuar krimi e korrupsioni dhe në veçanti kjo që quhet shkapje e institucioneve të drejtësisë. Prandaj, nuk ka as liberalizim, e as përforsim të pozicionit ndërkombëtar.

Duke ua futur thesin në kokë shtetasve turq, duke i depërtuar e duke i lënduar thellë institucionet demokratike të Republikës së Kosovës, duke i shkelur të drejtat dhe liritë individuale të njerëzve nuk mund të kemi liberalizim dhe ky nuk është faj i opozitës. Ky është faj i Qeverisë.

Prej dhjetorit 2009, Hashim Thaçi pati deklaruar se qytetarët e Kosovës brenda 13 muajve do të udhëtojnë në të gjitha vendet e Evropës pa pasur nevojë për viza. Kjo gënjeshtër ka vazhduar në vitin 2019, kur ai thotë se brenda 15 muajve do të realizohet ky proces.

Njëjtë pati deklaruar në tetor 2011, po ashtu edhe në shtator 2013. Kjo ka zgjatur deri më sot.

Në maj 2017, zoti Haradinaj pati thënë: Unë nuk shoh periudhë më të gjatë se tre muaj nga momenti i nisjes së punës për liberalizim. Po ashtu, në dhjetor 2017, Ramush Haradinaj, ky kryeministër deklaronte se me qeverinë e re brenda 90 ditësh qytetarët e Kosovës do të udhëtojnë pa viza në Gjermani, Zvicër, Austri dhe në gjithë Evropën.

Plot dhjetëra vite që flitet për liberalizim. Plot dhjetëra vite që mashtrohen qytetarët tanë. Shteti i Kosovës ka mbetur në duar të kësaj Qeverie të korruptuar e të padijshme, kurse qytetarët tanë përfitojnë veç përbuzjen, injorimin dhe gënjeshtren.

Dikush këtu tha pse ne si opozitë nuk e shprehim keqardhjen. Sigurisht që e shprehim keqardhjen. E shprehim keqardhjen për qytetarët tanë. Dëshmi për këto që thashë janë edhe institucionet publike, për çështjen e korrupsionit. Ato janë mbushur me militantë partiakë, që në një formë shteti është shndërruar në pronë private e në shërbim të këtyre politikanëve të korruptuar.

Prandaj, qytetarët nuk e meritojnë këtë ndëshkim që vjen nga kjo Qeveri dhe qeveritë e kaluara, sepse nuk po e amnistojmë asnjë qeveri. Dhe, kjo Qeveri e dështuar duhet ashtu siç është e dështuar edhe ne ta dështojmë, për të mos e dështuar shtetin tonë.

Prandaj, kryeministri dhe të tjerët duhet të japin llogari, dhe llogaria e tyre politike sigurisht ka të bëjë me dorëheqjen. Kjo është parimore dhe e drejtë.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhaj! Zoti Selmanaj e ka fjalën.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

U tha e u përsërit këtu nga kolegët se kjo Qeveri i ‘paska gënjyer’ qytetarët për liberalizimin e vizave. Në rregull, ne prapë po e them ‘paskemi gënjyer’, sepse kemi besuar në premtimet e përfaqësuesve të BE-së, e përtej kësaj, kemi besuar në vlerësimin që BE-ja e ka bërë për përmbushjen e kriterëve nga Kosova.

Nëse ne ‘paskemi gënjyer’ për një vit, po ju, të nderuar kolegë të LDK-së, i bie se paskeni gënjyer për afro 10 vjet dhe premtimet në kohën e LDK-së vijnë në kohën kur BE-ja nuk e ka pasur vlerësimin se Kosova i ka përmbushur kriteret.

Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë për opozitën: A e keni hallin e vizave, apo të zgjedhjeve? Nëse e keni hallin e liberalizimit, atëherë në Qeverinë Haradinaj po thuhet nga BE-ja se janë përmbush kriteret, Parlamenti Evropian ka votuar pro, Komiteti për Politikë të Jashtme ka dhënë vlerësim pozitiv, tash jemi në momentin kur Këshilli i Ministrave do të duhej ta caktonte datën, por u tha që kjo s’po ndodh për shkak të problemeve politike.

Të kthehemi te çështja e dytë, nëse e keni hallin te zgjedhjet, atëherë ky është një proces shumë normal, në këtë Parlament është votuar kjo Qeveri, nëse dëshironi zgjedhje, urdhëroni, keni mundësi ligjore dhe kushtetuese të ofroni mocionin për shkarkimin e qeverisë, e jo thjesht të mbani ligjërata këtu dhe demagogji të panevojshme.

Dhe, unë mendoj se ajo që e tha edhe deputeti i Nismës, i mikut tonë, Engel, atëherë a duhet besuar këtyre miqve ndërkombëtarë edhe bashkësisë evropiane që po thotë se Kosova i ka përmbushur kriteret, apo kujt t'i besojmë në këtë rast?

Kështu që nëse keni thirrur seancë të jashtëzakonshme për liberalizim të vizave, atëherë kjo është e vërteta. Nëse kërkoniz zgjedhje, rruga është e hapur, urdhëroni, ofroni mocionin e rrëzimit të Qeverisë. Por, ju e dini që nuk i keni numrat dhe Qeveria nuk bie. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Bekim, a pate replikë, a çka deshe, replikë, ke të drejtë.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Nuk është replika me rëndësi, është me parafolësin, me Arbrin, sepse edhe vetë, unë vlerësimin e bëra për kundërshtim me demarkacionin, do të thotë 100% Vetëvendosja ka qenë kundër demarkacionit, LDK-ja përafërsisht në bazë të numrit të deputetëve që ka pasur, 50% prej tyre kanë kundërshtuar.

Arbri e ndryshoi këtë, e bërë që... (*ndërhyrje*) po aq shumë e keni kundërshtuar sa që është dashur ambasadori amerikan të vijë në grupin parlamentar, se s'ju ka zënë zyra atje në Dragodan.

Por Arbëri e vlerësoi ndryshe, do të thotë, 100% fajtor për liberalizimin apo mosliberalizimin e vizave Vetëvendosja, 50% LDK-ja, është vlerësim real, Arbër. Faleminderit!

KRYESUESI: Po zoti Arbër, e ka fjalën, kundërreplikë.

ARBËR REXHAJ: Kjo që tha deputeti është bajate dhe është degradim. Në fakt, as që ishte humor ajo që tha dhe mua po më vjen shumë keq kur ky Kuvend po bëhet arenë jo e mirë e debatit, por po kemi kësi lloj përgjigjesh, të cilat janë edhe të lodhëta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Arban Abrashi.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sot jemi dëshmitarë të një pakënaqësie ekstreme që mbizotëron në Kosovë si pasojë e një qeverisje të keqe.

Viti i fundit u karakterizua me një qeverisje të keqe, me një Qeveri me disa nënqeveri, degradim total të shtetit të Kosovës.

Qeverisja aktuale ka shmangur fokusin nga detyrat ndaj qytetarit të Kosovës dhe qytetari i Kosovës ka qenë vetëm një shikues në vendin e vet.

Me këtë qeverisje njëvjeçare janë zhdukur më shumë se 15 mijë vende të punës, janë tërhequr njohje, është dështuar me anëtarësimin në organizata të huaja, janë rënë investimet e huaja dhe fatkeqësisht janë përkeqësuar deri në pikën e fundit marrëdhëniet me SHBA-në dhe me BE-në.

Fatkeqësisht sot Kosova është vendi më i izoluar në Evropë, kurse të rinjtë perspektivën e shohin jashtë saj, e që është më keq Qeveria fare nuk shqetësohet për këtë rast.

Tek tema e sotme, vizat dhe integrimet evropiane, dua t'i shpalosi disa fakte, të cilat nuk janë përmendur dhe nuk janë trajtuar më herët.

Te liberalizimi i vizave ka ndodhur një mashtrim i qëllimshëm i opinionit publik. Është deklaruar se pritet që vizat të hyjnë në agjendë të Këshillit të Ministrave, që është një mashtrim.

Parlamenti Evropian ka votuar dhe i ka dhënë mandat komisionit LIBE për nisjen e negociatave ndërinstitucionale me Këshillin e BE-së dhe Komisionin Evropian, pra një mandat për të filluar dialogun, që në fakt janë takime joformale ndërinstitucionale trepalëshe mes Komisionit, Parlamentit dhe Këshillit të BE-së, në bazë të rregullave të procedurës.

Sipas këtyre rregullave të procedurës, seksioni tre, specifikisht thuhet se çdo marrëveshje e përkohshme që arrihet në dialog është joformale dhe duhet të miratohet në procedurën formale që aplikohet në dy institucione legjislative, në Parlament dhe në Këshill.

Pra, për të sqaruar, nuk ka qenë votimi në kuadër të plotësim-ndryshimit të Rregullores 539/2001 të Parlamentit, rrjedhimisht çështja e liberalizimit të vizave nuk ka mundur të hyjë në agjendën e BE-së më 6 dhe 7 dhjetor, pa një votim paraprak të Parlamentit Evropian.

Prandaj, njohësit e integritimeve e kanë ditur që vizat nuk janë fare në agjendë, derisa publiku është mashtruar qëllimshëm.

Pra, në fund të dialogut duhet edhe një votim tjetër formal nga Parlamenti Evropian, gjë që nuk ka ndodhur, prandaj edhe vizat nuk kanë qenë të planifikuara për këtë datë.

Te shtylla tjetër e integritimeve evropiane, Agjenda e Reformës Evropiane, që në fakt janë prioritetet të MSA-së, me qëllim që të arrihet integrimi i Kosovës në BE, kemi stagnim të plotë, të themi nga 22 prioritetet, rreth 85% të prioritetëve kanë mbetur pa u përmbushur.

Disa prej prioriteteve të papërbushura janë veprimet politizuese, po e citoj raportin me emërime të larta në institucionet publike, në institucione të pavarura, borde të politizuara, në agjenci rregullatore, nuk janë marrë masa në sigurimin e transparencës së financimit të partive politike, e shumë të tjera.

Derisa në rrafshin ekonomik, në kuadër të Agjendës së Reformës Evropiane investimet e huaja direkte në Kosovë kanë shënuar një rënie rapide, kurse sipas Bankës Botërore, në raportin e të bërit biznes Kosova ka shënuar regres.

Në kuadër të zhvillimit ekonomik, në kuadër të agjendës evropiane gjithashtu papunësia është rritur për 3%, kurse janë zhdukur mbi 15 mijë vende të punës.

Te shtylla e tretë e integriteteve evropiane, siç është MSA-ja, marrëveshja e parë kontraktuale me BE-në, zbatueshmëria e saj ka shënuar një rënie shqetësuese.

Në vitin 2016, zbatueshmëria e MSA-së ka qenë diku rreth 53 deri 55%, në vitin 2017 gjatë qeverisjes Mustafa ka arritur në 63%, ndërsa në qershor të vitit 2018, në matjen e fundit të zbatueshmërisë së MSA-së, zbatimi ka rënë në afro 13%.

Qytetarë të nderuar,

Për të ndryshuar këtë gjendje, për të plotësua detyrimet e BE-së, detyrime që kemi si shtet në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, duhet një mendësi e re politike.

Duhet një ekip që komunikon mes veti, që ka në fokus qytetarin, që respekton ligjin dhe që ka vizion. Duhet Qeveri që flet për plane, për zhvillim dhe mirëqenie, për vende pune, një Qeveri që e do Kosovës. Kurse sot dëgjojmë një opozitë që numëron dështimet e Qeverisë dhe një Qeveri që numëron arsye të.

Kjo Qeveri duhet të lëshojë rrugë, për t'i hapur rrugë ndryshimit të shumëpritur në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, zoti Haliti!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sot e kemi ftuar një seancë të jashtëzakonshëm për dështimin, të quajtur ashtu, të institucioneve të Kosovës për liberalizimin e vizave.

Ne realisht duhet të jemi të sinqertë para opinionit publik dhe jam shumë optimist se edhe ata të cilët sot e kanë thirrur këtë seancë, më shumë e kanë për konsum të brendshëm, sepse e dinë qysh është realiteti në Republikën e Kosovës.

Ne kemi pasur shumë kritere nga BE-ja, konsideroj që kanë qenë shumë të padrejta për qytetarët tonë, nëse i krahasojmë edhe me shtetet të cilat e rrethojnë Kosovën, nga Shqipëria, Maqedonia, Mali i Zi, Serbia, mendoj që ato kritere ne i kemi plotësuar shumë më herët.

Ne e dimë, u tha edhe nga shumë kolegë, që në legjislaturën e kaluar kemi pasur vetëm një kriter, kemi pasur takime edhe si deputetë apo me zyra të ndryshme të shteteve të Quintit apo të BE-së, në përgjithësi, që kanë thënë që nëse ju e kaloni demarkacionin me Malin e Zi, prapë ka qenë e njëjta pikë, që është edhe sot. Nëse ka argumente njëra palë, duhet ta rishikojmë, ne do gëzojmë këtë të drejtë që qytetarët e Republikës së Kosovës do të kishin lëvizur pa viza dhe nuk ishim sot duke e diskutuar këtë temë, nuk ishim sot duke e fajësuar njëri-tjetrin, nuk ishim sot as duke u arsyetuar, po kishim folur për obligime të tjera që do t'i kishim pasur si institucione të vendit.

Ne e dimë çfarë imazhi i kemi krijuar Kosovës me ato skena që i kemi pasur pikërisht në këtë sallë, ne e dimë që nuk i kemi krijuar imazh të mirë, ne e dimë që jemi vetë ata, pozitë e opozitë, me veprime apo mosveprime që e kemi penguar procesin e liberalizimit.

Mendoj që është një moment tjetër në rrethana të cilat jemi, në veçanti pas raportimit apo deklaratave që i bëri Komisari i BE-së për Kosovën, zoti Han, në këtë rast, i cili deklaroi se liberalizimi i vizave për Kosovën do të shtyhet, edhe pse Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret nga BE-ja.

Unë vetë jam anëtar i Komisionit për Legjislacion, kemi pasur takime të vazhdueshme edhe me faktorë të jashtëm, edhe me Apostolovën, edhe këtë vit na është thënë që nëse kalojnë këto ligje, të cilat kanë të bëjnë me ERA-n, Kosova do ta plotësojë kriterin që të hyjë në agjendën e Parlamentit Evropian që të paktën në tremujorin e parë të vitit 2019 t'i kemi liberalizimin e vizave.

Mendoj që e kemi kryer kryesisht punën tonë, por ende po shohim që nuk jemi në rrugën e liberalizimit të vizave edhe në vitin 2019.

Ne duhet të kemi të qartë se shpesh kemi thënë që këto janë kriteret, për shembull, luftimi i korrupsionit duhet të ndodhë në vazhdimësi, është pikë e zezë, ka qenë edhe në raporte për Kosovën, është pikë e zezë që duhet të luftohet edhe kur ta kemi liberalizimin, edhe kur të jemi në OKB, edhe kur të anëtarësohemi në të gjitha organizatat ndërkombëtare, edhe në NATO. Unë mendoj dhe thërras që ato dukuri negative duhet të luftohen pavarësisht kush është sponsorizues ose kush është përkrahës i tyre, sepse korrupsioni kur ka ndodhur e kemi parë që nuk i ka parë

shumë as kombësitë, as nacionalitetet, as partitë, po ka ndodhur te ata njerëz që e kanë shkelur ligjin dhe mendoj që janë organet e tjera kompetente që duhet të merren me ato veprime.

Sa u përket deklarimeve, sidomos nga partitë që kanë qenë kryesisht më shumë në pushtet se sa në opozitë, në veçanti deputetët e Lidhjes Demokratike flasin shumë për borde. Nëse i doni listat e bordeve, 50% anëtarët e tyre, që janë ndërmarrje publike, aktualisht janë anëtarë të Lidhjes Demokratike, që janë shkuar prej Lidhjes Demokratike. Ne mund të flasim për secilën ndërmarrje veç e veç, po flas për ndërmarrje publike.

(Ndërhyrje)

Jo, po ju them edhe juve, po edhe këta se herë po bëhen me ju e herë po i pengojnë proceset, po ne mund të flasim me emra, po unë mendoj që nuk jemi këtu për ta gjetur fajtorin, sepse fajtori dihet, po ne jemi këtu dhe mendoj që kjo rezoluta juaj nuk i bën mirë as liberalizimit të vizave, as zhvillimit të vendit, sepse e dini edhe ju që kjo nuk mund të ndodhë, këto pikat që i keni propozuar ju. U tha nga shumë deputetë është mirë që të mblidhen shefat e grupeve, pse jo edhe kryetarët e partive politike, të bëhet një konsensus që të kemi ndoshta një letër apo një shkresë me pika apo një rezolutë e i drejtohem secilit deputet të Parlamentit Evropian dhe t'i kemi kërkesat tona të qarta, sepse nuk është e drejtë, i vetmi popull në këtë pjesë të kontinentit jemi që e kemi të mohuar të drejtën elementare, të drejtën e lëvizjes.

Më nuk është as e lëvizjes së lirë, nuk konsideroj që është lajm për qytetarët e Republikës së Kosovës më liberalizimi, realisht secili prej neve, pozitë e opozitë, të paktën prej 2009-ës u kem thënë qytetarëve që shumë shpejt do ta kemi lëvizjen e lirë, e kanë pasur qytetarët e shteteve të tjera përreth neve, por jo ne.

Unë konsideroj që duhet të shkojmë edhe më tutje, e kemi pasur një mbledhje të dy qeverive, në këtë rast të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës, mendoj që duhet të merren hapa konkretë se qytetarët nuk kanë kohë të presin, të shikojmë anët ligjore që Republika e Shqipërisë ta shikojë një formë të na e mundësojë që secili qytetar i Republikës së Kosovës të ketë të drejtë të pajiset me pasaportë të Republikës së Shqipërisë dhe ta gëzojmë këtë të drejtë, që të na njihen dyshtetësitë, edhe shtetësia e Shqipërisë. Mendoj që është rruga më e afërt për të pasur lëvizjen e lirë qytetarët. Të paktën këtë mendoj që mund ta bëjmë, kanë të drejtë ta bëjë edhe presidenti i Republikës së Shqipërisë me një dekret dhe kisha kërkuar nga Shqipëria të marrë një hap konkret dhe të mos mbesin qytetarët tanë të izoluar.

Unë pajtohem që këtu ka njerëz me shumë pasaporta, ka njerëz edhe me shtetësi të tjera, ka njerëz që nuk e kanë problem, as të paktën ne si deputet nuk e kemi problem lëvizjen e lirë, s'e kanë as ministrat e as zëvendësministrat, s'e kanë as ata përgjegjësit apo zyrtarët e lartë institucionalë, po e kanë qytetarët e këtij vendi.

Andaj, kërkoj nga gjithë ne që të jemi unikë në këtë drejtim. Ne i kemi parë të gjitha deklaratat e zyrtarëve të BE-së, edhe deklaratën e zotit Igor Sholtes, i cili është raportues për Kosovën në Parlamentin Evropian, ai ka reaguar pas deklaratës së Hanit dhe tha se Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret dhe çdo vonesë për qytetarët e Kosovës për liberalizimin konsiderohet që është e padrejtë.

Andaj, unë edhe një herë kërkoj që ta shikojmë një formë, ta kemi një rezolutë të harmonizuar dhe t'i drejtohem edhe Parlamentit Evropian që ta ketë parasysh që ta shtijë në agjendë çështjen e liberalizimit për Kosovën, në të njëjtën kohë t'i drejtohem edhe Republikës së Shqipërisë, e në veçanti presidentit të Shqipërisë që me një dekret ta shikojë rrugën ligjore që qytetarët e Republikës së Kosovës ta kenë mundësinë ta marrin edhe shtetësinë e Republikës së Shqipërisë dhe të njëjtën kohë ta gëzojnë të drejtën elementare për qytetarët tanë.

Unë ju falënderoj edhe një herë për fjalën.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Beqa! Fjalën e ka zonja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Është e vërtetë që u thanë shumë çështje, megjithatë po mundohem të ndalem edhe në disa pika, duke pasur parasysh që nuk u përmendën.

Së pari, që nga viti 2015, në kohën kur janë nënshkruar dy marrëveshje të dëmshme, marrëveshja për demarkacionin dhe ajo për Zajednicën, kanë nisur akuzat në drejtim të Lëvizjes Vetëvendosje, apo propagandës e shpifjeve në drejtim të Lëvizjes Vetëvendosje që kinse për shkak të kundërshtimit të demarkacionit po e pengon liberalizimin e vizave dhe po i mban të izoluar qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pra, kështu ka qenë për vite me radhë, është bërë një propagandë kundrejt Lëvizjes Vetëvendosje dhe besoj që e kujtoni edhe ju që në kohën kur para votimit të demarkacionit, kjo u përmend edhe nga deputetë të tjerë, u premtua që në momentin kur do të votohet demarkacioni me Malin e Zi, qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund të lëvizin lirshëm.

Menjëherë pas votimit të demarkacionit, sikur sot e kujtoj ekzaltimin e deputetëve të koalicionit, kryeministrit, ministrave dhe pas atij votimi, në fakt, menjëherë kanë ndryshuar edhe deklaratat e tyre.

Pra, pastaj kanë ndryshuar në kuptimin që ndoshta edhe do të mund të mos ta kemi të drejtën e lëvizjes së lirë dhe kjo varet pra nga Bashkimi Evropian. Pra, ka pasur ndryshime në vazhdimësi të qëndrimeve të koalicionit, por pasi u votua demarkacioni, tani kemi pasur deklarata të papranueshme të ministres së Integritimit, e cila i akuzon qytetarët e Republikës së Kosovës,

apo i fajëson qytetarët e Republikës së Kosovës që janë fajtorë për shkak të migrimit ilegal. Pra, për shkak se qytetarët migrojnë ilegalisht këta janë përgjegjës siç ka thënë ministrja e Integritimit të Kosovës nuk e ka liberalizimin e vizave.

Por, shtrohet një pyetje se pse qytetarët e Republikës së Kosovës migrojnë ilegalisht? Pra, kush është fajtor që qytetarët e Republikës së Kosovës migrojnë ilegalisht? Sidomos PDK-ja ka udhëhequr dikasteret më të rëndësishme në Republikën e Kosovës dhe pse qytetarët migrojnë ilegalisht përgjegjës kryesor është PDK-ja. Pra, Hashim Thaçi sa ka qenë kryeministër i vendit që nga 2009 i kemi si të them të freskëta deklaratat e tij që Kosova do ta ketë liberalizimin herë këtë vit, herë atë vit, pra nuk e patëm, përkundrazi, e kjo është arsyeja se pse qytetarët, jo nga dëshira, por nga zori, janë në gjendje që të lënë gjithçka vetëm për të kërkuar një jetë më të mirë, jetë të cilën nuk ia kanë ofruar qeveritë e pasluftës.

Pra, nuk mund të akuzohen qytetarët që ata janë fajtorë se pse sot nuk kemi liberalizim të vizave, por çfarë ndodhi është se pas akuzave ose fajësimit të qytetarëve dolën tek akuzat në drejtim të Bashkimit Evropian, madje duke përdorur gjuhë të urrejtjes dhe duke thënë që Bashkimi Evropian është domethënë albanofob, siç ka thënë Enver Hoxhaj apo të tjerë me radhë, që assesit nuk janë në gjendje që të pranojnë që përgjegjës kryesorë se pse sot qytetarët nuk lëvizin lirshëm janë qeveritë, qoftë e kaluara, qoftë qeveria aktuale.

A po më tregoni se si mund Bashkimi Evropian, përkatësisht në këtë rast Këshilli i Ministrave të thotë që Kosova duhet ta ketë liberalizimin e vizave kur e sheh që shteti apo institucionet e Republikës së Kosovës janë të kapura, është shtet i kapur. Pra, vendosin se kush të shkojë në PTK, në KEK, personi që i ka tri aktakuza për keqpërdorime; kush të shkojë në AKP. A po mendoni ju që Bashkimi Evropian nuk i dinë këto?! Ju e dini shumë mirë që secili shtet ka përfaqësim diplomatik në Kosovë dhe ka zyrtarë të instaluar në Republikën e Kosovës, e ata i shohin, ata e kanë parë se si një prokuror është detyruar ta lëshojë vendin për shkak të kërcënimeve, për shkak të hetimit që e ka pasur për lëndën e veteranëve, ose të tjera që i përmendi edhe zoti Kurtoshi, ku zihet me drogë dhe armë djali i Shpend Maxhunit dhe ka deklarata të ndryshme prej Policisë dhe Prokurorisë; ose zoti Aleksandër Lumezi del në mbrojtje të djalit të Maxhunit; apo vëllai i Hashim Thaçit i godet investitorët! A po mendoni ju që Bashkimi Evropian nuk i di këto?

Dhe, unë sot i dëgjova me vëmendje dhe deklaratat e deputetëve të Koalicionit dhe përnjëmend po më duken naive për shkak se shtetet anëtare, përveç zyrtarëve të Bashkimit Evropian, pra e kam fjalën për ministrat e brendshëm të vendeve anëtare kur marrin vendime, përveç elementëve të sigurisë, që i përmendëm edhe më herët, shohin statistikat mbi atë vend, ta zëmë në këtë rast për Kosovën. E tash kur i shohin statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës në raport me papunësinë që për çdo ditë shënon rritje, kur shohin sa është papunësia te të rinjtë, te gratë, kur e

shohin sistemin e arsimit, të dhënat nga shëndeti publik, ju e dini shumë mirë se çka thonë gjitha këto të dhëna.

Si ka mundësi që të thoni që Konjufca ose dikush tjetër nga radhët e opozitës paska thënë që qytetarët e lëshojnë vendin në momentin kur liberalizohen vizat. Si është e mundur të jetë aq naiv? Po ata nuk vendosin në bazë të deklarimeve, edhe në qoftë se qëndrojnë, se unë nuk besoj, por edhe në qoftë se qëndrojnë qysh mendoni ju që ata vendosin në bazë të deklaratës së një deputeti të opozitës. Ky është naivitet!

Dhe, çështja tjetër që duhet po ashtu ta përmend, është e vërtetë që qytetarët e Republikës së Kosovës e meritojnë liberalizimin e vizave. Ata s'mund të mbeten peng i politikanëve të korruptuar. Unë e pashë që këtu pati edhe deklarime në mbështetje të liberalizimit të vizave natyrisht, domethënë askush nuk është kundër, por në qoftë se Qeveria, deputetët e koalicionit e duan aq shumë liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, atëherë duhet të lëshojnë rrugë, sepse është e qartë se liberalizimi i vizave nuk ndodh me këtë qeveri, me këtë qeveri të korruptuar, me këtë qeveri të skandaleve, me këtë qeveri që e ka kapur shtetin, nuk mund të ndodhë.

Pra, bëjuani një favor qytetarëve të Republikës së Kosovës nëse aq shumë po e doni liberalizimin për qytetarët, atëherë largohuni nga këto institucione, shkoni në shtëpi. Dhe, unë jam e bindur që shumë prej tyre do të përfundojnë prapa grilave, sepse korrupsioni s'mund të qëndrojë përherë. Njëherë do të vendoset drejtësi në këtë vend dhe atë drejtësi natyrisht që s'do ta sjellë kjo qeveri.

Dhe çështja tjetër, u përmend këtu edhe gazi lotsjellës, e përmendi edhe Glauku që asnjë fije s'jemi pishman për çfarëdo veprimi që kemi bërë në kundërshtim të atyre dy projekteve. Dhe, unë nuk e di se qysh s'e keni kuptuar që gazi lotsjellës ka qenë favor dhe ndihmë edhe për ju, bre! Ne kemi hedhur gaz lotsjellës që ju të mos e falni territorin. Pra ne kemi bërë veprime, edhe jemi dënuar, por s'ka rëndësi, që edhe juve të ju bëjmë favor, të ju tregojmë që s'bën ta falni territorin dhe tash ata që kanë votuar për demarkacion, 81 deputetë, a ju bren bre pak ndërgjegjja? Ose të tjerët, të cilët kanë premtuar liberalizim të vizave, a keni bre një fije...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Edhe një minutë!

ALBULENA HAXHIU: ...për shkak se nëse po flasim për vlera evropiane, a do duhej që të vepronim në përputhje me standardet evropiane, në përputhje me demokracinë, sepse nëse një zyrtar premtion diçka, nëse ajo s'realizohet, ai duhet të japë përgjegjësi për fjalën që e ka thënë. Pra duhet të ketë moral në politikë. Çka u duhen qytetarëve dhe Kosovës njerëz që premtojnë dhe dështojnë? Nuk u duhen qytetarëve, prandaj kërkesa e opozitës është e qëndrueshme, është e

drejtë, sepse vendi duhet të shkojë në zgjedhje të jashtëzakonshme dhe Kosova ka nevojë për një qeveri që e kthen zhvillimin ekonomik, mirëqenien, barazinë, drejtësinë, por edhe liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Prandaj, duhet të shkoni në shtëpi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! A deshi dikush replikë? Jo! Mirë! Kush do replikë? Blerta Deliu, replikë!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, zoti Haliti!

Jemi shumë vonë, por vetëm për hir të korrektësisë, sepse u thanë të pavërteta edhe e kam për obligim që të them për të mos ia bërë avokatin askujt, vetëm për hir të korrektësisë për të deklaruar se qëndrimet të cilat sapo u thanë që ministrja Hoxha ka deklaruar që faji për mungesë të liberalizimit është i qytetarëve të vendit është totalisht i pavërtetë. Asnjëherë ministrja Hoxha nuk e ka thënë një deklaratë të tillë.

Ne e kemi pasur disa herë në Komision për Integritet për të raportuar, pothuajse në të gjitha takimet e saj zyrtare ajo ka deklaruar që qytetarët e Republikës së Kosovës nuk do ta keqpërdorin asnjëherë procesin e liberalizimit të vizave. Këtë e ka thënë edhe në kampanjën e fundit të lansuar bashkë me GIZ-in gjerman, ku është mundur që përmes fushatës të arrijë t'i sensibilizojë qytetarët për kushtet që ne i kemi në raport me procesin e liberalizimit të vizave.

Prandaj, konsideroj që deklaratat e tilla janë të panevojshme, askush nuk guxon të lëshohet në tilla deklarime që thotë që i paska akuzuar ai ose ky preson qytetarët për një proces kaq të ndjeshëm.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zonja Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Nëse tash jo, në seancën e ardhshme, zonja Deliu, do ta sjell deklaratën e ministres së Integritetit, ku ajo thotë “nuk i ka fajet politika, por migrimi ilegal”. Ministrja e Integritetit thotë kështu. Prandaj, deklaratat e mia janë të vërteta dhe në përputhje, ose të sakta dhe asgjë nuk kam shpikur. Pra, ajo ka thënë që fajet i ka migrimi ilegal dhe tash shtrohet pyetja, pse ndodh migrimi ilegal? Unë ta shpjegoj, 10 vjet keni qenë në qeverisje, keni udhëhequr dikasteret e ekonomisë e të drejtësisë dhe çka keni sjellë, varfëri ekstreme, papunësi dhe natyrisht që qytetarët e Republikës së Kosovës detyrohen ta lëshojnë vendin, sepse po kërkojnë jetë më të mirë, atë jetë që e ka familja jote, e familja e kolegëve që i ke afër, e familja...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Kujtim Shala.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar kolegë,

Së pari, unë e çmoj shumë durimin dhe praninë tuaj këtu në këtë seancë që është e jashtëzakonshme vërtet për një çështje të zakonshme. Unë besoj që një pjesë e mirë e debatit u zhvillua për debatin, duke përfshirë dhe analizën e kujdesshme të kërkesës së propozuesit të kësaj seance, besoj që edhe ajo është e dobishme, por çështja ose tema e këtij debati është shumë më e rëndësishme sesa forma sesi është adresuar ajo.

Tani agjenda e integritimeve nuk është vetëm çështje e qeverive ose e shumicave, të cilat prodhojnë qeveritë, sepse agjenda e integritimit evropian për vendet e rajonit tonë në të vërtetë është agjenda themelore nacionale. Për këtë arsye, ne edhe sonte do të duhej të ishim më shumë këtu dhe në radhë të parë do të duhej ta kishim dhe Qeverinë këtu, por nuk është.

Tani unë do të përpiqem të flas për 3-4 çështje, të cilat u morën, u rimorën disa herë. E para, komisionari Han si një evropian, domethënë evropiani dje në Kosovë nuk ishte për vizat, por për taksën, kjo është e vërteta. Çështja e taksës është kthyer në një problem të ri të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian. Foli për vizat, sepse iu kërkua të fliste për vizat. Një deklaratë e një zyrtari evropian, çfarëdo qoftë ajo, duhet të keni parasysh që s'është vlerësim i institucionit. Që Kosova i ka plotësuar të gjitha kriteret, vlerësim të tillë nuk ka. Të vërtetat duhet të thuheshin ashtu siç janë, Parlamenti Evropian, edhe kur s'ishim ne shtet, miratonte rezoluta për ne. Ai është një organizim i një natyre tjetër dhe duhet ta dini sesi funksionojnë institucionet e Bashkimit Evropian.

Kriteret janë teknike, po ato kriteret e matin funksionimin e institucioneve dhe të shoqërisë. Kosovës i ka mbetur faktikisht i paplotësuar kriteri i 95-të, që është lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Dhe, në këtë duhet ta dimë dhe duhet ta themi.

Nëse refuzimi është vetëm politik, problemi është më i madh, sepse ne na refuzojnë politikisht. Dhe, na refuzojnë politikisht si të tillë kështu si jemi e çfarë jemi ne. Duhet ta dini që institucionet, së paku në demokracitë përfaqësuese, çfarë është kjo e jona, përfaqësojnë dhe qytetarët e vendit dhe një evropian e ka të pamundur t'i njoh qytetarët e Kosovës, por ata i njeh nëpërmjet nesh dhe së pari nëpërmjet drejtuesve të institucioneve tona.

Tani keni parasysh se komisionari Han ishte për një çështje për ta të rëndësishme dhe për ne, sepse ka mbështetje të madhe në Kosovë, ndërkaq kryeministri tallej dhe i thoshte se unë kam prituri që ti vjen dhe na jep datën e vizave. Rreziku i madh është që një evropian s'e kupton një tallje të tillë, sepse ata tallen pak më ndryshe. Por, e vërteta është që një sjellje e tij s'i lejohet kryeministrit.

Problemi i raportit të Kosovës me Bashkimin Evropian më së miri duket në gjuhën, të cilën e përdor kryeministri dhe institucionet tona në komunikimet formale me institucionet e Bashkimit Evropian. Ajo është e rrezikshme. Kosova s'mund të dalë përballë ose t'i rrijë karshi një mekanizmi aq të rëndësishëm drejt të cilit do të shkojë dhe e ka agjendë themelore integrimin.

Kosova s'mund t'i rrijë përballë atij që e ka mbështetësin kryesor dhe këtë kryeministri duhet ta dijë së pari dhe i pari në vendin tonë.

Tani, unë s'do të doja të flisja për gjithë historinë e këtij problemi, por problemi e ka historinë, prandaj ne jemi sonte këtu dhe bisedojmë për të njëjtën çështje në disa variante, problemi është i njëjti. Në Kosovë, njëri nga kriteret edhe jashtë institucioneve edhe në institucione ka pasur dhunë, dhe kjo është e vërtetë. Tani nëse njerëzit ndërrojnë qëndrim mund të kthehen edhe me kokë teposhtë, është punë për ta, por atë që unë e njoh si dhunë s'mund të mos e them që ka qenë dhunë, por duhet të dini, të dalloni, të identifikoni atë që e ushtron dhe atë që e garanton, sepse ka pasur një garantues të dhunës. Dhe, këtë mendim e kam pasur edhe atëherë, kur u tërhoq garantuesi s'pati më dhunë, e tani garantuesi është në Qeveri dhe në krye të qeverisë dhe kjo është e vërteta. Këtë duhet ta keni parasysh.

Drejtuesit tanë, më saktësisht përfaqësuesit e Qeverisë së Kosovës si institucion përfaqësues ditëve të fundit kanë folur në raport me Bashkimin Evropian, me vendet evropiane dhe me Evropën për një tip albanofobie, që domethënë që evropianët s'i durojnë shqiptarët, qoftë dhe për emrat e tyre. Unë besoj që një evropiani i kujtohet emri i shqiptarit në bazë të veprimit të tij, sepse Kosova e ka pasur një drejtues, themeluesin e shteti Presidentin Rugova, që quhej Ibrahim, por askush s'e kishte problem atë. Nëse i ka problem Evropa emrat tanë, i ka problem sepse ka problem veprimet tona. Tani dhe problemi religjioz, jo të gjithë në Kosovë janë myslimanë, është shumicë myslimane, por mos e cilësoni gabimisht Kosovën si shtet mysliman, sepse s'është i tillë. Myslimanizmi ose islami në esencë është politik, e Kosova s'është e tillë, dhe faktikisht edhe me dokumentin themelues ose themeltar të saj që është Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Tani Britania e Madhe po largohet gradualisht nga Bashkimi Evropian, por unë ju rikujtoj këtu që kryetari i Londrës quhet Sadik Kan, është një mysliman dhe ata s'e kanë problem. Pra, në një prej vendeve më të rëndësishme edhe sot edhe historikisht të Evropës. Pse i kemi ne këto probleme? Sepse ne kemi keqkuptime. Kërkesat e Bashkimit Evropian për Kosovën janë të vërteta. A ka pasur më shumë kërkesa në adresë të Kosovës, po, sepse ne i jemi bashkuar këtij procesi më vonë dhe vendet e Bashkimit Evropian, kërkesat shtesë për Kosovën i përmbushin përbrenda legjislacionit si shtete anëtare të Bashkimit Evropian.

Ne duhet të jemi të vendosur dhe të vërtetë në raporte me Bashkimin Evropian, e para, dhe, e dyta, ne duhet të bëjmë detyrën tonë themelore, e cila nuk mbyllet me këtë qeveri. Unë shpresoj

që të ketë vullnetin që të punojë aq sa mundet dhe kjo është lufta kundër korrupsioni. Por Kosova po prodhon skema të tëra korruptive të cilat po i bën edhe skema institucionale. E tash unë pajtohem besoj si rrallë herë me deputetin Kurti që këto janë shenjat e kapjes së shtetit, se nuk është një proces abstrakt.

Pra, korrupsioni nuk është problemi më i madh. Korrupsioni bëhet problemi më i madh kur kthehet në një normë për shtetin dhe drejtuesit e shtetit dhe zyrtarët e lartë dhe disa nivele të funksionimit të shtetit, e mbrojnë, dhe e mbrojnë sepse kanë interesa. Interesat nuk janë vetëm të një natyre. Korrupsioni natyrisht nuk është vetëm financiar, por përfshin të gjitha fushat.

Ne mund të na duket që Bashkimi Evropian s'na përcjell dhe s'na shoqëron në këta hapa, por të jeni të sigurt që ata janë shumë të kujdesshëm. Madje më të kujdesshëm sesa për punët e tyre. Pse? Sepse në shtëpinë e tyre të madhe bëhet gati të marrin edhe një anëtar të ri, të cilin e duan të verifikuar. E tani, ne mund të fillojmë rrugën e vërtetë të përafrimit me Bashkimin Evropian përtej kritereve teknike, nëse jemi të vërtetë në raporte me ta, e ne bëhemi të vërtetë në raporte me ta nëse ia themi të vërtetën njëri-tjetrit. Më duket që as sonte nuk e kemi thënë të vërtetën, të vërtetën tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Shemsi Sylja.

SHEMSI SYLA: Faleminderit zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Vërtet sonte u zhvillua një debat do të thosha si i frytshëm, përkundër faktit se dikush nuk e pranoi se është i tillë, por paksa më habiti një fakt që prej kolegëve të pozitës nuk mori guximin askush që të pranojë së paku që qytetarëve të Kosovës i është bërë një mashtrim i madh. Ka pasur zëra bile që kanë deklaruar që nëse s'bëhet ky liberalizim ndoshta edhe do të tërhiqen edhe nga skena politike, apo edhe nga postet. Por atë nuk e gjeti fuqinë askush ta bëjë këtë.

Më vjen keq dhe pak jam i zhgënjyer me këtë se si nuk pranohet një realitet i cili ishte faktik dhe i cili e dëmtoi shumë shtetin, shoqërinë dhe popullin tonë.

Të nderuar deputetë,

Vizita e komisionarit Hahn në Kosovë dhe sidomos porosia që dha se qytetarët e Kosovës nuk mund të kenë liberalizim të vizave dhe të lëvizin lirshëm nëpër vendet e BE-së përpara vitit 2020, është shumë dëshpëruese dhe dekurajuese për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Siç u tha edhe nga shumë parafolës të mi këtu, zhgënjimi është edhe më i madh kur dihet fakti se këtu pati misione të fuqishme ndërkombëtare në të gjitha fushat e shtetndërtimit dhe të forcimit të demokracisë e sidomos në sundim të ligjit, në polici dhe në gjyqësi dhe është për të ardhur keq në rezultatet e zbehta të këtyre misioneve për punën e të cilave u shpenzuan aq shumë para dhe

prapë Kosova në raport me Bashkimin Evropian ka ngecur paradoksalisht dhjetë vjet prapa Serbisë në plotësimin e standardeve. E paradoksi tjetër është Ukraina e cila sot është në luftë, ani që pa fajin e saj, dhe nuk e kontrollon të gjithë territorin e saj, nuk e garanton dhe nuk i garanton të dhënat personale për të gjithë qytetarët e saj, nuk i ofron garancitë e besueshmërisë së dokumenteve të lëshuara, por ka fituar liberalizimin e vizave.

Kaluan njëzet vjet në këtë gjendje pasigurie dhe kontradiktore. Vërtet që është shumë. Serbia asnjëherë nuk pati pasoja për politikën dhe qëndrimet e saj ndaj Kosovës. Evropa u mjaftua me individualizimin e krimeve dhe bota me një gjykatë në Hagë, që pati efektin praktik të balancimit të krimeve nën sintagmën juridike ‘të gjithë përgjegjës dhe të gjithë fajtorë’. Serbia në vend që të përjashtohej ose të neutralizohej për periudhën së paku njëzetvjeçare në çdo çështje rreth Kosovës, përkundrazi asaj i është dhënë rol vendimtar, bile më shumë se vetë përfaqësuesve të popullit të Kosovës në përcaktimin e fatit përfundimtar të shtetit të Kosovës. Bashkimi Evropian e ka marrë si të mirëqenë, legjitime dhe si krejt legale qëndrimin zyrtar të Serbisë në raport me të gjitha zhvillimet sa i takon Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Deklarimet e Bashkimit Evropian se ratifikimi i marrëveshjes për kufirin me Malin e Zi është kusht i fundit për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës doli se nuk është i vërtetë. Për këtë, Lëvizja Vetëvendosje ka deklaruar gjithnjë se demarkacioni i kufirit me Malin e Zi nuk do të jetë kusht i vetëm për liberalizimin e vizave. Tash, pas vizitës së komisionarit Hahn, edhe Qeveria po e shfaq nervozen dhe pakënaqësinë e saj dhe ka harruar vizitën pompoze të gjithë zëvendëskryeministrave dhe Kryeministrit në Bruksel për të marrë lajmin e madh se Kosova i ka plotësuar kriteret për liberalizim. Siç vrapuat atëherë të gjithë për të shkuar në Bruksel, për të bashkëndarë suksesin e arritur, po ashtu sot të gjithë bashkë duhet të ndani edhe dështimin dhe të kërkonin falje para qytetarëve se i mashtruat me data, deklarata, se vizita do të bëhej brenda këtij viti e të tjera e të tjera. Se vizat do të bëhen brenda këtij viti e premtime të tjera të kota.

Sipas eurodeputetes sllovene Tanja Fajon, Gjermania dhe Franca janë kundërshtuesit më të mëdhenj të liberalizimit të vizave. A ka ndonjë përgjigje Qeveria se si është e mundur që dy shtetet më të fuqishme të BE-së të jenë kundër liberalizimit? A do të thotë kjo se vizitat e vazhdueshme lobuese në këto dy shtete të mëdha paskan qenë të kota? Ose injoranca e juaj politike nuk merren vesh fare gjuhën diplomatike, ose me qëllim keni mashtruar qytetarët e Kosovës. Dhe tash këtë nervozë momentale tuajën dhe këtë dështim total po e kamufiloni me një veprim tjetër që po ashtu është euforik e pa konsensus paraprak, formimin e një ekipi negociues me Serbinë.

Në vend që të shqetësoheni për këtë dështim dhe të reflektoni duke e rishikuar e rivlerësuar qëndrimin tuaj të mëtutjeshëm në pushtet, ju po filloni edhe një dështim tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Lirie Kajtazi. Ahmet a je paraqitur? Po e ke kryer ti. Jo, jo Bilallin e kam toleruar, nuk ka dy herë diskutim. Veç kryetarët e komisioneve e kanë atë të drejtë, jo kryetarët e grupeve parlamentare.

LIRIE KAJTAZI: Faleminderit!

Çdo politikan i arsyeshëm ndihet keq para gjykimit të qytetarëve për klasën e keqe politike dhe athua ndihen keq fajtorët e vërtetë apo dalin e krekosen për rezultate të mira pune? Apo barrën e fajit e bartin te faktori ndërkombëtar që nuk bëri mjaftueshëm. Koleg Ahmet, si të kesh durim të na përcollëm, se boll po ju lëshojmë të zhvatni tjetërkah. Apo barrën e fajit e bartin te faktori ndërkombëtar që nuk bëri mjaftueshëm dhe duke thënë se ka edhe barriera dhe tendenca fetare. Ju lutem, edhe kur intervenoi Aleanca e NATO-s ishim me këtë besim fetar, ishte politika e mençur e presidentit Rugova dhe lufta e pastër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që gëzoi simpatinë e botës.

Por, si po qeveriset sot në një Qeveri e cila shpërblen më së shumti ata që sjellin plaçkë, plaçkën më të madhe, asaj i thonë qeverisje kusare që i takon një kohe të largët dhe primitive.

Me këtë Qeveri konsumi e aspak zhvillimi, kanë rënë investimet e huaja për 43 për qind, dhe kjo çon sinjale në botë. Duke ushqyer partiakët me numër të madh të ministrave, zëvendësministrave, me shpikje të pozitive të ndryshme dhe emërimet e familjarëve aty, po ashtu edhe duke humbur afër 16 mijë vende pune, në një vend kur një përgjigje nga gjyqësori për të realizuar një të drejtë qytetare zgjat deri në 15 vjet, kjo ngjall frikë dhe pasiguri, jo veç qytetare, por kjo pasiguri bartet edhe më lart. Aty ku vidhet dhoma e dëshmive është frikë dhe pasiguri edhe përtej kufijve të Kosovës.

Ndoshta bashkësia ndërkombëtare dhe vendet mike mund të jenë frikësuar nga gjuajta me armë e ministrave të kësaj qeverie dhe nga deklarimi i ministrit Lekaj se Kryeministri Ramush Haradinaj mund të gjuajë me pushkë kur e ka pikën e qejfit. Them të drejtën pamundësia për të lëvizur lirshëm është një kufizim i madh i të drejtave njerëzore, por para se t'i kërkojmë llogari të tjerëve, është mirë t'i shohim veprimet tona, të cilat po e rrjepin qytetarin për çdo ditë. Edhe për çdo ditë ai po dështon në adresimin e problemeve jetike për ta.

Krejt në fund, të nderuar kolegë dhe të nderuar qytetarë,

Bashkësia ndërkombëtare mund të jetë e rezervuar derisa e sheh këtë format të qeverisjes dhe bashkësia ndërkombëtare mund të jetë po ashtu e rezervuar derisa të kuptojë formatin e tkurrur të shtetit të Hashim Thaçit, i cili dërgon sinjale pasigurie edhe në botë, me lëvizje kufijsh dhe me lëvizje dhe trazime qytetare.

Dështimi për liberalizimin ka vetëm një emër të formatit qeverisës të Ramush Haradinajt dhe të formatit të shtetit të Hashim Thaçit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Arbërie Nagavci.

ARBËRIE NAGAVCI: Faleminderit kryesues!

Të nderuar qytetarë,

Kolegë deputetë,

Në një intervistë në një nga emisionet tona televizive më 10 shkurt të vitit 2017, Presidenti Thaçi pat deklaruar: edhe pesë shtetet anëtare të BE-së që nuk e kanë njohur Kosovën janë dakorduar që pas miratimit të demarkacionit të kufirin me Malin e Zi, qytetarëve të Kosovës do t'u mundësohet liberalizimi i vizave. Kjo nuk ishte deklarata e patë e papërgjegjshme Presidentit Thaçi, sikurse u përmend disa herë tashmë edhe këtu. Dhe jo vetëm e tij. Ka tashmë 10 vjet që bëhet fushatë me çështjen e liberalizimit të vizave dhe deklaratat e qeveritarëve kanë qenë të vazhdueshme të përsëritura se Kosova do të marrë shumë shpejt liberalizimin e vizave.

Akuzat ndaj neve deputetëve dhe të gjithë aktivistëve të Lëvizjes dhe së fundi në muajin mars kur u votua marrëveshja e demarkacionit, kur kishim një presion të jashtëzakonshëm te deputetët dhe një mashtrim masiv ndaj qytetarëve, ishim vetëm një nga shumë herët e tjera kur u manipulua me data për liberalizimin e vizave. Ashtu sikurse u potencua disa herë deri më tani dhe si e dinë mirë edhe qytetarët ka tashmë vite që premtohet nga zyrtarët tanë se liberalizimi i vizave do të ndodhë shumë shpejt. Përderisa edhe falja e 8200 hektarëve tokë shërbeu si justifikim për liberalizimin e vizave, edhe pse dihej dhe ishte e qartë se kjo nuk do të ndodhte. Është e vërtetë se Kosova vazhdon të mbetet vendi më i izoluar në Evropë dhe qytetarët e saj edhe në vitin 2018 për të lëvizur drejt vendeve të Bashkimit Evropian duhet të përballen me kompletimin e shumë dokumenteve, me pritjet e gjata të marrjes së vizave, shpeshherë kjo u refuzohet dhe madje edhe nëse arrijnë të marrin një vizë pas plotësimit të gjithë këtyre kërkesave, ajo është me një afat relativisht të shkurtër, shpeshherë edhe vetëm për një javë ose dy.

Por, e vërteta është që asnjëherë BE-ja nuk ka dhënë data për liberalizimin e vizave. Dje ishte hera e parë që u përmend një datë nga një zyrtar i lartë i BE-së, dhe madje komisionari Hahn e ka thënë që ndoshta në vitin 2020, duke thënë po ashtu që të mos mbetemi peng të datave. Andaj është interesant të shihet dhe është për keqardhje se si në këtë situatë në të cilën ndodhemi ka një tendencë nga partitë që qeverisin me vendin, që të fajësojnë të tjerët. Pra qoftë BE-në, apo në anën tjetër të tregohet se të gjithë ne këtu jemi të njëjtë. Nuk qëndron as e para dhe as e dyta.

Nëse zyrtarët tanë paskan pasur premtime se nëse votohet demarkacioni do të kemi menjëherë liberalizimin, se kanë pasur premtime të shumta nga zyrtarë të BE-së që kanë deklaruar disa herë deri më tani për data dhe që pastaj u pa se ajo nuk u realizua, kjo të bën të mendosh se a janë naivë apo se qëllimshëm kanë manipuluar me qytetarët. Gjasat më të mëdha janë që janë të dyja këto.

Pra edhe proceduralisht dhe jo vetëm politikisht ka qenë e pamundur të merret vendimi brenda vitit 2018. U përmend tashmë edhe nga kolegët e tjerë deputetë se kjo ka qenë e pamundur të arrihet edhe në aspektin formal dhe zyrtarët e diplomatët që kanë përfaqësuar Kosovën është dashur që këtë ta dinin. Është e vërtetë që tani situata në BE është pak më e komplikuar dhe si duket nuk ka një disponim brenda BE-së që të ketë një liberalizim të vizave për Kosovën.

Sidoqoftë, përkundër asaj se çfarë është disponimi në vendet e BE-së, vonesat në liberalizim të vizave për Kosovë duhet t'i atribuohen në masën më të madhe politikanëve vendorë. Sado që na thuhet se ka pasur progres dhe se kemi plotësuar kriteret është evidente se s'kemi arritur rezultat të kënaqshëm në luftimin e korrupsionit. Madje edhe vetë kryeprokurori Lumezi gjatë konferencës së fundvitit të Këshillit Prokurorial kishte deklaruar se në krahasim me lëndët e tjera, s'i kemi punët mirë me lëndët e korrupsionit. Pra nuk duhet harruar se liberalizimi i vizave dhe secila fazë e integritit në BE matet me suksese të prekshme siç janë lufta kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe të tjera si këto. Dhe jo me deklarata politike krejtësisht boshe.

Deri më tani fatkeqësisht nuk kemi pasur ndonjë sukses evident e në veçanti me tema të ndjeshme për të cilat vendet e BE-së janë shumë të interesuara siç është luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit. Kosova po bën gjithçka për të përmbushur standardet, parimet dhe vlerat e BE-së, megjithatë duket sikurse sa herë po i afrohem BE-së, ajo po ikën prej nesh. Deklaroi vetëm para pak kohësh, ministrja Hoxha thujse të gjithë kemi harruar se një ndër vendimet e para të kësaj qeverie ishte shkarkimi i Bordit të Agjencisë Kosovare të Akreditimit me kërkesën e vetë Kryeministrit Haradinaj për të vazhduar pastaj me shkarkimin e bordeve të tjera dhe emërimet klienteliste partiake në të gjitha bordet dhe pozitat më të rëndësishme të institucioneve shtetërore. Se po keqpërdoren me dhjetëra e qindra miliona euro dhe se po abuzohet për çdo ditë me pushtetin. Po, qytetarëve të Kosovës po u bëhet e padrejtë, por padrejtësia vjen në radhë të parë nga kjo klasë qeverisëse, nga Presidenti, nga e gjithë kjo armatë e ministrave e zëvendësministrave.

Në Kosovë po bëhet fushatë me liberalizim që nga viti 2008, por nuk po punohet aspak dhe nuk ka as minimumin e përkushtimit që të plotësohen kriteret themelore për luftimin e krimit dhe të korrupsionit. Me Qeveri e President që keqpërdorin buxhetin, që falimentojnë ndërmarrjet publike, në një vend ku Kryeministri kërcënon prokurorin, ku në krye të institucioneve më të rëndësishme të vendit kemi persona joprofesionistë, ku kemi ministra që janë me aktakuzë, ku kidnapohen e depërtohen njerëz, ku me mjetet e dedikuara për lobim për vendin bëhen promovime personale për përmirësim të imazhit të Presidentit, si mund të deklarohejmë se janë plotësuar kriteret dhe si mund të presim që do të kemi mirëkuptim nga vendet e BE-së dhe qytetarët tanë tashmë e dinë këtë gjë. Gjasat janë të vogla që të kemi një perspektivë evropiane pa i luftuar seriozisht këto dukuri negative, pa e luftuar krimin e korrupsionin, pa dhënë

përgjegjësi e llogari për deklarata e veprimet që dëmtojnë jetën dhe perspektivën e qytetarëve, që dëmtojnë të ardhmen e këtij vendi e të fëmijëve tanë.

Në një vend me një nivel minimal të zhvilluar të demokracisë, tanimë do të kishim dorëheqjet e para pas gjithë këtyre deklaratave të papërgjegjshme të pushtetarëve. Por ata jo vetëm se nuk mbajnë përgjegjësi, por nuk denjojnë as të marrin pjesë në seanca si këto kur diskutohen çështje kaq të rëndësishme. Andaj, ashtu sikurse u përmend disa herë zgjedhja më e mirë për vendin është dorëheqja e kësaj qeverie dhe hapja e rrugës përpara për zhvillimin e vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Shkumbin Demaliaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Haliti!

Deputetë, media, qytetarë të Republikës,

Në këto orë pas mesnate ju përshëndesim nëse jeni zgjuar dhe duke na ndjekur nga Parlamenti i rezolutave. E them nga Parlamenti i rezolutave për shkak se opozita edhe sot me tentativën e saj po mundohet të minimizojë punën edhe veprimet e Qeverisë që udhëhiqet që një vit nga Ramsuh Hardadinaj.

Sikurse të kishin dashur të kenë Qeverinë këtu është dashur ta dinë mirë opozita që Rregullorja e Kuvendit e përcakton ndryshe, është dashur të thirret në interpelancë Kryeministrin apo ministrat apo dikë tjetër, jo vetëm hajt ta hartojmë një kërkesë me disa pika, edhe atë duke i falsifikuar ato nënshkrime, e të gjitha këto që ndodhën deri këtu. Kështu që vazhdimisht duke mos mundur të ballafaqohet me të arriturat e kësaj Qeverie që e udhëheq z. Haradinaj që një vit, vazhdimisht jeni munduar dhe jeni përpjekur opozita në Parlament ta pengojnë me pengesa të ndryshme, duke dashur vetëm me anë të rezolutave të pengojë proceset edhe deri te ato integruese të Kosovës. Sonte filluan të bisedojnë shumë deputetë, edhe folën këtu edhe dialoguan për çështje fetare, u munduan të na bëjnë edhe fundamentalistë apo diçka tjetër shtetin tonë, por Kushtetuta jonë, Republikën e Kosovës e paraqet shtet laik. E si sillemi ne e dimë fare mirë, është e vërtet ne dalim në zgjedhje, demokracia e lejon atë, përfaqësues edhe krerë të partive politike dalin edhe nëpër terren në kohë fushatash, bëjnë be pasha musafin e Kuranin për të marrë vota, e kurrë kryet në sexhde nuk e kanë vënë, edhe luajnë me ndjenjat e besimtarëve.

Ndërkaq, për pjesën tjetër, a mund të luftohet në qoftë se ka pasur aq shumë korrupsion në Republikën e Kosovës që gjitha këto vite prej kur funksionojmë si Kuvend, edhe Qeveri, edhe si republikë parlamentare, do të thotë këtë korrupsion për një vit d.m.th. duhet të jetë përgjegjës Ramush Hardinaj. E dimë fare mirë se njerëzit e parë që kanë akuzuar, edhe janë trajtuar nga gjyqësia e Kosovës për korrupsion, s'po flas për nivelin e dytë dhe të tretë, po nivelin e parë, janë ministrat e LDK-së. Dihet fare mirë, nga Ministria e Kulturës, në Ministri të Shëndetësisë, ministri të ndryshme.

Por kur flasim edhe për formatin tjetër, për të arriturat në politikën e jashtme, për të arriturat e tjera, nuk ka qenë vetëm një subjekt politik në koalicion e as nuk ka udhëhequr asnjëherë Kosovën, por kanë udhëhequr bashkërisht, prej vitit 2007 Aleanca nuk ka qenë në pushtet. Tash është në pushtet, jemi bashkë me shumë subjekte politike. Dalin për çdo ditë duke u munduar, është i njëjti refleksion, i njëjti rotacion i këtyre deklaratave lidhur me çështjen e zëvendësministrave e shumë çështje të tjera që po mundohen t'i hedhin pluhur syve qytetarëve të Republikës në këtë kohë, kur jemi në procesin e vendosjes së një takse 100 për qind ndaj Republikës së Serbisë, edhe ajo është e kushtëzuar me njohje. Mundohet ta minimizojë dikush, po kjo është shumë naive vetëm të mendosh kështu. Edhe thirrmi sot për të ardhur të nxjerrim këso rezolutash, edhe këso pika të rendit të ditës për diçka tjetër. Ardhja deri te ajo nuk ka qenë më e mira, nuk ka nevojë askush të na tregojë, por e dimë pse janë pengesat dhe pse ka ardhur deri aty.

Po sonte folëm edhe për retorikën e vazhdueshme lidhur me demarkacionin. E dini fare mirë cila ka qenë marrëveshja, e dini kundërshtimin edhe të Aleancës. Ka mekanizma politike sot në Kosovë se po flasin për faljen e 8200 hektarëve. Ju e dini edhe në deklaratimet e mëhershme tash të Presidentit Thaçi, atëherë ish-zëvendësministër edhe ministër i Punëve të Jashtme kishte pas thënë se asnjë milimetër tokë nuk ia kemi dhënë Malit të Zi. Mirëpo, e ka rigjykuar vendimin e vet, edhe fjalën e vet, edhe së bashku me kryeministrin e Kosovës e ka nënshkruar edhe një deklaratë tjetër për korrigjimin e kufijve që dihet afati ligjor lidhur me marrëveshjen kur do të jetë ajo edhe s'do të mund ta marrë askush asnjë milimetër tokë Kosovës, edhe atë duke pasuruar lidhur me një objektivitet tjetër që në këtë rast vjen nga Lidhja Demokratike e Kosovës që i kemi besuar një ekspertit më të madhi në Kosovë që është Shpejtim Bulliqi, ish-koleg i legjislaturës së kaluar që sot është në krye të atij komisoni, dhe ne besojmë ta ai dhe demarkacioni do të jetë i rehatuar, mos ta kenë vesvese.

Po flitet për kapje të shtetit. Unë nuk e di çka duhet bërë më shumë sa që nëse ky koalicion qeverisës e ka kapur shtetin që 1 vit e këndeje, unë si deputet kam përfunduar në burg për një deklaratë televizive. Asnjëri nga ju të tjerët asnjëherë.

Ka qenë një deklaratë e nxjerrur, por mendoj që asnjëri këtu nuk ka të drejtë që të përzihet tek mekanizmat e drejtësisë. Nëse dikush ka se unë po dëgjoj po thonë; po vidhni e po bënë e të tjera, urdhëroni, janë policia, është prokuroria, depononi deklaratat tuaja dhe mos flisni që ta ekzagjeroni në të përgjithshmen.

Unë e shoh kur flasin për liberalizimin. Sot, ka kërkesë të 22 deputetëve të Parlamentit Evropian që në afatin sa më të shpejtë ta fusin në votim liberalizimin për qytetarët e Kosovës nga Këshilli i Ministrave të Evropës.

Ne këtu po sillemi dhe duke u munduar se ne nuk jemi evropian, neve s' di çfarë njerëz jemi. Ata neve po na shohin, po i shohin sjelljet tona. Bile kemi mbërri deri në atë shkallë sa që sikur Daçiqi kur iu drejtua kryeministrit Haradinaj tha; kush po ti shkruan letrat. Sonte thanë se po mundohen që t'ia shikojnë edhe deklaratat.

Më së miri e ka marrë vesh Serbia sesi duhet të deklarohet dhe të shkruhen letrat ndaj saj. Ngase janë mësuar me të mirë nga ana jonë, dhe na kanë sjellë marrëveshje të këqija. Na e kanë sjellë demarkacionin e Asociacion e çfarëdo marrëveshje tjera dhe kanë pranuar edhe marrëveshja të tjera që sot po e kemi problem që të zbatohen, përdërisa nuk ka përfunduar dialogu me Serbinë siç është ai edhe për marrëveshjen e vitit 2013 lidhur me gjykatat në veri.

Unë në këtë rast që të mos lëshohem në anën tjetër, te liberalizimi kur flasim nuk mund ta dimë më mirë ne se Bashkimi Evropian, kur dalin dhe deklarohen zyrtarët e atij parlamenti, ata deputetë, ata kryekomisioner që Kosova i ka plotësuar kushtet.

Nëse nuk i kemi plotësuar kushtet duhet të tregohet pse. Nëse ne kemi njerëz të këqij brenda i kisha lutur të gjitha subjektet politike mos të vendosin në listat e tyre zgjedhore njerëz të këqij, njerëz të korruptua, njerëz që janë kundër shtetit të Kosovës në votime dhe të vijnë njerëzit e këqij në institucione.

Kështu që po e rrumbullakoj këtë fjalën time, të shkojmë dhe t'i përvishemi punës. Jemi në përfundim të shumë formateve të tjera që janë; përmbyllja e këtij procesi të liberalizimit, përmbyllja e ushtrisë. Ta votojmë buxhetin për vitin 2019. Për zgjedhjet kemi kohë që të flasim.

Sikurse kur po na thonë ata kur po hidhërohen me neve se nuk ka viza deri 2020, atëherë s' do të ketë zgjedhje as në 2021-ën për shkak se duhet ta dimë pse shkojmë në zgjedhje.

Ne e kemi të rregulluar me ligj dhe me Kushtetutë sesi bëhen zgjedhjet. Nëse ka vota kundër, edhe ajo përpjekje mund të ndodhë në Kuvend. Askush nuk është jashtë natyrës demokratike. Mos i merrni zgjedhjet si kërcënim. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës fare nuk e ka problem atë punë. Sa për zgjedhje besoj se edhe nëse mbahen zgjedhjet sonte nuk besoj se do të ketë ndonjë rezultat tjetër, përpos ky që ka qenë në zgjedhjet e fundit ose më i mirë, për shkak të vlerësimit të punës që po bën Qeveria e Kosovës dhe koalicioni qeverisës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, Shkumbin! Fjalën e ka zonja Valentina Bunjaku.

VALENTINA BUNJAKU-REXHEPI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë të Republikës së Kosovës,
Të respektuar qytetarë të republikës sonë,
Sot po diskutojmë për një temë për të cilën qytetarët e Republikës së Kosovës kanë pasur një pritje krejtësisht tjetër.

Një përgjigje të cilën kjo Qeveri e ka trumbetuar këta 15 muajt e fundit tek qytetarët, duke premtuar se do të udhëtojnë pa viza para Vitit të Ri.

Çka nuk keni premtuar këta 15 muajt e qeverisjes suaj; pranimi në Interpol, pranimi në organizata të rëndësishme ndërkombëtare, zhvillim ekonomik, punësim. Madje keni deklaruar se Kosova është Zvicra e Ballkanit.

Do të dëshiroja që të gjitha këto të ishin të vërteta. Fatkeqësisht, asnjëra nga këto nuk është e vërtetë, janë gënjeshtër të radhës, që është karakteristikë për partnerët e këtij koalicioni qeverisës.

A e keni një grimë moral politik, njerëzor dhe qytetar? A jeni të vetëdijshëm se çfarë i keni bërë këtij vendi me këtë qeverisje dhe me këtë logjike qeverisëse?

E keni vrarë shpresën e qytetarëve të Kosovës. Pjesa dërmuese e të rinjve presin që të gjejnë një mënyrë që të ikin nga vendlindja e tyre. Po ikin intelektualët, po ikin ekspertët e në veçanti po ikë pjesa më e shëndoshë, rinia.

A keni përgjigje për këtë gjymtim që po i bëni Kosovës? A keni përgjigje për këtë degradim të shtetit tonë? Jo. As nuk keni përgjigje, as nuk keni dije dhe as kapacitet që të ofroni zgjidhje.

Kjo Qeveri e përbërë nga qindra anëtarë duket se nuk ka kryeministër. Nuk ka shef diplomacie, nuk ka ministra dhe nuk ka as ministër të Integritetit Evropian. Çka jeni ju? A jeni qytetarë apo grup OJQ-ësh apo institucione të një shteti të pavarur dhe sovran?

Kjo Qeveri më së paku i përngjan një ekzekutivi të një shteti normal. A keni kuptuar që BE-ja dhe institucionet e saj nuk na vlerësojnë, dhe asnjë iniciativë e juaja nuk përkrahët nga partnerët tanë ndërkombëtar.

Interpoli na i mbylli dyert. EQAR-ri na përjashtoi. Na i mbyllën dyert edhe shumë organizata tjera ndërkombëtare. Na i kanë mbyllur dyert dhe ne marrim vetëm përgjigje negative.

Besoj që e keni kuptuar se sa shumë e keni dëmtuar imazhin e shtetit tonë. Dorëheqja është e pamjaftueshme, por është mirë t'i kërkonit këtij populli. Të ikni sa më parë nga institucionet e këtij vendi. Ta rrëzoni këtë Qeveri, ngase Kosova ka nevojë për një qeverisje të pastër dhe me duar të pastra.

Kosova e besoj që keni kuptuar se shumë e keni dëmtuar imazhin e shtetit tonë. Kosova ka përparuar më së shumti në korrupsion. Në kapjen e sistemit të drejtësisë dhe në shumë sektorë të tjerë.

Do të doja të besoja që ka përparime, po tani kemi vetëm ngecje dhe fajtor për këtë gjendje më së paku janë qytetarët. Edhe kësaj radhe e po sanksionohen pikërisht qytetarët e republikës sonë. Në fakt do duhej që të dënoheshin qeveritarët. Prandaj, keni kujdes. Të ndjeni pak keqardhje karshi qytetarëve tanë. Ikni, lironi rrugë të hyjmë ë zgjedhje dhe fjala e fundit le të mbetet te qytetarët e republikës sonë. Ata do të vendosin se kë do ta votojnë dhe kush do të udhëheqë me institucionet e shtetit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Pacolli e ka fjalën.

FITORE PACOLLI: Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Të nderuar deputetë,

Sot Qeveria dhe deputetët e partive në pushtet po paraqiten kinse ky vendimi i fundit i Bashkimit Evropian, deklarimi i komisionarit Hahn i paska zënë disi në befasi, sepse këta paskan pritur që liberalizimi i vizave të ndodh këtë vit.

Mirëpo, e vërteta është se këta po shtiren kinse nuk e kanë ditur, sepse rezultati në fund ka qenë diçka që mund ta kishin pritur dhe se Qeveria e ka ditur.

Ka disa sinjale që Bashkimi Evropian i ka dërguar Qeverisë dhe Lëvizja Vetëvendosje i ka ngritur këto, duke potencuar se kjo Qeveri me punën që po bën, jo që do të sjellë liberalizimin e vizave, por do ta dëmtojë edhe më tutje shtetin tonë në vend dhe jashtë tij, siç po vërtetohet edhe sot, pra, me tërheqjet të cilat po bëhen çdo ditë dhe me shtetet të cilat e kanë njohur Kosovën, por tashmë janë kthyer kundër Kosovës.

Kur Lëvizja Vetëvendosje deklaronte se këto sinjale do duhej të merreshin seriozisht nga Qeveria, Qeveria fillimisht refuzonte se ka sinjale të tilla dhe vazhdonte t'i angazhonte mediat e saj që të na sulmonin.

Pra, cilat janë këto sinjale? Në shkurt të vitit 2018 kryeministri, ministri i Drejtësisë, ministrja e Integriteteve Evropiane, kanë pranuar një raport të punuar nga ekspertë të Bashkimit Evropian të cilët ishin angazhuar nga Bashkimi Evropian për t'i vlerësuar kapacitetet e institucioneve të drejtësisë për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Ky raport nuk është shkruar për publikun e Kosovës, ky raport është shkruar për përfaqësuesit e shteteve anëtare që ata të informohen sa më mirë dhe sa më drejte sa i përket gjendjes reale në Kosovë.

BE-ja vetëm në këtë raport e ka thënë atë që është e vërteta. Pra, siç BE-ja e sheh Qeverinë e Kosovës dhe punën e saj për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Në këtë raport ishte konstatuar qartë se sistemi i drejtësisë ka dështuar në luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Shqetësimi kryesor mbetet mungesa e pavarësisë së gjyqësorit dhe autonomia prokurorëve, e veçanërisht në nivelin e lartë të korrupsionit.

Gjyqësori është i ndikuar politikisht dhe i korruptuar. Prokuroria Speciale ndikohet nëpërmjet ndërhyrjeve direkt të kryeprokurorit të shtetit. Mungon gatishmëria dhe nuk është bërë asnjë përpjekje për t'i hetuar kokat e krimit. Hetimet kryesisht përqendrohen në nivelin e ulët dhe jo në nivelin e lartë.

Konfiskimi i pasurisë së paligjshme nuk është fare objektivë qendrore e sistemit të drejtësisë. Dhe Ligji për Konfiskimi e Pasurisë së paligjshme është joadekuat. Pra, këto ishin disa prej konstatimeve të këtij raporti. Pra, raporti i cili vërtetë pati deklaruar dhe pati informuar edhe Qeverinë edhe ministrat kryesorë, pra ministrin e Drejtësisë dhe ministren e Integriteteve Evropiane se Kosova nuk është duke e bërë punën ashtu siç duhet.

Ne patëm arritur që ta marrim këtë raport në mënyrë jozyrtare dhe ta ngremë si shqetësim, mirëpo Qeveria duke e ditur se ku qëndron me punët e saj, angazhuan mediat që të sulmonin deputetët. Kryeministri pati angazhuar këshilltarët e tij të cilët deklarorin se ne po gënjenim.

Ne patëm ftuar një interpelancë, ku kemi kërkuar që kryeministri të bëhej i sinqertë dhe të raportonte për punën dhe për dështimin që e kishte gjetur ky raport, por kryetari i Kuvendit dhe kryeministri jo vetëm që patën bërë të pamundur që seanca të mbahej në kohën e caktuar, patën shtyrë seancën tre muaj pas, por edhe patën ndërhyrë tek administrata e këtij Kuvendi që ky raport të mos u dërgohej deputetëve.

Dhe për ta mbuluar dështimin e për ta fshehur gjendjen reale, kryeministri pari sjellë në Kuvend një raport të cilin e kishte shkruar vet, pra vet Qeveria e tij, ku lavdërohej puna e Qeverisë dhe jo raportin konkret të cilin e kishte dërguar Bashkimi Evropian.

Sinjali i dytë ishte në takimin e mbyllur për media ku ishin prezent përfaqësuesit e BE-së dhe Komisionit për Integritete Evropiane. Duke lexuar mes rreshtave se çfarë thoshin përfaqësuesit e BE-së, kuptohej se pavarësisht se çfarë shkruhej në raport për vendin, përfaqësuesit e BE-së kishin qëndrim krejt tjetër.

Pra, ata e theksonin dhe e ritheksonin dështimin e institucioneve për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar. E ne si deputetë e kemi për të detyrë që t'i informojmë saktë dhe dejtë qytetarët e Kosovës, dhe për këtë kur pata deklaruar se në bazë të asaj se çfarë kisha arritur të kuptoj nga ky takim, është se këtë vit nuk do ndodhë liberalizimi i vizave.

Patën filluar sulmet nga të gjitha anët dhe në media ishte ngritur pyetja se kush gënjeu. Dhe sot kjo pyetje është shumë më legjitime. Pra, kush në fakt gënjeu dhe kush po vazhdon të gënjejë?

Zyra e BE-së është përgjegjur në këtë çështje duke u arsyetuar se nuk ka dhënë asnjë afat për vizat, gjë që është e vërtetë, por në këtë takim të brendshëm të mbyllur për mediat, normal që nuk janë deklaruar në mënyrë direkte dhe të prerë, por mes rreshtave kanë dhënë sinjal negativ se nuk do të ketë liberalizim të vizave këtë vit.

Sinjali i tretë, institucioni nga i cili ne po presim liberalizimin e vizave është pikërisht institucioni që e konsideron këtë shtet si shtet të kapur. Pra, çka do të thotë shtet i kapur? Shteti i kapur është shteti kur çdo institucion i tij është kapur nga njerëzit që udhëheqin në Qeveri, pra në pushtet.

Çdo vendim për hetim apo dënim varet nga dëshira dhe interesi i pushtetit, ku prokurori special detyrohet të largohet nga vendi se kërcënohet nga kryeministri. Ku për rend dhe ligj vendosin ata që do duhej të ishin prapa grilave apo ata në listat e hetimeve të cilat i ka kërkuar vet BE.

Sinjali i katërt, janë shqetësimet që ka shprehur Bashkimi Evropian rreth vendimit të shtetit të Kosovës për kidnapimin e gjashtë shtetasve turq të cilëve vet shteti i Kosovës ua ka dhënë njëfarëlloj sigurie që ata të jetojnë dhe të punojnë në Kosovë, por duke i kidnapuar dhe dëbuar, Qeveria ka bërë shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Ky ishte një skandal shumë i madh dhe mesazh shumë i qartë për shtetet e Bashkimit Evropian, se çfarë sistemi të drejtësisë kemi dhe sa jemi zhvilluar si shtet.

Sinjali i pestë janë shqetësimet e shteteve anëtare të BE-së kur kryeministri kushtëzon, shantazhon dhe kërcënon prokurorin special të shtetit. Ky veprim e vërteton atë çfarë ka thënë edhe vet BE se ky shtet është shtet i kapur. Dhe për vendimet se kush të hetohet e kush jo, vendosin njerëzit në pushtet.

Sot, Qeveria po shprehet e habitur, po pyet si është e mundur. Apo Evropa qenka bërë albanofobe. Shumë ministra të kësaj Qeverie kanë deklaruar shumë herë se po llojnë për liberalizimin e vizave. Pra, ministrat që vet janë nën hetime. Paramendojeni, këta sa herë flasin ose llojnë për Kosovën e kthejnë çdo proces të Kosovës prapa. Sepse, këta janë persona të akuzuar dhe duhet të përgjigjen para drejtësisë dhe jo të llojnë për vendin.

Në mars të këtij viti, pra të vitit 2018 në Komisionin për Integritet Evropian patën raportuar; ministri i Drejtësisë dhe ministra e Integriteteve Evropiane. Të dy patën deklaruar dhe patën premtuar se liberalizimi i vizave do të ndodh pikërisht këtë vit.

Ministrja më pati pyetur se çdo të bëja nëse liberalizimi i vizave do të bëhej këtë vit? Unë nuk t'ia bëj pyetjen e njëjtë ministres, sepse nënkupton se ministres i japim disa mundësi, disa opsione. Ministrja sot nuk ka mundësi të zgjedh se çfarë do të bëjë pasi që Kosova nuk do ta marrë liberalizimin e vizave këtë vit.

Ministrja e ka obligim të japë llogari dhe përgjegjësi dhe këtë duhet ta bëjë duke dhënë dorëheqje. E kjo nuk mjafton vetëm me ministren e Integriteteve Evropiane, duhet të japë dorëheqje edhe ministri i Drejtësisë e për ta vënë vendin në drejtimin e duhur duhet të japë dorëheqje kryeministri e presidenti.

E ne si deputetë çfarë mund të bëjmë, ne mund t'i bëjmë një kërkesë Bashkimit Evropian. Është fare e thjeshtë, por bën ndryshim të madh, pra të kërkojmë nga Bashkimi Evropian të flasë direkt. Atë që e thotë në raporte të brendshme ta thotë edhe në raportin për vendin, pra në raportet të cilat bëhen publike.

Është vlerë e BE-së si institucion që të informojë saktë dhe drejtë qytetarët dhe le ta bëjë këtë edhe me qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani, unë e kam shkelur më herët rregulloren dhe e kam shkelur me kërkesë të disa deputetëve të LDK-së, e para. E dyta, meqenëse kryeministri dhe Qeveria nuk është këtu opozita e ka pasur shumë më pak diskutime dhe më pak deputetë ka në sallë.

Unë për ta përfunduar në emër të pozitës, dua t'ia jap fjalën zoti Ahmet Isufi, meqenëse Qeveria nuk është këtu.

AHMET ISUFI: Faleminderit, kryesues!
Qenka bërë vonë dhe nuk po e marr fjalën.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë para se ta mbyll nuk dua që të diskutoj asgjë, veç dua t'ju them disave që paraqitën aq shumë urrejtje ose menduan që aq shumë po na urren Evropa, dua t'ju them që vetëm këtë vit Evropa i ka dhënë donacione Kosovës, 200 milionë euro. Kështu që jemi në rregull. Besoj që edhe kjo është një ndihmë për liberalizim të vizave.

Zoti Hoti e keni fjalën i fundit ose dikush tjetër. Zoti Konjufca, urdhëro!

GLAUK KONJUFCA: Si e thatë edhe vetë, lidhur me kushtet objektive për votimin në këtë seancë aktuale, ne propozojmë së bashku me Lidhjen Demokratike të Kosovës si propozues të kësaj seance të jashtëzakonshme, që dita e votimit të jetë enjten lidhur me pikat që i kemi propozuar. Në orën 10:00 për shembull, para se të fillojë seanca tjetër.

Siç po e shihni edhe vet dhe siç e konstatuat nuk ka kuorum që të vazhdohet seanca drejtë votimit.

KRYESUESI: Meqenëse Ahmeti s'po do që të flasë, po flas unë. Mendoj që ky tekst që e keni shkruar, do të jetë i papranueshëm për pozitën, e para.

E dyta, me rezoluta nuk rrëzohet Qeveria. Këto dy gjera duhet t'i keni parasysh. Megjithatë, të enjten unë nuk e kam problem që në fillim të seancës ta vë në votim. Në qoftë se nuk vjen kryetari këtu, jam unë dhe jemi të gjithë bashkë. Është në rregull nëse dëshironi kështu.

A ka ndonjë propozim tjetër? Zonja Deliu e ka një propozim për këtë çështje.

BLERAT DELIU-KODRA: Zoti Haliti u tha këtu që të enjten ta hedhim në votim, unë propozoj që fillimisht të kemi një harmonizim, sepse ashtu siç e deklaruat ju është absolutisht e papranueshme që me këto pika të cilat janë futur brenda kësaj rezolute të arrijmë që të kalojmë dhe ta miratojmë bashkërisht.

Prandaj, unë propozoj që fillimisht të ketë një harmonizim ndërmjet pozitës dhe opozitës nëse veç qëllimi ka qenë që të përfitojmë diçka sa i përket këtij procesi.

KRYESUESI: Unë mendoj që Avdullahu edhe Glauku mund të diskutojnë me të gjitha grupet. Zoti Hoti e keni fjalën. Zoti Hoti e ka fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit!

Ne me qëllim kryesues i seancës e shpërndamë dhe e protokolluam më herët këtë propozim tonin të rezolutës. Nuk kemi marrë asnjë koment nga grupet tjera parlamentare, pro jemi të gatshëm, Glauk nëse pajtohesh që të enjten në 9:30 mund të takohemi dhe t'i shohim kërkesat...

KRYESUESI: Unë nuk jam në 9:30 se... Takohuni nesër. Caktoni më shumë kohë vetës.

AVDULLAH HOTI: Nesër është ditë zie. Të enjten përpara seancës takohemi dhe diskutojmë.

KRYESUESI: Atëherë, konstatoj që seanca dhe debatet kanë përfunduar. Votimi ka ngelur pa u bërë për shkak të kuorumit dhe mosharmonizimit. Mirupafshim!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*